

# Jeta Arbëreshe

e-mail: [jetarbreshe@libero.it](mailto:jetarbreshe@libero.it) - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga gjashtë muaj - Semestrale online della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs- Italia)

## Përmbajtja / Sommario

<b>EDITORIALI</b>	faqe 3
Drejtori	
<b>NGA ARBËRIA</b>	faqe 4- 8
Laura Perillo, Motimadh/G.Mario Miracco, Kostantin Bellushi, Francesco Marchianò, Daniela Moccia, Zef Chiaramonte, Mario Massaro, Zef Schirò di Maggio, Pasquale Ferraro	
<b>ZAKONE POPULLORË, TEKSTE NGA ARBËRIA</b>	faqe 9-14
Giuseppe Chiaffitelli, Carmine Stamile, Mario Massaro, Zef Gallo, Emanuele Giordano, Patrizia Figlia	
<b>PËRVJETORE</b>	faqe 15-16
Drejtori	
<b>ARTIKUJ E STUDIME MBI BOTËN ARBËRESHE</b>	faqe 17-31
Italo Costante Fortino, Imri Badallaj, Giovanni Giudice, Merita Bruci-Sauku, Alisa Velaj, Giuseppe Schirò di Maggio	
<b>ARTIKUJ E STUDIME MBI BOTËN SHQIPTARE-ÇAME</b>	faqe 32-43
Baviola Shatro, Nexhip Mërkuri, Diana Mone	
<b>ARTIKUJ, STUDIME, POEZI, KËNKA MBI MËMËN TEREZE</b>	faqe 44-51
Lush Gjergji, Irena Alimerko, Agostino Sofis / Vëllezërit Scaravaglione, Alisa Velaj	
<b>POEZI ARBËRESHE</b>	faqe 52
Nicola Alfano, Aedi, Zef Schirò di Modica	
<b>POEZI SHQIPE</b>	faqe 53
Brikenë Ceraja	
<b>SEMINARI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS</b>	faqe 54
<b>XV* VJETORI I JETËS ARBËRESHE</b>	faqe 55-57
Kledi Shegani & Helena Grillo, Drejtori	
<b>DREJ QINDVJETORIT TË EPARKISË SË UNGRËS (1919-2019)</b>	faqe 58-62
Pietro Lanza, protosincello	
<b>PËRKUJTIMI I ZOTIT MANUELL GIORDANO</b>	faqe 63-67
Drejtori, Lino Mitidieri, Shkëlqim Llanaj, e-mail Drejtorit	
<b>DORËSHKRIMI ARBËRESH</b>	faqe 68-69
Bernardo Bilotta	
<b>JO VET ARBËRISHT</b>	faqe 70
Pierfranco Bruni	
<b>NDERIM FRANGJISKUT FUSKA (1948-2016)</b>	faqe 71
<b>BIBLIOGRAFI ARBËRESHE NDËPËR REVISTAT SHQIPTARE TË DIASPORËS</b>	faqe 72-80
Koha e Jonë	
<b>BIBLIOGRAFI ARBËRESHE e AGOSTINO GIORDANO-s / BUZËDHËLPRI</b>	faqe 81-96
<b>BIBLIOGRAFI MBI POEZINË E BUZËDHËLPRI-t</b>	faqe 97
<b>KONKORS POEZIJE (LËTISHT E ARBËRISHT)</b>	faqe 98

# Jeta Arbëreshe

Semestrle online  
di Cultura  
e Informazione Arbëreshe,  
in Italia e nel Mondo

Revistë gjashtëmujore online e Shoqatës Kulturore “Jeta Arbëreshe”,  
Purçill / Eianina (Cs-Italia)

**Regjistrim** / Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr.4/2001 del  
28-12-2001.

**Drejtor përgjegjës** / Direttore responsabile: **Agostino Giordano**

**Drejtori, Redaksi e Administratë** / Direzione, Redazione,  
Amministrazione: via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia)

**Tel.:** (+39) 345-3124376 / **e-mail:** jetarbreshe@libero.it /

**Sito internet:** <http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

**Artikuj, Dorëshkrime e Fotografji, edhe ndëse s’botohen, nëng priren prapë** / Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono.

**Drejtorja nëng është përgjgëjse për përmbajtjen dhe formën e artikujvet të nënshkruar** / La Direzione non è responsabile del contenuto e della forma degli articoli firmati.

**Gjithë të drejtat të rezervuara** / Tutti i diritti riservati.

**ISSN 2465-1141** Jeta Arbëreshe [Online]

## Arbëreshi ka të priret t'jetë Arbëresh

Këtë herë revista mënoi të dilë, për arsye teknike. E, dhaj ndë fund të theristiut, një lip i papritur na helmoi shumë. **Frangjisk Fuska**, ka Spixana, na la gjithnjëherje, i këputur ka nj'infart. Gjashtëdhjetë e tetë (68) vjet, një jetë e kushtuar Shkollës: më parë si mjeshtër, pra drejtor didaktik, pra inspektor, pra Proveditor. Shkrimtar e poet. Pak shkruajti arbërisht, po mbi problemet e Arbëreshëve luftoi si pak. S'm'e mundi zëmra t'e falja ndë tavut: dua t'e mbanj mendë të qeshëm, ndë mes t'vallevet të Pashkës, Frasnitë. Arbëria buar një Personaxh, u bora një mik. Po jeta vijon e radhët duan shtrënguar.

**Jeta Arbëreshe** simbjete mbaron pesëmbëdhjetë (15) vjet, e, pa adunatur, me faqet e saj (2.022), ja 'rru e ja shkoi këtij viti 2016. Fat o përputhje, s'e di. Di vet se **Jeta** ecën me motin, edhe një hap përpara motit; e avlaqi ç'ajo hapi, te Bota jonë arbëreshe, është ai i drejtë, i dühuri. Kjo Rivistë stisën vatra, shtron triesa vëllazërije, bashkon Arbëri e Shqipëri.

**Arbëreshi** ka të folënj arbërisht, ka t'shkruanj arbërisht: ka të ri-marrë ndër duar, e të drejtonjë, Fëmilat e tij, Bashkitë e tij, Shkollat e tij, Sportjelet e tij Gjuhësorë; Llexhën nacionale 482/99 e ato krahinore për Pakicat. Arbëreshi ka t'priret t'jetë Arbëresh. E pra ka të krijonjë Punë për bilt e tij, me atë që nga katund ka: kulturë, zakone, tradita artixhanale; bukuri natyrore, ambjentale, artistike...

**Mëmën Tereze**, ndë vjesht e kemi Shëjte: e para shëjte shqiptare. E, pas asaj, edhe të tjerë priftra e murgj, martirë të regjimit komunist të Enver Hoxhës do të jenë lumturuar. Shqiptarët mund zënë e parkalesjën Shëjtrat e tyre. Një harë e madhe.

**Eparkia e Ungrës**, këtu e pak mot (2019), bën një Qinde vjet. Pas InterSinodit të Grottaferratës, shumë janë pritjet e shpresat. Edhe ndëse Monastiri i Grottaferratës buar autonominë dhe Eparkia e Horës nga 'greko-arbëreshe' shkau në 'anglo-italiane', ajo e Ungrës mban. Ka të mbanjë. Dhe Pastërtia e Ritit - si thot Eparku Donat - ka t'ecënj dora-dora me Gjuhët Liturgjike: Arbërishtja e Greqishtja. Tertium non datur.

Arbërisë i duhen dy mushkri: Gjuha Arbëreshe e Riti Bixantin, të ngjeshura 'një brumë' njera me jetrin. Kështu erthtim ka Shqipëria, kështu do t'na gjënjë i Gjashti Shekull, në diasporë. Trima.

**Drejtori**

**L'ARBËRESH DEVE TORNARE AD ESSERE ARBËRESH** - Questa volta la rivista ha tardato ad uscire, per motivi tecnici. E, proprio alla fine di giugno, un lutto imprevisto ci ha rattristato tantissimo. **Francesco Fusca**, da Spezzano Albanese, ci ha lasciato improvvisamente, stroncato da un infarto. Sessantotto anni, una vita dedicata alla Scuola: prima come maestro elementare, poi direttore didattico, poi ispettore, poi Provveditore agli Studi. Scrittore e poeta. Poco ha scritto in arbresh, ma sui problemi degli Arbresh ha scritto come pochi. Non me la sono sentita di salutarlo in bara: voglio ricordarlo sorridente, in mezzo alle ridde di Pasqua, a Frasinetto. Un Personaggio ha perso l'Arbëria, io ho perso un amico. Ma la vita continua e le fila vanno serrate.

**Jeta Arbëreshe** quest'anno compie 15 anni, e senza rendercene conto, con le sue pagine (2.022), ha raggiunto e superato l'anno solare 2016. Destino o coincidenza, non lo so. So soltanto che *J.A.* cammina col tempo, anche un passo davanti al tempo; e il solco che ha aperto, nella Terra nostra arbëreshe, è quello giusto, necessario. Questa Rivista costruisce focolari, apparecchia tavole di fratellanza, unisce Arbëria e Albania.

**L'Arbëresh** deve parlare in arbresh e deve scrivere in arbresh: deve ri-prendere in mano, e dirigere, le sue Famiglie, i suoi Comuni, le proprie Scuole, i suoi Sportelli Linguistici; la Legge Nazionale 482 e quelle regionali sulle Minoranze. L'Arbëresh deve tornare ad essere Arbëresh. E poi deve creare Lavoro per i suoi figli, con ciò che ogni paese ha: cultura, usi, tradizioni artigianali; bellezze naturali, ambientali, artistiche...

**Madre Teresa**, a settembre l'avremo Santa: la prima santa albanese. E dopo di lei, anche altri preti e monaci, martiri del regime comunista di Enver Hoxha, saranno fatti Beati. Gli Albanesi possono cominciare a pregare i loro Santi. Una grande gioia.

**L'Eparchia di Lungro**, fra poco tempo (2019), compirà 100 anni. Dopo l'Intersinodo di Grottaferrata, molte sono le attese e le speranze. Anche se il Monastero di Grottaferrata ha perso l'autonomia e l'Eparchia di Piana da 'greco-arbëreshe' è scivolata ad 'anglo-italiana', quella di Lungro tiene. Deve tenere. E la Purezza del Rito - come sostiene l'Eparca Donato - deve camminare manonella-mano con le Lingue Liturgiche: l'Arbëreshe e la Greca. Tertium non datur.

All'Arbëria occorrono due polmoni: la Lingua Arbëreshe e il Rito Bizantino, impastate ben bene l'una con l'altro. Così siamo venuti dall'Albania, così ci troverà il Sesto Secolo, in diaspora. Eroi.

## Spurtjeli të gjuhës ndë Katundë

**Laura Perillo**

ka Katundi (Av)

Shkoqi mot sa ka ç'kje të paran herë Spurtjeli të Gjuhës ndë Katund, nani zumbuiqi popà. Çë ka inari Kumuna Katundit ka Spurtjelin pë gjuhan, jam u Laura Perillo çë zhenj atjë. Ma spurtjelin do shomi të mbami gjuhan e kulturën si më buna, e zumë figh tua shkuaqur një ditë ma kjeturt të skoghës. Bashkë ma ata lëxhuam ndonjë kund çë thojn joshrat jona e çë nani nëng thuhan me. Kjeturt u panë të ndësuara të gjegjin kta kunda çë nëng njighin, e padën ka na një si libr të shpijn ka shpia ma atë çë bëqëm. Folëm adhe mbi Martin Camaj, pse kundat çë kunduum i mora ka një libr çë ai prufësor bëri, ku vu bashkë kundat çë i thanë kur eth ndë Katund 50 vjet prapa. Kshu kje një ditë ku ma kjeturt mbaqëm mend fatat çë thoj një herë e ata njoghën adhe embrin të njija kështer çë studhjoqi horan jona. Ki ishtë vetëm pët zemi figh, spurtjeli do bënj shumë zbisa angora pët mber gjuhan e pët mos të haromi kush jemi.

**SPORTELO LINGUISTICO A GRECI** - È passato già un po' di tempo dalla prima volta che si è avuto lo Sportello Linguistico a Greci, ora è di nuovo attivo. Da gennaio il comune di Greci ha lo Sportello linguistico: sono io, la dott.ssa Laura Perillo ad essere la responsabile. L'obiettivo dello Sportello è di preservare la lingua e la cultura il più possibile e abbiamo cominciato passando una giornata con i bambini della scuola.. Insieme abbiamo letto alcune favole che ci raccontavano i nostri nonni e che ora non si raccontano più. I bambini erano interessati ad ascoltare questi racconti che non conoscevano e a fine giornata hanno ricevuto un fascicoletto con le favole lette. Abbiamo parlato anche di Martin Camaj poiché i racconti li ho estrapolati da un libro che il professore ha pubblicato, dove ha raccolto le storie che gli hanno raccontato 50 anni fa quando venne a Greci. Così in questa giornata con i bambini abbiamo ricordato fatti che si dicevano una volta e loro sono anche venuti a conoscenza di una persona che ha fatto studi sul nostro paese. Questo è solo l'inizio, lo Sportello vuole fare ancora tante cose per conservare la lingua e per non dimenticare chi siamo.

## Si do Krishti

**Motimadh /Mario G.Miracco**

ka Shën Sofia (Cs)

Vilezëri, çë na kuqar me fjala t'ëmbra.  
Ai malli çë të fallopjasen te një e rremë e lëren se vërteta qëndron pa pjesë, është mall, është?  
Ish mall, ish dashuri?  
O s'ish ne njeri ne jetri?  
Arbëri, Arbëri, ç'i bën të kshhtëut, ti?  
Vete mir se çdo të kshhtë lodhen tue vat aprisu njëndur, kur e ëndrura s'është e tire? Si do Krishti.  
Gjindja pighet: u lodhë ingrati, ju shua linari e ra ka shkalla kadaratit kur ish i voghel? Ësht si do Krishti.  
Ka t'çonjë një virvilë sa t'ghiçë te njënderr, të jeçë katundar dy katunde, di histori, dy kultura? Si do Krishti.  
Ghap dritoren e ruaj jashtë, e çë shegh? Shegh gjitoni të mbrazura. Si do Krishti.  
Të prierat prapt ka eho fjalat ime çë kan mall, fjal të çara te një këndim me vuxhë çë nëng njogh. Si do Krishti.  
Gra çë vallzonjen çë së njogh, me sy çë rughen prapa. Si do Krishti .  
Ndë guerçi lipen shokes çë ka afer 'shih per mua', si bën t'i lipinj 'ruaj për mua', pa shtier te pisa at bukri çë ka mbrënda mbë zëmer, çë ajo ndien nd'ato fjalë? Si do Krishti.  
Me një mall i vjeter, një mall çë së do më, te cili së ndien më se një të meruam mall, çë së duket më joti; si një shpi, me derë zgardamend, vitrëjata të çara e qaramidhe të rata? Si do Krishti.  
E ato dit çë së jan më tonat, e qeshjet një e qeshem e vjeter pa kutëndic, ki i qeshem çë del ka gola si një rëkim? Si do Krishti.  
E ajo e ruejem e shuar çë ruan lartë te malat e malave trubulluar ka ret të bardha, sa t'bënjë vandi se ruan llargu, kush e di çë kërkon? Si do Krishti.  
E ai gjë çë të tjeret kin lën kundrela e ti kërkon, e skalljon e shkelen me këmbë at vërtet; e kështu të merr malli te shurbiset çë ke afer. Si do Krishti.

*Shën Sofi, 26/04/16*

## Mbledhja e zotravet, Pllatën

### Kostandin djak Bellushi

ka Pllatëni (Cs)

Të ënjtën, ndër dimbëdhjetë të majit dhe në oran nënd e gjims, u mbjodhtin Pllatën zotrat e Eparhisë së Ungrës bashkë me Peshkopin e tira, Imzot Donato Oliverio, që drejtoj e lurtmja mbledhja mëparë se verja te Shëjtërørja e Shën Marisë së Kostandinopolit dhe, pas ç' than fixat m' klishë, mbajti mendimin shpirtëror zoti Bruno Dante, drejtori i Komunitatës "Regina Pacis". Pas lutjas e skumullisës zotrat dhe Peshkopi van ka salluni e shpisë së famullitarit, papàs Ariton Ilies, dhe atje Munsinjur Donato foli për thirrjan e re e Papës Frangjisku, "Amoris Laetitia"; për harën rexhonalle e smurëturat dhe për atà që s' mënd tundan ç' bëhat Ungër ndër nëndëmbëdhjetë të therestiut; për djakërin e prof. Corduano Nicola, që mbahat Romë, te klisa e Shën Thanásit, ndër njëzetëegjashhtë të therestiut dhe për një meshë ç' thot te Klisa madha e Ungrës Imzot Donato, ndër nëndë të therestiut, në orën tetëegjims, ç' kujton peshkopin Stamati Janj, bir të Pllatënit, pas njëzetëenënd vjet ç' vat nd' qiall.

**RITIRO DEL CLERO, A PLATACI** - Giovedì, 12 maggio alle ore 9.30, si è riunito a Plataci il Clero della nostra Eparchia di Lungro con il suo Eparca, S. E. Mons. Oliverio Donato, che ha presieduto l'ultimo incontro prima della pausa estiva. Il Ritiro si è svolto nel Santuario della Madonna di Costantinopoli e, dopo la recita del Divino Ufficio in chiesa, ha tenuto la meditazione spirituale Don Dante Bruno, fondatore e presidente della Comunità "Regina Pacis". Dopo l'akoluthia della confessione i sacerdoti e il Vescovo sono andati nel salone dell'abitazione del parroco, papàs Ariton Ilies, e colà Mons. Donato ha parlato dell'esortazione apostolica postsinodale, Amoris Laetitia, di Papa Francesco; del giubileo regionale degli ammalati e delle persone disabili, che si svolgerà a Lungro, domenica 19 giugno; della prossima ordinazione diaconale del lettore, prof. Corduano Nicola, che avverrà a Roma, nella chiesa di Sant'Atanasio, il 26 giugno, e di una Divina Liturgia in memoria di S. E. Mons. Stamati Giovanni, figlio di Plataci, che verrà celebrata dal Vescovo Donato il 9 giugno, alle 8.30, nella Cattedrale di Lungro, in occasione del 29° anniversario della sua dipartita in cielo.

## Jeta e rëndë e Arbëreshëvet

### Francesco Marchianò

ka Spixana (Cs)

Kur erdhin Arbëreshët, si djovasmi ka librat të vjetra dhe ka dokumentat e arkivevet të motit, nëng u sualltin shumë mirë me gjindjat e vendit: ata vrisjën, vjidhjen, bëjën dëme të rënda aq sa zevendesmbreti i Napuljit tha se Arbëreshët kish t'jetojën mbrenda te katundet e tyre, nëng mund mbajën samare te kuelhtë e ghajdhurët e nëng mund të silljën pas me ta edhe thika! Një problem që gjet këtu, te viti 1539, zonja Erina Kastriota – stërmbesa e Skënderbeut dhe gruaja e princit Sanseverino – kanë qënë disa banditë arbëreshë! Dhe ndodhi se një grup arbëreshësh rrëmbëu disa banditë nga Strigari/San Cosmo Albanese dhe zonja Erina nëng i vuar si thonej ligja pse ata takstin të ndrojjën jetë! Dhe ndodhi edhe njeter gjë: te marci 1567 një grup me cingare/jevvgjë ngrënjën kalivet afer Kastrofilës dhe katundet arbëreshë të Frasnitës dhe Purçillit/Ejanina. Këta cingare vjedhën, bënjën dëme dhe venë ka një anë e ka njeter me arme te duartë ture kanosur gjindjat! Arbëreshët e Purçillit, që kishën pasur probleme vite më parë me zotrat e vendit të cilët thojjën se Arbëreshët ishën të keq dhe bëjën dëme, u bashkuan dhe vanë e u sultin kundër cingaravet dhe, si thuhet, i bënë copa copa! Sipas një historjani ky fakt do të thot se Arbëreshët kështu buftojën/tregonin se ky nani ish dheu i ri i tyre e se i pelqenej kjo jetë! Këta shurbise donë të thonë se jeta e Arbëreshëvet nëng qe aq e lehtë te vitet të para kur erdhin ketu, kronikat rrëfienjën se ata bënë probleme pse nëng kishën një vend ku mund rrijën, nëng kishën shpi, dhera dhe vejjën gjetkë e nëng sillshin aq mirë! Disa gjetin vend e me zotrat shkruajtjn kapitujt/"capitoli", domethënë se shkruajtjn një kundrat/marrëveshje: të parët kanë qënë ata të Shën Mitrit (1471), pas ata të Fermës (1486), ata të Frasnitës (1491), ... Me këta "capitoli", edhe se nëng ishën aq të mira, Arbëreshët u ndreqtin te jeta e re italiane.

#### **Bibliografi:**

**F. Tajani**, Le istorie albanesi – Epoca quarta, Salerno 1886 (ristampa, Cosenza 1969); **V. Librandi**, Vakarici / Vaccarizzo Albanese: genesi storica di una comunità. Famiglie, avvenimenti e luoghi della memoria, Anni 976 d.C. – 1628, vol. I, Amm. Com. di Vaccarizzo Albanese (Cs), 2006; **G. Tucci**, Memorie storico-legali dei comuni albanesi di S. Giorgio, Vaccarizzo, S. Cosmo, S. Demetrio e Macchia nelle due cause di scioglimento di promiscuità col comune di Aciri, con note e documenti storici, Cosenza, 1865.

## Shumë i bukur sa t'jer vërtet!

**Daniela Moccia**

nga Shën Benedhiti (Cs)

Një menat dolla nga mbrënda e ture ngarë në udhat e Shën Benedhitit diosava mbi një bakek e bashkisë një manifest që thoj se bashkia e Shën Benedhitit kish bërë një konkors në studhime gjithë shorshi mbi tritonin që rronë Lakiçiel; këtë ndan njetër lajme thoj se biblioteka e katundit që ka më se 4000 libra ishë e hapur tre ditë në javë. U theva: 'dy lajme të mira!'.

Ture vatur më përpara, ndë mest kurvës t'udhës, Shesh Kallvari, atje ku më parë ish një shkall e gjatë që qellij në një lllarg me dy joke kriaturshi pjet me bar të lartë nga një anë e nga njetër, nani nëng ish më shkalla po një shesh më i madh, i rritur njera ku më parë ish shkalla, me një reçincion nga ku një kriatur nëng mund shkonj e i pjet me joke kriaturshi të vënura jo mbi matune çimendi, po mbi tapete spunji e gjithë nduarnu një barorë me bar të prer të bukure. Hyria ish jo më një skall e gjatë, po një rrugarele, ku mund vehej edhe me një karrocelle kriaturshi që dilij mbi udharelën e komunit që shkon nga këtë ndan. U hipa nga kjo udharele e u gjënda përpara mullirit të "zonjës Rozë" i restaurarmër e i hapur gjindjes për të mbahet mend moti që shkoj të katundit. Ngava njera ndë mest katundit e ndën komunin ku një her ish një kamp i bandunarmër peva një kamp sportiv me bar sintetik ku ishinë e bridhinë kriaturat që më parë, sikome nëng kishin ku ka t'e bëjin, bridhinë ndë mest kryqëzimit m'i madh të katundit. Gjith një herjë gjegja një musik; hapa sit e ishnja mbi shtratë: kishnja u ëndërr...!

*(Fjutur Shënbenedhitjote)*

**TROPPO BELLO PER ESSERE VERO !** - Una mattina sono uscita di casa e camminando per le strade di San Benedetto Ullano ho letto su una bacheca comunale un manifesto che diceva che il comune di San Benedetto Ullano aveva bandito un concorso per ricerche di qualsiasi genere sul tritone che vive a Laghiccello; là vicino un altro avviso diceva che la biblioteca del comune che possiede più di 4000 libri era aperta tre giorni alla settimana. Mi sono detta: 'due buone notizie!'

Andando più avanti in mezzo alla curva di via Prato

## Një piramidë si gur kufiri

**Zef Chiaramonte**

nga Sëndahstina (Pa)

Te libri im, *La Terra di Costantino: Bizantini Arabi Normanni e Albanesi a S.Cristina Gela: fonti documentarie* (Palermo: Provincia di Palermo, 2002), transkriptova nga fondet e Arkivit të Shtetit të Palermës një seri dokumentesh ende të pabotuar lidhur me territorin e me horëzën arbëreshe të Sëndahstinit stisur më 1747.

Te njeri nga ata dokumente bëhet fjalë për një gur kufiri mbi të çilin, thotë dokumenti, ndodhet shkalisur një kriqje.

Për sa përpjekje (tentativi) pata bërë, ç'nga gjetja e dokumentit e ktej, ngë kleva i zot të gjeja atë gur, njer që rastësisht, papritur, ai më dolli përpara.

Me kureshtje u vura të kërkoja kriqjen... e gjeta!

Guri, në formë piramide të parregult, shenjon ndarjen e dy feude për të çilët bëhet fjalë te platetë normane që lidhen me katastin arab, i çili, pra, rrjedh e vjen nga ai bizantin.

Kriqja, shumë e grisur nga era e shirat, ka formë bizantine.

Calvario là dove prima c'era una lunga scala che portava in uno spiazzo con due giochi per bambini pieno di erba alta da un lato e dall'altro ora non c'era più la scala ma uno spazio più ampio ingrandito e recintato fin dove prima c'era la scala, pieno di giochi per bambini sistemati non su un pavimento di cemento, ma su un tappeto di spugna e tutt'intorno un prato di erba curata; l'ingresso era non più una scala ma una stradina, percorribile anche con un passeggino, che sbucava sulla stradina comunale laterale. Sono salita lungo questa stradina e mi sono trovata di fronte al Mulino della "Signora Rosa" restaurato e aperto al pubblico per ricordare il passato del paese. Ho camminato fino al centro del paese e sotto il Comune, dove un tempo c'era un campo abbandonato, ho visto un campo sportivo con erba sintetica in cui stavano giocando i ragazzi che prima, non avendo dove farlo, giocavano in mezzo all'incrocio principale del paese. Ad un tratto ho sentito una musica; ho aperto gli occhi ed ero sul letto: avevo sognato...!

*(Farfalla Sanbenedettese)*



## 21 fëlvar: Dita e gjuhës amtare

**Mario Massaro**

nga Qefti (Fg)

Celebrimi i Ditës së Gjuhës Amtare do të thorrë se gjuha amtare isht baza e historisë dhe kulturës të çdo njeri, dhe përfaqëson një mjet për të ruajtur pasurinë gjuhësore dhe kulturore të njerzimit, por edhe një shtitje për të zvilluar një vetëdije më e humbët të ndryshimeve kulturore në botën, vëjtur në rrezik nga globalizimi.

Drejtësia të kushullohet gjuha amtare isht një garanci themelore lirie dhe barazie të njerzvet!

Celebrimi i Ditës së Gjuhës amtare isht arsie krenarie dhe krielartësie për ne Arbëreshë, dhe për këtë duomi, të haristismi të parët tona pse na kanë lëjtur trashgimin e gjuhës e tire, edhe nëse vetëm gojor por me kaq dashuri për pesë shekuj e më shumë, dhe pse e kanë ruajtur nga brez në brez me vulnet të fort në një ambient shumë i ndryshëm për kulturë, besim dhe tradita.

Kjo lidhje e dashur dhe kokëthatë me rrënjët e tyre vjen mua thënë, për mua, se Arbëreshët kanë ndjehur një dashuri e humbët për Mëmëdheun e bjer dhe e shkelur, për prindërit që kanë lëjtur atje, për kujtesën e idhur të luftës e gjatë që kanë luftuar palodhtsisht për njëzet e katër vjet kundër Turqëvet për të ruajtur pavarësinë dhe besimin e tyre.

Në Mëmëdheun e ri refugiatat arbëreshë, tua folur gjuhën amtare, rikujtojtën trimëritë heroike dhe të lavdishme të Komandantit e tyre Gjergj Kastrioti Skanderbegi (lexhomi Rapsoditë e de Radës), këndojtën regëtimet dashurie të rinisë e tyre dhe këngët shejte, rrëfjejtën prallëzat dhe tregime, që pleqtë shpjegojnë në shpi te dimri kur ishi shumë ftohtë prëzë vatrës e çelur, për të përjetsojnë kujtesën e rrënjëvet e tyre.

Kishtu, edhe ndë ndonjë Peshkop ose feudatar i vendit ka luftuar në Kapitanatën dhe në Molizin ritin bizantin dhe ka imponuar ritin latin, mosgjë ata mund të bërën për të na nxirjën gjuhën arbëreshe, që sod isht për ne shkak krenarie, sepse u mbjet elementin e vetëm identifikimi të identitetit kulturor dhe të origjines arbëreshe.

Cili popull ka ruajtur për pesë shekuj, edhe më shumë, të folmen e tij, pa të pasur kurrë kontakte me Mëmëdheun, në një vend i huoj?

Vetëm Arbëreshët!

## Akademia Siciliane e Mitikëve

**Zef Skjiro Maji**

nga Hora e Arbëreshëvet (Pa)

Më 26 shkurt 2016 u përurua “Akademia Siciliane e Mitikëve”, me seli në Palermo. Akademia lindi më 18 nëntor 2015 në lidhje me Qendrën Ndërkombëtare të Studimeve për Mitin.

Presidenti dhe Rektori i Akademisë është Shk. e Tij Prefekti Emeritus Doktor Xhanfranko Romanjoli. Akademikët, njerëz të shquar të shkencës universitare, të drejtësisë, të letrave, të arteve e të kulturës siciliane (e arbëreshe), janë tridhjetë. Numri është i mbyllur, përveç marrjes, për pak të tjerë, të titullit ad honorem.

Bëjnë pjesë në Akademi dy arbëreshë të Sicilisë: prof. Zef Kjaramonte (albanolog, eseist, poet) e prof. Zef Skiro Maji (albanolog, poet, dramaturg, eseist).

Lajme më të gjera për “Akademinë Siciliane të Mitikëve” mund të gjenden në web duke vizituar vendin përkatës.

### ACCADEMIA SICILIANA DEI MITICI -

Il 26 febbraio 2016 è stata inaugurata l’“Accademia Siciliana dei Mitici” con sede in Palermo. L’Accademia è sorta il 18 novembre 2015 in collegamento con il “Centro Internazionale di Studi sul Mito”.

Presidente e Rettore dell’Accademia è S. E. il Prefetto Emerito dott. Gianfranco Romagnoli. Gli Accademici, personalità della scienza universitaria, della magistratura, delle lettere, delle arti e della cultura siciliana (e albanese), sono in numero di trenta. Il numero è chiuso, salvo acquisizione per pochi esterni del titolo ad honorem.

Fanno parte dell’Accademia due arbëreshë di Sicilia: il prof. Zef Chiaramonte (albanologo, saggista, poeta) e il prof. Zef Schirò Di Maggio (albanologo, poeta, drammaturgo, saggista).

Notizie più approfondite sull’ “Accademia Siciliana dei Mitici” si possono reperire nel web visitando il sito omonimo.

Për tjerit emigrante ka mjaftuor një brez për të harrojën gjuhën dhe të humbjën rrënjët e tire!

Por, ne Arbëreshët edhe sod vazhdomi t’ e ruomi kulturën e gjuhën amtare, e vlerëzomi dhe e trashgomi, pse gjuha jone ka historinë e plot e një populli i patrëmbur dhe i lavdishëm.

U thom, çdo herë marrë fjalën dhe shkruonj dogjegj për Arbëreshët, se “një popull pa histori isht si një njeri pa kujtesë!”

“Corpus Domini” në Shenjtëroren e Gjenacanit

## Shtegtimi vjetor i Shqiptarëve

### don Pasquale Ferraro

koordinator kombëtar i baritorisë për shqiptarët në Itali, arbëresh ka Ferma (Cs)

Mjetet e reja të komunikimit modern e kanë bërë veçanërisht të frytshëm këtë vit, lajmërimin vesh më vesh të emigrantëve shqiptarë për të arritur të shumënumërt në shenjtëroren e Zojës së Këshillit të Mirë në Gjenacan (pranë Romës). Numëroheshin rreth njëmijë vetë, ardhur jo vetëm, siç është traditë tashmë që prej njëzet vjetësh, nga qendra të ndryshme baritore emigrantësh nëpër Itali (katër autobusë vetëm nga Pistoia), por edhe nga vetë Shqipëria, për të kremtuar e festuar së bashku ditën e përvitshme të takimit e të lutjes, organizuar nga Fondacioni “Migrantes” i Konferencës Ipeshkvnore Italiane, pranë Virgjërës, Pajtores të Shqipërisë.

Sapo mbërritën në shenjtërore, shtegtarët u organizuan për një procesion përgjatë rrugëve të qytezës, zbukuruar me tapetet tipike e artistike, bërë me lule, karakteristike të festës së Korpit të Krishtit (Corpus Domini), duke i lartuar himne Virgjërës me këngë tradicionale të Shkodrës, nga ku, sipas traditës, ka ardhur mrekullisht ikona. Takimi në Gjenacan, për emigrantët shqiptarë, është si kthim në shtëpi për t’ia besuar Shenjtes Virgjër, me lutje korale, pasiguritë e jetës së përditshme dhe shpresat personale. Të shohësh imazhin e Marisë, tha në homeli imzot Angelo Massafra, kryepeshkëv metropolit i Shkodër-Pultit dhe kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, do të thotë t’i shohësh të bashkuara në këmbët e Zojës familjet e ndara nga emigracioni; ... “të lidhura me Virgjërën për të pasur besim në mëshirën e Zotit, veçanërisht gjatë këtij viti jubilar: ky është kuptimi i shtegtimit, kjo është shprehja e fesë së popullit tonë shqiptar, i cili, edhe në emigracion, arrin ta dëshmojë me lutje fitoren e fesë mbi vështirësitë njerëzore”. E gjithë kjo, vijoi imzot Massafra, na konfirmohet, në mënyrë gati simbolike, nga fakti se Ati i Shenjtë Françesku e nënshkroi dekretin për lumnimin e 38 martirëve shqiptarë të regjimit komunist, pikërisht më 26 prill, ditën që i kushtohet Zojës së Këshillit të Mirë, sepse kujton dukjen e saj, për mrekulli të Zotit, në Gjenacan. Kremtimi eukaristik, pas homelisë, pati një çast veçanërisht solemn dhe emocionues, sepse

## Kryetarë të rinj nd’Arbëri

- **Zhur** / Ginestra (Pz/Basilicata) – **Fiorella Pompa** e zgjedhur me 52,48% të votëvet, **kryetare e ré;**

- **Portkanun** / Portocannone (Cb/Molise) - **Giuseppe Caporicci**, me 53,09% të votëvet, **i ri;**

- **Rur** / Ururi (Cb/Molise) - **Raffaele Primiani**, me 68,82% të votëvet, **i ri;**

- **Fallkunarë** / Falconara Albanese (Cs/Calabria) – **Ercole Conti**, me 95,48% të votëvet, **i konfirmuar;**

- **Strigar** / S.Cosmo Albanese (Cs/Calabria) – **Damiano Baffa** / me 55,93% të votëvet, **i ri;**

- **Shën Mitër** / S.Demetrio Corone (Cs/Calabria/) **Salvatore Lamirata**, me 50,92 të votëvet, **i ri;**

- **Puhëri** / Pallagorio (Kr/Calabria) – **Umberto Lorecchio**, me 62,55% të votëvet, **i konfirmuar.**

ipeshkvi i dha Sakramentet e hyrjes në krishterim një çifti bashkëshortësh shqiptarë, njëra 46 e tjetri 54 vjeç.

Liturgjia e këtyre Sakramenteve në rrethanat e veçanta të shtegtimit, vuri në pah edhe një herë faktin se marrja e Sakramenteve për emigrantët tanë duhet inkuadruar në një kornizë më të gjerë rilindjeje, me shumë kuptime. Vërtet, në këtë përmasë fetare shfaqet, e gjallë ndër shqiptarët, edhe dëshira për të rizbuluar autenticitetin e tyre të vërtetë, shkelur me dhunë gjatë 50 vjetëve të regjimit komunist, kuptuar si vullnet për t’u rikthyer në identitetin e tyre si kulturor, ashtu edhe fetar, për ta bërë të dukshëm e të njohur dinjitetin e tyre njerëzor, pasuritë kulturore dhe qytetare, si edhe aftësinë për t’u integruar pozitivisht në shoqërinë e re.

Qytetarët e Gjenacanit, duke filluar nga kryetari i bashkisë, zoti F. Ascenzi, që na pritën me gëzim, vërejtën, jo pa simpati, se procesioni i Zojës udhëhiqej nga flamuri kombëtar shqiptar e shtoj këtu, se edhe kënga përfundimtare në mbyllje të liturgjisë eukaristike ishte himni kombëtar shqiptar, i njohur edhe si Himni i Flamurit, si për të nënvizuar jo vetëm ndjenjën e fortë të atdhetarisë, por edhe identitetin fetar të Shqipërisë së re, e cila, në ndjenjat e saj fetare, shfaq gjithnjë e më shumë dëshirën për t’ia besuar të ardhmen e vet bekimit të Zojës.



## Të Vjelat

Kirsa, çë duhij per të putuar vreshtan, kish dy të prera të ehjura shumë mirë: si një spatë nga një anë e nga tjetra anë ish a pjerrë si një cep qifti. Kelmrat a care e picutinat (pjesat a kalmrit të mbetur nga a ehjura) ishan shumë të mirë për të dhezjan zjarrin. Ma kizan “putojën”, presjan vallastarat tura lënë” rëparin”, një sy te vallastari më pranë kucrit e ta vallastari çë vij pas lëjan katar o pes sy. Kur një dhri u kish tharë o u kish carë, ta dhria pranë lëjan një vallastarë shumë të glatë e pa prerë (perpajné o varvajani) çë, ta a rumuart, a shtrojan, a vëjan ndën dheut e dilij ma të sprasmat di sy ta vendi ku më parë ndodhij dhria a thatë. Një grua mblidhij vëllastarët a prera, thënura “fraska o dhri”, i lidhij ma një shelq të glatë e të trash e bëj “fashunat” çë i vëj një mbi njetrit ta “sallmendari”. Ta marzi rumojan ma një shat të madh, “skauciojan”, nxirjan dheun nga kucri dhrisës, a mundunajan e bëjan “travunin” anamesa fillarëvat. Pas të rumuarit shtrojan kelmrat a ehjur, katar kelmre nga katar dhri; prana “palorjojan”, nguljan te dheu pranë kucrit një kallmë ca i pjerrë, të katrat kelmra i lidhjan bashka ma një shelq tura bënë “palarin” çë i glisij njëj piramidë. Ma spartan kannojan, lidhjan dhrinë ta kallmi. Sparta ish a thatë, çahij e për këtë, ditan më parë, a vëjan ndë ujëtë për të rripshshonij, bëhij si rrip a njomë e a butë për të mos çahij kur a priirjan. Ta prilli dhrinë “klajan”, nxirjan nga a prera një pikëzë lëngu e sythët ishan të fryjtura, të rriture e bijan përdhë kur tundjan dhrinë ma shatin e për këtë nëng ish mirë të rumoja vreshtan ta prilli.

Ta muaji majit rrjtitshjn vallastaret e lidhshin ta kallmi ma “sunxhin” për të mos ishen çarë nga një erë a fortë, “mazhojan”, ma shatin “ngauciojan” dhrinë ma dheun a travunëvat. “Rumomë kur do, po mazhomë ta maji”, thoj një pruverbë. Spëdhënjojan, nxirjan “spedhenjat” çë kishan dalur nga kucri dhrisë. Cullfjojan, shkundjan një trastë fillëzje të mbushur ma cullfin çë mbi vallastarvat mbetij si plëh. Cullfjojan adhe ma “trapedhnan” ngrah çë ish si një pombë çë nzirrij plëh cullfi.

Cullfjaturan a bëjan kur nëng frij erë për të mos dhëbirij cullfi e për të mos përvëlojan e klajan sytë. Pak gjënd a durojan këtë sherbëtirë. Pumbojan e cullfjojan më pak o më shumë herë si vej moti e si ish hria. Një djal o një grua vej ta lumi (ta përroi) ma kalin o ghajdhurin ngarkuar ma dy vuca, një “siq” e

Giuseppe Chiaffitelli

nga Mashqiti (Pz)

**LA VENDEMMIA** (seconda parte) -

La bipenne che serviva per potare la vigna aveva due tagli ben affilati, era come una scure da un lato e, dall'altro lato, era adunca come un becco di falco. Le canne spezzate e i ‘pizzutini’ (la parte della canna che restava dalla affilatura) erano molto buoni per accendere il fuoco. Con la bipenne potavano, lasciando solo una gemma sul tralcio più vicino al ceppo e del successivo lasciavano quattro o cinque gemme.

Quando una vite diventava secca o si rompeva, lasciavano alla vite accanto un tralcio molto lungo (propaggine e margotta) che, alla zappatura, veniva stesa e messa sotto terra lasciando fuori due gemme proprio dove prima c'era stata la vite secca.

Una donna raccoglieva i tralci tagliati (detti frasche o sarmenti), li legava con un lungo e grosso salice formando dei fasci che ammucciava al ‘sarmentajo’.

A marzo zappavano con una zappa grande, ‘scalzavano’ (cioè toglievano la terra dal ceppo delle viti) e la ammucciavano facendo il ‘travone’ tra i filari.

Dopo la zappatura, stendevano le canne appuntite: quattro per ogni quattro viti. Poi ‘pagliaravano’, conficcavano a terra, vicino al ceppo, una canna leggermente inclinata e legavano insieme le quattro canne con un salice facendo così il ‘pagliaro’ somigliante ad una piramide. Con la ginestra ‘cannavano’ (cioè legavano) le viti alle canne. La ginestra era secca e si spezzava, perciò, il giorno prima, la mettevano nell'acqua affinché diventasse come un laccio tenero e morbido che non sarebbe spezzata.

In aprile le viti piangevano, emettevano una gocciolina di linfa e le gemme, gonfie e cresciute, cadevano a terra se la vite era scossa con la zappa e, quindi non era opportuno zappare.

A maggio crescevano i tralci e si legavano perché non si rompessero se tirava un forte vento. ‘Masciavano’, con la zappa incalzavano le viti con la terra dei travoni. “Zappami quando vuoi, ma ‘masciami’ a maggio”, diceva un proverbio. Spollonavano, toglievano i polloni che erano spuntati dal tronco della vite. Zolfiavano, scuotevano sopra una sacchetta di juta riempita di zolfo che cadeva sui tralci dove ne restava uno strato di polvere. Zolfiavano anche con la “trapedine”, che era una pompa che emetteva polvere di zolfo. La zolfiatura veniva fatta quando non soffiava il vento affinché non si perdesse lo zolfo e non bruciasse gli occhi. Pochi sopportavano questo lavoro! Pompavano e soffiavano

nje butil të madh e, pa shkarkuar, shtij një siq ujë, një here ta një vucë e njetër herë ta tjetra njera kur ishan të mbushura. Pumbajan vreshtan ma pomban ngrah a mbushur ma 25 litra ujë ku ish losur “verdrama” e “kauçë” (polltila budullezë) e ujtë dilij nga “zhjeti” purtekës si plëh, si mjegull që lagij mirë rrush e pambëna njera brënda dhrisë. Ma një drapër të vogël o ma një gërshërë putaturi shkurttojan, prisjan kaprjolët e vallastarat të rritura e të ngjitura ma vënazat më mbi sa niaja palarit. Ta korrikuri, kur bij pak o fara shi, tërcëjojan, rumojan pë të tretan herë sa ashtu dheu i rummar nëng ndahij e nëng dhëbirij atë pak lagshtirë që adhe i mbetij Thojan pleqt: “Ujët a vreshtës isht shati”. Ta vreshta ndër dy palara mbilljan bjavë o elbë “a çuffu” mbë tufa që ta maji a prisjan (bëjan frazhnan) e ja jipjan kuelvat; bathë, vulupina, ripul grosh e fierre i mbialljan mbë tufa pe të i hajan; bathë e vulupina i mbilljan a “spalu”, a “zhjetu”e, pë të bëjan “suveshin”, i vëjan ndën dhe ta a rumùart. Kush kish vetëm vreshtan e jo dhera vëj adhe fraudha, pumëdhore, lakra, rapa, hudhra e qepë. Ta vreshta ritshin pa mbjellur labati, burdulaka, sënajeli, gjumsit, mrroj i egër e seskulit shumë të mirë; po ritshin shumë barëra ma glëmba; vambaçjelat, rrodhëzit e “bacia pied” sa ndë ti ecja xathur ta gushti të puthjan këmbët. Shumë “qandojan” fiq, gjërshi, molla, dardha vëllinj, vadha, nespul, shegë uvaspinë ftonj mënatë, shëshul mendul. Ta gushti, kur shurbejan adhe ta lëmi, zëjan të hajan rrusht a mira (rrushtë triazja) cë ishan adhe ca aguridha: menavakan, muskatin, mallvazinë, barbarosan, herdhagjelin, bërdaqin, alanëkunin, kalatamburin, alejatkun. Ta vjeshti viljan muskastin e malvazin pë të bëjan veran a bardhë e a pijan ta festa S. Alisë që a bëjan të dijtan të dielë a vjeshtit. Ta e gjëmisa shën Mitrit viljan rrushin alenëk pë të bëjan veran a zezë. Ta shën Mërtiri mblihdhan “rapcit” e bëjan “mjarkatin”. Të vapkat i mblihdhan ndë vrestat a tjerva e adhe ata viljan. Thoj një proverb: V”jel adhe kush veta pë rapca”. Nani shumë shërbëtira nëng bëhan më o janë të mekanizuara.

più volte o meno, secondo come andava il tempo, secondo le necessità.

Un ragazzo, o una donna, andava al torrente col cavallo o l'asino caricato con due barili grossi, un secchio e un imbuto; senza scaricarli versava un secchio d'acqua, una volta in un barile e un'altra volta nell'altro, fino a quando non fossero pieni. Pompavano avendo addosso la pompa con 25 litri di acqua dove era sciolto verderame e calce (poltiglia Bordoiese) L'acqua usciva dall'ugello della bacchetta della pompa come polvere, come nebbia che bagnava uva e pampini fin dentro l a vite.

Con una falchetto o con le forbici da patate accorciavano cioè tagliavano le femminelle e i tralci cresciuti e attaccati con i viticci al di sopra del nodo del “pagliaro”.

A luglio, quando pioveva poco o per niente, zappavano per la terza volta affinché la terra zappata non si spaccasse e non perdesse quel po' di umidità che ancora le restava. Dicevano i vecchi: “L'acqua della vigna è la zappa”.

Nella vigna tra i “pagliari” seminavano avena e orzo che tagliavano verde a maggio ottenendo il foraggio che davano ai cavalli.

Fave, lupini, piselli, cicerchie, lenticchie le seminavano “a ciuffo” per mangiarle. Fave e lupini li seminavano “a spaglio” per fare il sovescio.

Chi aveva solamente la vigna e non i terreni piantava anche fragole, pomodori, cavolfiori, agli, cipolle, senape, rape. Nella vigna crescevano spontaneamente portulaca, “senapiello”, lattughino, finocchio selvatico, biete ma crescevano anche molte erbe con le spine: “vampacelli” e “bacia piede”, che ti baciava i piedi se in agosto camminavi scalzo.

Molti piantavano fichi, ciliegi, meli, peri, ulivi, corbezzoli, melograni, uva spina, cotogne, giuggiole, mandorle.

Dai primi giorni di agosto, quando ancora lavoravano nell'aia, incominciavano a mangiare le uve da tavola, che erano ancora non del tutto mature: Mennavacca, Moscato, Malvasia, Barbarossa, Verdicchio, aglianicone, Colatammurro.

A settembre vendemmiavano il moscato e la malvasia per fare il vino bianco e berlo alla festa di Sant'Elia nella seconda settimana del mese.

A metà ottobre vendemmiavano l'uva Aglianico per fare il vino nero (rosso).

A novembre “San Martino” raccoglievano i “raccioppi, racimoli per fare il mosto cotto “vincotto”.

I poveri li raccoglievano nelle vigne degli altri e anche loro vendemmiavano, diceva un proverbio “chi racioppa, racimola, pure vendemmia”.

Ora molti lavori non si fanno più, o sono meccanizzati.

**Skedë Lesikale****Carmine Stamile**

nga Shën Japku (Cs)

**Frutet (pemet) e ortaxhet (barishtet) të paraverës**  
(Frutti e ortaggi primaverili)

Niespullat (mush mollat)	Le nespole
Brethezët	Le fragole
Gjërshët	Le ciliegie
Llisberxhar (kajsit)	Le albicocche
Korronxhezët të bardhë	I gelsi bianchi

Bathët të njoma	Le fave fresche
Pizilet	I piselli
Patanat të lashta	Le patate novelle
Shprëngjijt	Gli asparagi
Lluvrinjët	Gli asparagi selvatici
Qepët	Le cipolle
Hudhurat	Gli agli
Tale kukucjeli	Talli di zucca
Lule kukucjeli	Fiori di zucca
Kukucjelet	Le zucchini
Karcavecet	I cetriolini
Marrulet	Le lattughe
Palot	Erbe selvatiche mangerecce
Karçofrat (angjinarat)	I carciofi

**Frutet (pemet) e ortaxhet (barishtet) të verës**  
(Frutti e ortaggi estivi)

Brethet mali	Fragole di montagna
Pjeshkat	Le pesche
Kumbullat	Le prugne, le susine
Fiqt	I fichi
Rusht	L'uva
Kurronxhezët të zezë	I gelsi neri
Mënezët	Le more
Fiqt truqisk	I fichi indiani

Kumbadhoret	I pomodori
Peperat	I peperoni
Mollonxhanat (patëllxhanat)	Le melanzane
Brirazët	I fagiolini
Fasulet	I fagioli
Karcavecet	I cetrioli
Kukucjelet	Le zucchini
Kungujt	Le zucche
Mullunet	Le angurie
Patanat	Le patate

**Kriqja****Mario Massaro**

nga Qefti (Fg)

Ishi një herë një familje çë kishi një djalë çë rritshi ndërmes gjindëve të mira plotë me hare. Djali u rrit e u bë burrë.

Një bukur ditë kur ishën gjithë bashkë te triesa çë hajën, i biri i tha jatit:

- Ta, kisha hare ndë më jipje mua shpinë lart. □ë thua ti?

Jati si sosi muçekun çë kishi te grika e si sosi të piji qelqin me verë, fshiti buzët me stjavokën, ngriti koçën e tua varejtur të birin te faqa ju përgjegj:

-Biri im, m'i pari ke të dëçëdirinj pë këtë fat, u do di ndë ti di' t'e bëç kriqen.

Djali si e gjegji jatin, bëri kriqen. Jati e pa si e bëji e i tha:

- Jo, biri im, ti ngë di si bëhet kriqja. Ec te kisha e pjeth priftin çë t'e mbëson mirë si bëhet.

Djali rrodhi te kisha, e pjethi priftin si bëhshi kriqja e privti ja mbësoiti si bëhshi. Kur u pror te shpia, i dëftoiti popa jatit me dorë si bëhet kriqja. Jati njetër herë i tha të birin ke ngë bëhshi kishtu kriqja e i tha se te kjo herë të veji te veskuvu pë t'e mbësoji më mirë. I biri me fjalën e jatit u nda e vajti te veskuvu. Ki si e gjegji u vëh të thoji e të bëji kriqen:

- Te embri Jatit e të Birit e të Shpirtit i Shejt e kishtu qoftë.

E kishtu djali shpejt u pror te shpia pë t'i dëftoiti jatit si bëhshi kriqja. U vëh përpara jatit me shumë hare e zuri fill të bëji kriqen me dorën:

- Te embri Jatit – e ngriti dorën lart te balli.

Atëhera jati shpejt i tha të birin:

- Prit, prit! Mirë, shumë mirë kishtu.

E djali: - ...e të Birit.....- e vuri dorën te pjeti.

Atëhera jati ng'e luri të sosi të bëji kriqen e i tha:

- Biri im, e pe ke edhe kriqja thot ke jati rri lart e i biri rri posht. Ngë kimi si t'e bëmi, ka rrimi si thot kriqja. Ngë mund e ndërromi si bëhet kriqja, jati ka rrie lart e i biri ka rrie posht!

## B u k a

Jo shumë mot prapa, buka bëshshi ndë shtëpi. Buka blerë gjëndëshi vet ndë katunde të madha. Më' rpara, të bëshshi buka, kush kish grurëni e bluai; kush nëng kish grurëni, blii miellëtë, vei ndë furr, lipi ditën e kohën kur e bë t'e bëj e pas mëma, e ndonjë ka birt më të madha zën t'e bënë. Ndë shtëpi ime, buka bëshshi menatët shumë nxitu. Më 'rpara të shkoi furrëtari e të thishi 'mbrù", mëma vëi miellëtë mbrënda spumulatorë e vëi gjithë një vend, e hapi, vëi mbrënda brumtë e zëi t'e shërbej me nj'aj ujë ngrohur. Një herë shërbier, u, ime motër e madhe e shkanomë, mëma bëi kuleçët e pulikët për të pleqet e tona, i sënjoji me një kriq e pas i mbuloj të mbahëshën ngrohur ngrohur. Si shkoi furrëtari të mirri bukën e t'e shpii ndë furr për të piqëshi, mëma vei bashkë me furrëtarinë. Arrënë nde furr, furrëtari shii furrëni me një pecë lagur e pas, me lopatë vëi bukën brënda furr. Mëma mirri një parë pulike, i bëi pjese pjese e bëi puçët që hahëshin ngrohur ngrohur me një pikë valë o gjizë që djeg.

Kuleçët të bukës ishënë shumë! Kur buka ishi e njomë hahëshi me faré i madhë; kur zëi të thahëshi, hahëshi përçë kish të hahëshi. Shumë herë e kimi hëngër me pëlosh!

Di pune nëng i farronjë!

E para ishtë se që të bie buka përdhe e kish t'e mirrënje e kish t'e pastronje mirë mirë e kish t'e puthënje e pas kish t'e hanje.

Jeta punë ishtë atë se kur hanje bukën nëng kish të bënje mulike e, që të bieri ndonjë, e kish t'e mblidhënje e kish t'e shtinje ndë grikë.

Ndë atë mot, buka kishi një vler i madhë, sot buka ipët kashëve o shtihët mes t'udhës!

Tata im thishi: "Kush shtie bukën, nde jetri shekull e paguan shtretë!"

*Spumulatorë-a*, mattra; *brumëtë* (neutro), *brumë-i* (maschile), il lievito; *miellëtë* (neutro), *miellë-a* (femm.), la farina; *shkanonj*, temprare; *kuleçët*, pl. di *kulaç-i*, pezzo di pane; *pulikë-a*, pasta dolce, ma anche pane di piccola dimensione; *pëlosh-i*, muffa; *mulikë-a*, pezzettini di pane o briciole (molliche); *shekull-i*, mondo, secolo; *shtretë*, a caro prezzo.

## Lartë shkalle të Klishës

Kur inja një trimariel, më pëlqehëshi të venja ta ngarë me shoket e mia.

Shumë herë shpihëshë m lartë shkalle të klishës e madhe, ku itën rritër shume burra, që shkonë motëni ta kushëllur.

U venja afër të pleqëve që kushëllon ka e parja uerrë, që kishënë bërë e më pëlqehëshi t'i ndienja. Një ka këto të pleqe, si më pavi, më lipi: "Ti nëng je bir e këçilës?". 'Enji', ja thava'.

Ullu afër nde mua se të ka kushëllonjë ka di ungli të sat ëmës. Ti nëng i ke njohur përçë je i vogël. Këti ungle, një thërritëshi Tori e jetri Separiqi. Kimi mbetër bashkë ndë kufire ustrieke. Një ditë të dia ato vurënë poshtelartë një katundiel plotë surdate ustrieke. Kur më erdhënë e gjetër, kumamdanti im, si u prezëndotënë, buri të ngrihëshëm gjithë e të thërritëm 'urrà, urrà". Shkur njaj mot atje ku itënja u, klevënë dërgur nde njetër vend e pas njaj mot ditëm ka kumandanti im se Tori e Sapriqi, bashkë me tjera shoke të tona kishënë klënë vvarë ka bombët ustrieke. U u dëshpëlqeta shumë ashtu si u sësplëqeti kumdanti im. Tit ungle Separiqi e Tori nëng trëmbënë njari e vet bombët i bëtë vritën!"

Sosë ta kushëllur plaku, me lote ndër sire, më thavi: "Sa vete ndë shtëpi, falëm jatë nanëlë Ndoneqën. Thuaja se u jam Pjetri, miku të të vllazërve Tori e Sapariqi".

Lart shkalle të klishës, tjera kushëllon ka vreshta, ka gruri, ka ullintë e tjetër, Mua më përqehëshi të ndienja kush kushëlloi ka uerra, ka kush kishi dhënë gjellën për gjithë ne.

*këçilës*, della tale; *sat ëmës*, di tua madre; *jatë*, tua; *nanëlë*, nonna; *uerrë-a*, guerra; *gjellë-a*, vita; cibo.

**Fjalorth Arbërisht-Lëtisht****protopapas Emanuele Giordano**

albanolog ka Frasnita, Cs (1920-2015)

(vjen ka nr.77)

**I**

idhëz-a *sf.* companatico  
 ienj *v.tr.* tessere  
 ikënj *v.intr.* andare, scappare, partire  
 ikje-a *sf.* fuga  
 ikonë-a *sf.* icone, immagine sacra  
 ikonografi-a *sf.* iconografia  
 ikur (i,e,të) *agg.* fuggito, esule  
 ilë-a *sf.* fianco, lombo, lato, costato  
 ilir-e *agg.* illiro  
 ilq-i *sm.* leccio  
 im-ime *agg.poss. m./f.* mio  
 imi-imja *pron.poss.m/f* il mio  
 imtë (i,e,të) *agg.* minuto, sottile, fino  
 imzot-i *sm.* monsignore  
 indë-a *sf.* filo di lana più fino  
 indënj *v.tr.* tessere  
 inglënj *v.tr.* nitrire  
 Inzot-i *sm.* nostro Signore, Iddio  
 irëm (i,të) -rme (e) *agg.* nero, fosco; bruno

**J**

jam *v.aus.* essere, esistere, trovarsi  
 janar-i *sm.* gennaio  
 jap *v.tr.* dare, donare, offrire  
 jar-i *sm.* sposo, amante, fidanzato, valoroso  
 jargë-a *sf.* bava, muco delle lumache  
 jasht-i *sm.* il di fuori, l'esterno, campagna  
 jashta *avv.* fuori  
 jashtë *avv. e prep.* fuori  
 jashtëm (i,të) -shtme (e) *agg.* esterno, estraneo  
 jat-i *sm.* padre  
 jatër-tri/-tra *agg. e pron.indef.* altro  
 jatreshë-a *sf.* medichessa, dottoressa  
 jatrì-a *sf.* medicina, rimedio  
 javë-a *sf.* settimana  
 javòr-e *agg.* settimanale  
 jàvshëm (i,të) -shme (e) *agg.* settimanale  
 jaxhinë-a *sf.* capanna, dimora, ricettacolo  
 jëmull-i *sm.* gemello  
 jeni-a *sf.* generazione, stirpe, razza  
 jetë-a *sf.* vita; terra, mondo

**Parambote****(mbjoth) Patrizia Figlia**

nga Kajverici (Cs)

Patërnostër i gjatë  
 tata im divot:  
 - ku m'ë le Marushen?  
 - t'ë le prapa kucarit;  
 - kucari ku vate?  
 - e dogji zjarri;  
 - zjarri ku vate?  
 - e shuajti lumi;  
 - lumi ku vate?  
 - e pitin qet?  
 - qet ku van?  
 - i hungri uiku;  
 - uiku ku vate?  
 - vate prapa rahjit  
 e batirti stomahjin me një rrupaq,  
 çë ndë rahjë vate ndë qishë  
 e doli pa kumishë;  
 vate ndë qac  
 e hungri një vaxhill me tumac,  
 vate ndë një vërë  
 e shpoj bithën me një gjirpërë.

jetëgjatë *agg.* longevo  
 jetër-tri/-tra *agg. e pron.indef.* altro  
 jetësor-e *agg.* vitale  
 jetëshkrim-i *sm.* biografia  
 jetonj *v.intr.* vivere  
 jëtull-a *sf.* fettuccia, nastro  
 jëmë-a *sf.* madre, mamma  
 jìpem *v.pass. di jap* donarsi, darsi, accorgersi  
 jirë-a *sf.* angolo, cantuccio, orlo, costa  
 jo *avv.* no  
 jomëkeq *avv.* non peggio  
 jonë *agg. e poss.* nostra  
 jonì-a *sf.* armonia, sinfonia  
 jote *agg. poss.* tua  
 jotja *pron.poss.* la tua  
 ju *pron.pers.* voi  
 jùaj *agg. poss.* vostro  
 jùaji *pron.poss.* il vostro  
 judhi-u *sm.* giudeo, ebreo  
 jùstër-shtri *sm.* soldato  
 jushtri-a *sf.* lotta, guerra



**K**

ka *prep.* da  
 ka-u *sm.* bue  
 kacamitë-e *sf.* cervo  
 kaciq-i *sm.* capretto  
 kackatrumbull-a *sf.* capitombolo, capriola  
 kaçkanjollë-a *sf.* patatina selvatica, schiocco delle dita  
 kaçulëre-ja *sf.* capinera, allodola  
 kadalë *avv.* lentamente, piano  
 kadò *avv.* dovunque, donde  
 kafë-a *sf.* caffè  
 kafkäll-i *sm.* mascella, ganascia  
 kafomë *agg.* vuoto, fradicio, malato  
 kafshatë-a *sf.* boccone, morso  
 kafshë-a *sf.* besiamo, bestia, animale  
 kaheerë *avv.* da tempo  
 kakamàq-i *sm.* prigionie, carcere oscuro, catapecchia  
 kàkar-i *sm.* profondità, abisso, inferno  
 kakardhi-a *sf.* cacherello ovino  
 kakavë-a *sf.* grossa caldaia per fare il formaggio  
 kakëzozë-a *sf.* lombrico; lucciola  
 kal-i *sm.* cavallo  
 kalàrem *v.pass.* soffrire, esinanirsi, morire di fame  
 kalàstër-stri *sm.* cane giovane  
 kalàt-e *agg.* affamato  
 kàlbënj *v.tr.* far infracidire, corrompere, deteriorare  
 kalbësi-a *sf.* putrefazione, putredine, marciume  
 kalbësiq-e *agg.* fetente; discolo  
 kalbësonj *v.tr.* putrefare, corrompere, infettare  
 kàlbshëm (i,të) -shme (e) *agg.* corruttibile  
 kalbët (i,e,të) *agg.* fracido, infracidito, putrefatto  
 kalèc *avv.* a cavallo; leggermente  
 kàli-kàli *avv.* sorretto  
 kalimëre-ja *sf.* canto religioso  
 kaliqe-ja *sf.* scarpetta, ciocia, ciabatta, coturno  
 kalive-ja *sf.* capanna, stalla, abituro  
 kalonj *v.tr.intr.* cavalcare, andare, attraversare  
 kaloqe-ja *sf.* bastone di pastore, mazza  
 kalor-i *sm.* cavaliere  
 kalòsh *avv.* a cavallo, sulle spalle  
 kalth-i *sm.* cavalluccio; callo  
 kalthër (i,e,të) *agg.* azzurro, celeste  
 kaluar *avv.* a cavallo, sulle spalle, addosso  
 kalladhëpsënj *v.tr.* potare  
 kallamë-a/-ja *sf.* stoppia  
 kallàr-ënj *v.tr.* far scendere; -em *pass.* scendere  
 kàllënj *v.tr.* introdurre, infilare  
 kàllëzim-i *sm.* rivelazione delazione  
 kàllëzonj *v.tr.* rivelare, svelare riferire, narrare

kalli-u *sm.* spiga; kàllëz *s.pl.* spighe  
 kàllmër-mri *sm.* canna  
 kallogrë-a, -ja *sf.* monaca  
 kallogjër-i *sm.* monaco  
 kallonj *v.tr.* rubare; ingannare, scappare  
 kallùame-ja *sf.* furto, latrocinio  
 kàllur (i,e,të) *agg.* introdotto, ficcato  
 kam *v.aus.* avere, possedere  
 kamarònj *v.tr.intr.* avvelenare; trasgredire il digiuno  
 kamarùar (i,e,të) *agg.* avvelenato, contaminato  
 kamàstër-stra *sf.* catena del camino; intrigo  
 kambanàr-i *sm.* campanile  
 kamizollë-a *sf.* sottogonna di seta  
 kamné-a, -ja *sf.* fuliggine  
 kamnisënj *v.tr.* affumicare, annerire  
 kamnù-a-oi *sm.sn.* fumo  
 kamot *avv.* da molto tempo  
 kanakë-a *sf.* collana, ciondolo, monile pendente  
 kanàr-i *sm.* canarino  
 kanarikull-i *sm.* ghiacciuolo  
 kanarill-i *sm.* trachea  
 kanaroc-i *sm.* gola, trachea  
 kandaràt-i *sm.* cotenna di maiale salata e conservata  
 kandùsh-i *sm.* sottoveste di donna albanese  
 kangjel-i *sm.* canto, poema, canto a coro, ballata  
 kanosënj *v.tr.* minacciare, rimproverare  
 kanosi-a *sf.* minaccia, rimprovero  
 kanostë (i,e,të) *agg.* minaccioso, aggressivo  
 kapërxej *v.tr.intr.* saltare, attraversare, montare  
 kapistër-stra *sf.* capestro, cavezza  
 kapù-a-oi *sm.* cappone  
 kapurall-i *sm.* caporale  
 kaq *avv.* tanto, così, talmente; *agg.* tanto  
 kàqëz *avv.* un tantino, un pochino  
 karkalèc-i *sm.* grillo  
 karmaneshe-ja *sf.* lucciola  
 karnivall-i *sm.* carnevale  
 karpisënj *v.tr.intr.* maturare  
 karpù-a-oi *sm.* frutto  
 kartë-a *sf.* carta, lettera; quarto di moggio  
 kartuç-i *sm.* orciuolo, contenitore di vino  
 kàrthël-thla *sf.* frasca, legna secca  
 karramunxë-a *sf.* cornamusa, zampogna  
 karràqe-ja *sf.* botte da vino (da 1 a 5 qq.)  
 karrarë-a *sf.* viottolo, tratturo, sentiero  
 karròçull-i *sm.* trottoia  
 karroqàr-i *sm.* avaro

(Fjalë të nxjerra ka "Fjalori" i E.Giordano-s / është më)

**Kostantin Belluçi (Shala)**

(Shën Mitër/Cs, 1796-1867)

Poet popullor, mjeshtër qepës e rojë voshku komunal, i njohur për poezinë satirike ‘Komediantja’. Ndër 8 të vjeshtit 1860 qe krei i festavet ç’u organizuan, Napul, për hyrjen e Garibaldiit.

(Shih: *Giovanni Laviola, Dizionario Biobibliografico degli Italo-Albanesi, - Biblioteca degli Albanesi d’Italia/7, collana diretta da Italo Costante Fortino -, Ed. Brenner, Cosenza 2006, faqe 33*)

**Komediantja**

(...)

I

Po ndë gjith’ ata buljarë

kë zë fill u më parë?

Ndë vërteta qe si thonë

kam zë zotin Mikantón.

Kam bes se gjith e dinë

qé i pari që vodh shpinë.

Kur i vodh e pá Miljuci,

mbjatu e kallëzoi Tiruci.

Dish të thoi se ë ljinkùt

ndë vodh djathëra e përsùt.

Ma pse i muari shehur?

se ka ljetirja doi krehur!

Prit ahjimiz ndë kumbit

të i fjit edhe t’e ngit.

Se ndë duaj të bën ganjunë

Dreq së mund’e mban bastun. (...)

\*(*Kostantin Belluçi (Shala), ‘Komediantja’ – satyra buljervet të Shën Mitrit Koronë – përkthym italisht në vjershe prej Salvator Braile, parathanë e shënime të Gjrolam De Radës, Shkodër 1924, shtypshkroja Nikaj, Tiranë, faqe 20; Shih edhe: Girolamo De Rada, Rapsodie Nazionali - Biblioteca Albanese – Satira di Costa Bellucci ai galantuomini di S. Demetrio Corone, pag. 85.*)

**Dara Andrea**

(Palaci Adhrian/Pa, 1796-1872)

Bir i Gabriele Dara-s, studioi te Seminari arbëresh i Palermo-s e atjè u llaurear në Xhurisprudencë. U dha me zëmer pas studimevet të gjuhës arbëreshe.

**Kënkë të pleqëris**

1

Në ti do kesh bekim e orat

me njerëzit të keq mos bën përzit

duahj mirë tët ëmë, e tët at.

Kumbisu me shkop ku(!) isht shkit

Mos u math ti që së ke(!), as je(!) i bëgat

Dielli ku(!)r del ngrohën e bën drit

Llojas me tru(!) të mira ku(!)r isht nat

Me gjel e pa(!) gjel Krishti bën dit.

(...)

3

Sa(!) shërbise i mbëson i ati të birit

natnë e me drit të hilnarit

Në je(!) i Arbresh ruaju Litirit

si pelekani ruhet sqeparit

Mos të t’prien tru(!)t si Sotirit

jipja vendin ku(!) i nget të parit

Ike këshillin të keqit mirrja të mirit

se jo gjith monë qeshënë e shoqja e kusarit.

(...)

\*(*Francesca Di Miceli, I manoscritti danesi di Andrea Dara, - Albanica 19 - Salvatore Sciascia Editore, Caltanissetta 2004, faqe 98.*)

**Papas Vincenzo Selvaggi**

(Purçill/Cs, 1932-2006)

Bir mjekrari, studioi si seminarist në Badinë e Grotaferratës e pra te Kollexhi Grek i Romës, muar meshen ndë fund të vitevet '50 e qe prift bixantin për shumë vjet te katundi arbëresh i Vakarcit. Mbjoth e botoi folklor arbëresh, shkruajti edhe dica poezi me motive bestare.

**Fjalë të bjerrura**

Janë të mbëllitura diert e rruzullimit  
edhe fjalet zbardhullojen  
àthun mbi muret e lara.  
Hje të zeza zgjaten mbrëmjes  
mbi asfaltin e udhëvet  
dhe mbë kotë presnë.  
Krisje në ditën e kremtyes  
nga tregjet të banuar me zëre  
dhe mbë kotë drita  
feksen mbi theroret.  
Vdes mbi àkullin e mermervet  
martyri i Fjalës  
dhe qetsia e vetme  
mbleth lulet e jetës:  
në të cila duar po fshehet  
çmimi i Gjakut të pa-fajshëm?

\*(Papas Vincenzo Selvaggi, *Lutje* (Preghiere), Corigliano Calabro 1968, faqe 6)

**Luca Miranda**

(Purçill/Cs, 1852-1936)

Vjershtar ka Purçilli, ish i mirë të krijonej poezi popullore aty për aty, i ndihur ka fantazia, ironia, ka njohja e mirë e të së folmes arbreshe. Edhe sot poezitë e tij mbahen mendë ka pjeqtë e katundit.

**Cjè Ánxhulles Cùrrit**

Ti, Ánxhull, çë pënxon me ato tru?  
T'u qas hera ç'ke t'tramutosh shpi,  
ke t'tramutosh dhe shtratin ku je fjë,  
ke t'tramutosh katund e gjitonì.  
Ti ku m'e qellen t'bukurit çë m'ke,  
ku është katundi ç'vete e s'prire më;  
e gjellzen time nd'mes t'zjarrit m'e lë  
e zëmren time e djeg e m'e bën hì?  
Më mir një hell mb'zëmer të m'e ngùljen  
e jo ka ki katund ti më më dilje:  
se tin ishe mialt e ksàjna gol,  
nani t'u qas hera çë ke t'vësh kuror.  
Ma për sa harè të kisha u tijna lule,  
më gjith se gjith kur e ndrruar dilje,  
mua foka m'vije adur mbë trondofìle.  
U pir tij nat e dit lehenj si nj'qen  
se u pir tij i rrujunàr jam,  
se bier grasten me gjith petrasin.  
Po qani, trima, e qani gjith me lot,  
se na iken dielli çë na bënej drit:  
na èrret ditza e na bëhet nat,  
perndon Purçill e më shkepten Frasnit.

\*(ka teza e llàures të **Drejtorit**, *Poesia popolare a Frascineto e Ejanina*, 'Università La Sapienza' di Roma, 1975, ff.500-501; rrëfijati Maria Miranda).

## “Një oazë në motin”

**Italo Costante Fortino**

Instituti Oriental i Napolit

Poeti është artisti që di e dhjexasën librin e jetës me idhe të rea, orixhinale që ngasin zëmërën e njerëzve, që emocionojnë e që ndërrojnë vizionin konkret në një vizion më të bukur që helq njeriun e e ngrën në një sferë të hareshme. Shumë janë poetët arbëreshë që nga e gjymta e dytë e shekullit që shkoi zunë e bëgat ‘tin leteraturën arbëreshe moderne: një për gjithë, ju çitonj më të madhin, Vorea Ujko-n. Ka të kujtohet se ëmri vërtet i këtij poeti është **papa Minku** Bellici, nga Frasnita, që për gjithë jetën e tij bëri priftin Fermë, ku e deshtin mirë e e nderuan si poet, si njeri i vërtetë, me gjithë zakonet e keqe që mund kish, dhe një cik edhe si prift. Na e shohim nga pikëpamja e poetit e e nderojmë shumë pse na la një vepër të madhe, të bëgat, me shumë poezi të bukura, që nga herë që i dhjexasim na ngasin zëmërën e na emocionojnë. Pa shihni si përshkruan me pakë fjalë fatin e njeriut që shurben që menatet njera mbrëmanet – kështu kanë bërë atrat tanë – e që nëng vajton për shortën e rëndë, po ecën “i buzëqeshur”. Thotë kështu: “*U nise menatet / me këndimin e gjelit / e u ktheve mbrëmanet / me vajtimin e kukuvaqkës, / E gjithmonë shijet e tokës / e ti i buzëqeshur shortës*”. Kush do t’i dhjexasënj gjithë poezit e tija i gjën tek libri: Vorea Ujko, “Opera letteraria”, Studio introduttivo di Italo Costante Fortino; cura dei testi di Agostino Giordano; Traduzioni di Caterina Zuccaro, Editrice Il Coscile, Castrovillari, 2004, pp. 782.

Po i bejëm tort tjerëve poetë nëse nëng i shëngojmë fare, kështu se më duket e drejtë t’i shkruajmë, së paku, ëmrat që janë vërtetë kaq: Dushko Vetmo, Luca Perrone, Cosmo Cerrigone, Giorgio Cerrigone, Francesco Pace, Giuseppe Del Gaudio, Enza Scutari, Carmelo Candreva, Cosmo Rocco, **Vincenzo Golletti-Baffa**, Pietro **Napoletano**, Vincenzo Borrescio, Giuseppe Schirò Di Modica, Luis De Rosa, Giuseppe Schirò Di Maggio, Vincenzo Belmonte, **Vincenzo Bruno**, Francesco Fusca, Buzëdhelprì (Agostino Giordano), Pasquale Renda, Kate Zuccaro, Mario Bellizzi, Michelangelo La Luna e shumë të tjerë që mëngu kujtonj kush janë.

Po një që nëng shëngova te kjo listë, po që e kujtonj shumë mirë, është Matteo Luçiano De Gregorio. E kujtonj mirë pse më dërgoi librin e sprasëm me poezi që ai shkruajti e që siell titullin “*Un’oasi nel tempo*”, arbërisht “*Një oazë në motin*” (Munxhufuni, 2015), po e kujtonj mirë edhe pse, dica vjet prapë qemë bashkë Munxhufun, katundi i tij, e foltim për poezinë e tij. Është një poet popullor që ka shumë sensibilitet, që njeh traditën arbëreshe, gjuhën e mëmës, megjithëse nëng e studioi kurraj; me një fjalë është një njeri me rrënjat në katundin e tij, megjithëse nëng rri te katundi i tij, pse rri me shpi e me familje në qytetin Askoli Piçeno. Është një njeri që ndien se ka rrënjat te katundi i tij, se ka kulturën që thithi me qumshtin e të jëmës, që mori frymën e parë te ajri i katundit tij, që ka përpara syvet vizionat e gjithë ambientit të katundit. Nani, që shkuan dica vite, thomse shumë vite që kur ish djalë, ky njeri ato viziona i ka përpara syvet çdo ditë e i frymëzojin imaxhine, sentimente, idhe, pasione, emociione, me një vrull që e siell në motin e shkuar, që i duket, e vërtetë është, një oazë, një vend i qetë që i jep gjellë, hare, emociona të mëdha, ngrohtësi, dashuri për gjellën që shkoi e për gjellën që është e jeton. Është një njeri i ekuilibruar pse desh mirë ambientin që pati rreth kur ish i vogël e që e do mirë edhe sod, si edhe do mirë ambientin ku rri sod e njerëzt që njohu e neng janë më e njerëzt që edhe gjëllin përreth tij.

### <Hora>

Kur Mateut i mbajmë mend horën, Munxhufunin, duket se ringjallet, se bëhet pameta i vogël si një herë, vjen me thënë se “hora” nëng është vetëm një kujtim, po është një “kulturë” e gjallë që edhe sod i fjet e i frymëzon shpirtin. Nëng është vetëm nostalgji, po është një vatër që i ngrohën zëmërën e gjithë shpirtin, që i sugjeron sentimente të pastra, të forta që transformohen në poezi. Del kështu dëshira të shkruanj, të shëngonj, si mundën, poezi arbërisht dhe lëtisht, dhe pra t’i perficiononj fjalë pas fjale, me paçenxë e me një vëlimë të forte që mund e vlerësojmë më shumë vetëm nëse penxhojmë se është autodidat në të shkruajtur arbërisht.

Mateu ka një meritë shumë të madhe për dy motive: së pari pse zuri e shkruajti arbërisht kur ish burrë i pjekur; së dyti pse është nga një horë, Munxhufuni, që nëng kish një traditë në të shkruajturit arbërisht, si janë dica katunde nga Kalabria o nga Siçilja, ku u lenë e ku jetuan autorë si De Rada, si Serembe, si Dara, si Skirò etj. Ai,

Mateu, pat t'hapj ai vet udhën e arbërishtes në të folmen e Munxhufunit, ture mbësuar alfabetin dhe ture zënë fill, e u eserçitar si një fëmij që nëng di e shkruan. Për këtë fëtigë që ai bëri, e nderojm edhe më shumë për këtë tufë poezish që na dhuroi e që vjen e bëgatën kulturën tonë arbëreshe.

Kjo nëng është e para mbledhje me poezi që ai shtypën, pse në vitin 2008 na dha përmbledhjen me titull “*Kujtime – Ricordi in rima*”; pra në vitin 2012 një etër përmbledhje “*Paçfaqëshëm magji – Ineffabile incanto*”; dhe në vitin 2014 “*Una stanza nel tempo*”. Si mund vërejëm, ky mësues shkoi nga librat që fjasën për ativitetin gjimnastik në ativitetin e mendjes poetike: na pëlqen të mbajm mend se në vitin 1977 ai stypi librin me titull “*Totolino gioca a fare ginnastica*” dhe në vitin 1980 një etër libër me argument si ky: “*Attività motorie sperimentate per bambini della scuola elementare*”.

Pamja e horës për Mateun është një frymëzim i fortë; mund t’ë qasim, si imaxhinë, “zjarrmit” o “vatrës”, pse nga “vatra” e nga “zjarrmi” dalin “kujtimet”, - jeta e bukur e së kaluarës -, “dashuria”, - momentet e hareshme që mblojnë zemrën me hare -, “ëmbëlsia”, - të tërhequrit e fortë që magjepsën njeriun -, “emucionet”, - të ndiejturit e mbrëndshëm që të japin fuqi e të shkundin zemrën. Me një fjalë “katundi” o më mirë “hora”, si “zjarrmi” është si një “furorë” që të jep “sprënxën” (shih “*Un’oasi nel tempo*”, f. 69), atë “sprënxë” që është motori i jetës, që nëng bën e vdesësh kurraj.

“Horës”, vjen me thënë Munxhufunit, ai i dedikon dica nga poezitë më të bukura të kësaj përmbledhje: Mateu e ndion se gjindja është krenare për originën e saj, kur shkruan se është “*kundend ke kan rrënjërt ka Albania*” dhe si në një ëndërr “*flejën... nën kupën plot ma iles*”. Është jeta e qetë, e plotë me hare që mblon zemrën e munxhunjtvet dhe që i jep fuqinë dhe paqen për të flerë si nën kupën e pushimit të përherëshëm. Ne këtë vision plot me paq ai sheh “*memën, vatrën, / kljeshën, kambanarin*”, si edhe “*të qeshurit i ëmbël e pa mëkat / ta të parit dashuri i fëshehur imi*” (atje, f. 17). “Hora”, si edhe vetëm kujtimi i “horës” për Mateun ka një funcion terapeutike pse, kundër lodhjevet, kundër dhëmbjevet të shpirtit të jetës së sotme, i jep qetësi, paqe shpirtërore, dhe fuqi për të gjellitur mirë, me ekuilibër dhe me hare.

Mateu e di se ka njerëz që e harrojnë horën, ata që pat’ të ikin nga hora pse nëng kishin ku të shurbejnë, edhe ai vet pat të ikij nga hora e të venij në qytet, në Askoli Piçeno, kështu edhe ai njohu “*dhëurin pafjalë / të mëmërs*”, po megjithatë në mend e në zemër hora i qendron e stisur si vendi më i bukur, si “*një spiku të parajsit*”. Drama e emigracionit, që qëndron për gjithë një dramë, mund t’ë ëmbëlsojm me të mirat që Hora vlon jo vetëm në kujtim, po edhe në realitet, pse qëndron si porti ku mund të prirem të sigurtë se ai na pret e na restituirën paqen e shpirtit.

### <Malli>

Ai “*çip i vogël i Mulizit*”, vjen me thënë Hora Munxhufuni, Mateut i mblon zemrën me mall, me nostalgji të madhe, pse atje u rrit dhe ka në sy “*atë horë a qetë / e bëgat me ajrin a pyllit*”. Nëng është vetëm malli për horën, për vendin ku shkoi vitet e të rriturit që nëng harrohen kurraj, po hora është një metaforë, është metafora e fëmijës, e miqësisë dhe metafora e Zotit. Janë këto tri vlera që i gjëjm ngaherë në poezinë e Mateut, pse janë si pika që nëng tunden të ngulur fort në zemrën e në mendjen e Autorit. Gjithë gjella e këtij Poeti na rrëfien sesi ai gjëlliiti për fëmijët, për mallin që pati për fëmijën pse të bilët janë gjella e tij dhe kontinuiteti i gjellës dhe i veprës së tij. Kështu miqët për Autorin janë malli për njeriun që të rri më afër, që të ndjon dhe nëng bën e ndihesh i vetëm, janë njerëztë që, me një fjalë, të duan vërtet mirë. Në këtë vizion YnëZot, pra, është Njeriu i mirë më i madh, që ruan njeriun e e do jo vetëm mirë, po, e formon me principe të mira se të marrë udhën e mirë e të gjëndet mirë në gjithë udhëtimin e tij në këtë jetë. Kjo është viziona e Mateut për Horën e për Mallin: është viziona e një Poeti që në gjithë jetën e tij kërkoi paqen e harenë, atë paqe e atë hare që në pleqërinë e tij ai pa se Hora ja mbajti si një trizuar ture i mbajtur mend se edhe në qytet njeriu i mirë mund gjëllinj me paqe e hare, dhe se edhe në qytet mund konsideronj “*fëmijën*”, “*miqësinë*”, dhe “*Zotin*”, si vlera universale që janë baza e harmonisë së gjithë gjellës.

Poezia e Mateut është jo vetëm një të krijuar estetik, po është një të mësuar për jetën, një të mësuar së pari për familjen, që në vizionin e Autorit qëndron edhe sod pilastrit më i fortë i shoqërisë, e pra është të mësuar, arit për gjithë shoqërinë që ndërtohet, mur mbi mur, me principe të mira dhe të forta.



Mateu realizoi, edhe nëpërmjet estetikës së poezisë, mision e tij si mjeshtër në shkollat elementare, ku shkoj gjithë jetën në mes fëmijëve të vegjël, për t’i edukuar, për t’i mësuar me mjeshtëri, me ekuilibër, me humanitet dhe me shumë mall e dashuri.

Si dashuria, kështu edhe vizioni pozitiv për jetën atij i vjen nga mësimet që së pari ka pasur në familje, ku dominonij figura e së jëmës, me mësimet e saja të pastra e të forta, për të rritur fëmij me kuraxh, me guxim e me dashuri. Këtë na thonë ato pakë vargje që këtu e atje dhjavasim në poezinë e Mateut, kur flet për të jëmën:

*“Driçëma vetëm  
janë sytë të tua  
o mëma ime  
që më bën të ndriçojë  
brënda mua  
guzim e nostallgi”.*

Metaforës së Horës i qaset metafora e shpisë, ku idea e fortë është ajo e portit: si Hora është vendi ku njeriu gjën dimensionin e tij, ku ndihet i pritur e ku mund të gjëllin mirë, kështu Shpia është vendi ku njeriu është i pritur, i dashur mirë për të gjëllitur si duhet. Të dy këto dimensione humane janë si një port që është ngaherë në dispozicion e pret udhëtarët e detit t’i qasen për t’i prëjtur e për t’i dhënë qetësi, paqe e siguri. Gjegjini sa qetësi e sa hare na trazmeton kjo poezi e titulluar *“Shpia ime”*:

*“Furiqi im i vogël  
plot ma dashuri  
e ma të ngrohtë  
vetëm ti njeh  
haret  
trishtimet  
sekretet  
kujtimet  
e shpirtit tim.  
Edhe qetësit.  
Ka ti unë rëvinj  
i biruri  
e ti, mëmë,  
më tundën dipin”.*

Gjuha e Mateut në këto poezi është, më se më, ajo e Munxhufunit, vetëm këtu e atje i shpëton ndonjë fjalë që Autori merr nga shqipja. Ndihet se është një gjuhë jo elaboruar, jo e përpunuar, po një gjuhë që qëndron në livelin e të folurit, me shëngat e sforcit që Autori bën për t’ë lartësuar në livelin e poezisë. Është një udhë, kjo e poetit Mateut, që mund t’ë marrin edhe tjerët arbëreshë që duan të shkruajnë gjuhën e tyre të folur. Me të vërtetë, ture shkruar, edhe me ndonjë zbal o gabim, arbëreshi mëson si shkruhet mirë, si mund esprimen me të shkruarit idetë, espresionat që thuhet e që gjegjen në horë o në katund o në familje.

Ky libër me poezi, *“një oazë në motin”*, që shkruajti Mateu, na jep hare për dy motive, së pari se na ngrën shpirtin, ture e dhjavasur, me frymën estetike të poezisë, me forcën e artit të poezisë që i flet zëmrës e mendjes së njeriut; së dyti pse merr për dorje edhe ata që nëng dinë e e shkruajnë e dhjavasin arbërisht e i mëson, dalë e dalë, fjalë pas fjale, si shkruhen e si dhjavasen fjalët e espresionat e të folurit arbëresh.

## Distribucioni i fonemave konsonantike në të folmen e Kazallveqit

**prof.dr.Imri Badallaj**

Universiteti i Prishtinës

Grupet konsonantike në të folmen arbëreshe të Kazallveqit, të cilat po i shtrojmë më poshtë, tregojnë qartë, se distribucioni fonematik është i duarduarshëm dhe paraqet një produktivitet të shqipes së vjetër më shumë se pesë shekuj më parë.

Pra, përndarja fonematike e së folmes arbëreshe të Kazallveqit realizohet kështu:

**b+l:** blerë (comprato), bletë (alveare), bluanj (io macino);

**b+r:** brenda (dentro), brek (pantalone), breshkë (tartaruga), breshër (grandine), brazholle (braciola), brumi (il lievito), brinjë (erta, costa di monte), brumbullimë (rombo, boato), brisk (rasoio), brumrat (pasta di casa grossolana), broçë (stampella), breth (giocare), breg (collina), bres (cintura d'argento), bri (corno), brul (gomito);  
**t+r:** trut (cervello), tërkua (la corda), trieza (la mensa), tre (tre), trung (potatura eccessiva), trok (trogolo), truc (mole), trukullonj (battere), (i,e,të) trashë (spesso, grosso, doppio), train (carretto), traversë (stanga di legno), (i,e,të) tranguar (troncato), turjele (succhielli);

**p+l:** pleh (polvere), plak (vecchio), plesht (pulce), (i,e,të) plotë (pieno), plor (vomere);

plënxë (trippa), pleqëri (vecchiaia), (i,e,të) plasur (crepato);

**p+r:** prapa (dietro), prallëz (favola), pres (tagliare), pruvëlluni (il provolone), pritem (tagliarsi), prevëllë (sedile di legno a tre piedi, sgabello), prëmë (ieri sera), prift (prete), prill (aprile);

**k+l:** klishë (chiesa), klënë (stato), klinde (piega), kloqi (il baculo, il bastione), klithën (invocare), kla (piangere), klijë (chiave), klumësht (latte), klostërë (colostro);

**k+r:** krimbi (il verme), krah (braccio), krehur (pettinato), kre (rumore), krështer (kristiano), krunde (crusca), krushku (affine, parente), kripë (sale), (i,e,të) krishterë (cristiano), krehër (pettine), krimë (rumore);

**g+l:** glisht (dito), glu (ginocchio), glëmb (spina), gluhë (lingua), glatë (lungo);

**g+r:** gruo (donna), grumbull (mucchio), grurë (frumento), grosh (soldi), groshë (legume), grisur (logoro), grëhje (granchio), grië (gola), grep (uncino), griëgjer (persona che parla molto);

**gj+r:** gj(ë)ri (parente);

**f+l:** flë (dormo), fleta (la foglia), flas (io parlo), floku (la ciocca), flojerë (flauto), flutur (farfalla);

**f+j:** fjalë (parola), fjamuz (baldanzoso), fjeshtër (figliastro);

**m+b:** mbadhur (confuso), mbahur (tenuto), mbanur (impanato), mbanj (mantenere), mbëconj (infilzare), mbëkatë (peccato), mbë (sopra), mbesë (nipote), mbarë (diritto), mbiç (impiccio), mbullonj (coprire), mbulz (bolsaggine degli animali), mbushur (riempito), mba (tieni tu), mbathë (calzare), mbiazmat (stupido), mbëherë (in tempo), mbanë (la terra di là), mbaronj (finire);

**m+j:** mjasditë (mezzogiorno), mjedhk (medico), mjedhikonj (medicare), mjedhiçinë (medicina), mjegullë (nebbia), mjel (mungere), mjekër (barba), mjell (farina), mjerë (povero), mjeshtër (maestro), mjalt (il miele), mjel (mungere); mjerësi (miseria), mjekërkuq (dalla barba rossa o bionda); mjekrar (barbiere); mjalëm (addolcito); mjaft (troppo); mjalënj (addolcire);

**n+d:** ndagjagjë (qualcosa), ndanjëherë (qualche volta), ndajtur (separato), ndasuor (ingolfato);

nder (rispetto, onore), ndejtur (disteso), ndë (se, qualora), ndërtënuor (ritardato), ndrëshërë (avena, biada), ndrikullë (comare), ndurtuor (rimpinzato), ndutu (completamente, del tutto);

**n+g:** ngarkuor (caricato), nganjë (ognuno), ngarë (toccato), nge (tempo), ngjatur (allungato), ngopët (sazio), ngratë (avaro), ngrëfuor (rizzato), ngrohtë (caldo), ngruqëruor (accoppiato), nguqem (arrossire), ngusht (stretto), ngrënë (mangiato), ngridhinj (lievitare), ngusht (stretto);

**n+gj:** ngjalë (anguilla), ngjallinj (far risorgere), ngjëmuor (imbastito), ngjitur (attaccato), ngjim (imbastitura), ngjurrem (io divento rauco);

**n+x:** nxallatë (insalata), nxëvuor (unto, sporco), nxirt (innesto), nxjerr (levare), nxunonj (sognare), nxehtë (rovente), nxehem (riscaldarsi), ngjitem (attaccarsi);

**s+k:** skamandil (fazzoletto), skacamurjel (folletto), skapëtë (berretto di lana per la notte),

skacil (cisa); skollë (scuola), skarnonj (disabituare), (i,e,të) skarnuor (disabituato), skretë (fessura), skapenë

(petttine), skarpar (calzolaio), skaljernë (cardo selvatico mangereccio);

**n+XH:** nxhallambkë (imprevisto), nxhambkuor (inciampato), nxhenx (incenso), nxhin (asta di legno con due rebbi), (i,e,të) nxhënjur (indossato per la prima volta);

**t+r:** trakanjonj (tracannare), trashë (spesso), trim (giovane), triesë (tavola), tru (cervello), truq (potatura eccessiva), trok (trogolo), tri (tre), trëndafil (rosa), trapjedh (tripode), train (carretto);

**d+r:** drizë (sterpo), drahë (fondo del mosto), drapër (falce), dredhur (vibrato), dreq (diritto), dridhem (tremare), dromsë (pasta sbriciolata fatta in casa e cotta in brodo), drudhëz (piccole briciole), drugë (matterello), drinj (buttare), droqe (cavatelli), dru (legna), drudhë (briciola);

**v+r:** vroca (la forchetta), vrakë (braca), vras (ammazzare), vrëxhill (stomaco dei pennuti), vriç (brecciamme), vriskull (fiscolo), vrokëll (cavolfiore), vrërët (nuvoloso), vrocketë (cerniera dei pantaloni);

**th+r:** throni (il treppiede), thritinj (chiamo);

**dh+r:** dhria (la vite), dhrimin (crivello), dhrom (strada), dhropkë (marcio), dhrosia (cibo);

**s+p:** spalete (stipite), sparangerë (pianta dell'asparago), spartil (tamerice), spata (la scure), spëllëqun (disperato), spëllonj (pelare), spënduor (speso), spingullë (spilla), spix (ospizio);

**s+t:** staja (la stalla), stambatë (calcio, pedata), stanuor (stanato), stips (pestello), stupëll (tappo);

**z+d:** zduqi (il baule), zdënjur (indignato), zdrëlambuor (slabbrato), zdangë (stanga del carro);

**s+k:** skollë (scuola), skolë (cravatta), skretë (desolato), skallerë (varietà di cardo selvatico mangereccio), skanexh (mattatoio), skacil (cispa), skumbeçe (scapece), skunxhuor (guastato);

**sh+p:** shpia (la casa), shporta (il cestino), shprishur (sparso), shpresë (speranza), shpirt (anima);

**sh+q:** shqelp (calcio), shqep (io scucio);

**sh+t:** shtat (sette), shtie (io getto), shtip (io calpesto), shtoj (io aggiungo), shkëndilë (scintilla);

**z+b:** zbardhinj (imbianco), zbaljonj (sbagliare), zbetë (pallido), zburthenj (io sbottono);

zbrazët (vuoto), zbardhur (sbiancato), zbautirënj (spaventare);

**z+g:** (i,e,të) zgriur (strappato), zgrip (bordo), zgulfat (persona non di bell'aspetto), zgleth (io scelgo);

**z+m:** zmanirem (spazientarsi), zmaxhënat-e (mancino-a), (i,e,të) zmunduor (scolorito), zmajun (ometto), zmushënë (perquisizione), zmëçonj (sbirciare);

Në këtë idiomë arbëreshe grupet konsonantike realizohen në të gjitha pozicionet e fjalës, por në pozicion nistor dhe mesor janë më të shpeshta, sidomos konsonant + konsonant. Megjithatë, leksiku i arbërishtes së Kazallveqit realizon edhe konsonant + konsonant + konsonant, çfarë do të thotë, se edhe trekonsonantshi gjallon brenda këtij fjalësi, por denduria e tyre është më pak e shtrirë:

**f+sh+t:** mundafsht (filo di seta);

**m+b+j:** mbjell (seminare);

**m+b+r:** mbrum (impasto, pasta) // Mbrumi i ardhur – Impasto lievitato // Sod hami ca mbrum shpie – Oggi mangiamo un po' di pasta fatta in casa //;

**n+d+r:** çëndruni (grosso chiodo ripiegato ad angolo retto dal lato della testa per legare una corda per stendere i panni lavati);

**n+g+l:** (i,e,të) nglatur (allungato);

**n+g+r:** ngrohtë (caldo) // Mbaje ngrohtë – Tienilo in caldo // hëngra (mangiare) // Hëngri duorit – Si mangiò (si rose) le mani // E hëgri krimbi – Lo ha rosato il verme //;

**s+k+j:** (i,e,të) laskjuor (diradato, sfoltito);

**s+t+r:** strepe (spaccatura di terreno arido e asciutto);

**sh+k+r:** (i,e,të) shkretë (desolato, povero);

**sh+p+l:** (i,e,të) shplarë (risciacquato);

**sh+p+r:** shpresë (speranza), (i,e,të) shprishur (sparso) // Gjaku i shprishur – Il sangue sparso (espressione usata degli arbëreshë per indicare la diaspora albanese) //;

**sh+t+r:** (i,e,të) shtridhënj (strizzare), shtrat (letto);

**z+g+r:** (i,e,të) zgrënuor (affaticato);

**z+m+ b:** (i,e,të) zmbuluor (scoperto); etj.

**Rreth një kënge popullore arbëreshe: “Shkoi një trim ka një rugh”****dr.prof. Merita Sauku Bruci**

Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

Arkivi i Institutit të Gjuhës e Letërsisë (Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë) ruan ndër të tjera edhe *fac simile* të dorëshkrimeve të shkrimtarëve arbëreshë, dhuruar ndër vite nga biblioteka apo studiues të ndryshëm. Nën siglën GJ/5, nr.129 (arka 4, kutia 1) mund të njihemi me dorëshkrime të Bilotës, Krispit, Kamardës, Mikel Zanfino Bushatit, Varibobës, Bafës, Santorit, Serembes. Rruga që kanë ndjekur këto *fac simile* nis nga Biblioteka Mbretërore e Kopenhagenit ku ndodhen origjinalet, kalon nga Prishtina për të përfunduar në Arkivin e IGJL. Në faqet 429-430 të këtij blloku ku janë lidhur dorëshkrimet e mësipërme, hasëm një këngë popullore arbëreshe pa titull, por vargu i parë i së cilës është: *shkoi një trim ka një rugh*. Për dikë që ka lexuar me vëmendje *Rapsodie di un poema albanese* (1866) dhe *Rapsodie Nazionali* (1883) të De Radës, nuk mund t’i ketë shpëtuar shënimi që ky i fundit bën për këngën në fjalë:

“*Mio Santori,*

*Jer sera ricevei i due canti popolari che mi rimetteste: Shkonj një trim k̄a një rugh e Ajo zonja e r̄e e Gjikk̄s, il quale ultimo è per la mia raccolta oggi un prezioso regalo; oggi che una figlia dei Gjicca albanesi, nata ne’ principati rumeni, Dora d’Istria (principessa Coltzof Massalsky) attrae a sè gli sguardi simpatici della colta Europa ....”*. Për të lexuar letrën në plotninë e saj shih: [De Rada 1866, 79-80].

A mund të ishte kjo këngë ajo për të cilën bën fjalë De Rada? Nëse po, përse variantet e botuara prej De Radës ndryshojnë në shumë elemente prej atij të Santorit?

Duke ia lënë një momenti tjetër qasjen filologjike e variantistike ndaj problemit, po mjaftohemi të shuajmë kuriozitetin e lexuesve të revistës *Jeta arbëreshe*, duke e sjellur këtu këngën në plotninë e vet. Ky variant i mbledhur/ shkruar/përpunuar nga Santori botohet për herë të parë nën transkriptimin tonë:

Shkoi një trim ka një rugh  
 Me frushërëzen ndë dorë;  
 Ju përpoq je bardhullorë  
 Kuqullorë, e bukurë keq  
 Një kopile mes gholle.  
 Nkrëjti ai frushërëzën  
 E m’i nkau këshetëthin.  
 Ntodhi e jëma ndë dritësore,  
 Pā çë bëri trimëthi,  
 muorë ajo t’i thoj atij:  
 “Trim çë nkave timen bil,  
 Mos nk’e dije, xëje ani,  
 Ësht kjo gruaja jote”.  
 “Ndo s’k̄a pal si t’e dua?  
 Taksëm palën e je marr”.  
 Palën i taksi jëmëza.  
 I vū kez diellin,  
 Prë vantilje ghënëzën  
 Prë stol̄i ilëzit.  
 prana trimit ja e dërgoi.  
 Trimi e muori duorshi  
 Më je qelli ndë pëllas  
 Më je uli ndë një thronë

Ndë të jetrën uli vet.  
 Pa zū grollë të m'e porsij:  
 “Se je bukurëza ime,  
 Ësht i gjerë kī pëllas,  
 Ësht i gjerë e është i thellë  
 Sa i lart, edhe i gjat.  
 Kā njëzet e pes dritësore,  
 Me njëzet e pes llombardha.  
 Ka të shtunë ti m’i tagjis  
 M’i tagjis e m’i potis,  
 Ka të diellë m’i nëmëro.  
 Një i vet çë të mankonjë  
 U pa gjellë, e tij pa shoq  
 Nje bën’e qëntronjëmi.”  
 Vasha me një kurë të madhe  
 Vej e vij ndë dritësore,  
 Po të shih llumbardhazit  
 Erdh je diella manat;  
 Zuri fillë t’i nëmërōj,  
 më e mira ji mankoj,  
 Krie bardha pent ërgjënta.  
 “Popo! Popo! Fanë i keq”  
 Thirri vasha je helmore:  
 “Çë t’i thom u timit zot  
 Kurë të vinjë ndë mbrëmjet?”  
 Erth je mbrëma e zoti i saj  
 nënk u duk, e nënk u mbjodh.  
 Vasha qajti e më ju nkeq.  
 Priti ashtu javën e parë  
 Helëmore, e merëngore.  
 Kurë je dita diellë arvoi  
 E llombardhat nëmëroi  
 Më mankonej jetëra.  
 Mbjatu ajo e kuqja.  
 Ndë njëzet e pes jav  
 Njera pas jetërën  
 Gjith llombardhat u spovisëtin  
 E je mjerëza kopile  
 Prë rëkim e prë shërtim  
 Çë më bëri nd’ aq mot  
 Dit prë dit më u nkeq  
 Si qiria tek lartari.  
 Pak e pak m’u gris e u shua.  
 Pati pllasin prë varr  
 Qiramidhet prë mbuluome  
 Qatërë e gjerë, motin të gjat.  
 Pllasi qe më vjet i shkret.

*(Tiranë, maj 2016)*



## Fjala e besa ny AMK 9 (Shi'Nikoh)

papa Janni Giudice  
nga Shën Kolli (Kr)

1. Kio analizh shyrbehët kka Konferenca çy Gangkali çy boony pyr romançin ny Grigionet (Zvizzera). Mbi gjuhys (fjalys) ty AMK 9 te vjetit ty Shtaty dhjetit ty kjindarit çy ka shkuer, ka shkruer gjagjò ny “Lingua arberisca restituenda”; Ati gjuha ngky ka vdekur, po oshty “ipertrofica” e ndrashur kka fjalit lytinjy. Ny Gridjionet shihyx se lipsex besa, ajo “naturale” e ajo besetare. In amk 9, ndai gjithy (ny pyrgjythyse) oshty ngy besy (besim) si kremtme, pa zhomyr.

2. Te viti 1700 hora ka pasur ngy çensury “papi”; ngy peshkyv i ka syrritur: “Ty rremyt ty gjithy”; kka viti 1930 njer 1949, peshkvi i Kariatit ngky ngka ka vony komby te hora pyr ngy shyrbesy i egkyr; zh. Zhef Nigro (i Zhi) ka passur ngy “shkafy” ny sheshi i horys. I poshkrueri, me gjithy se ka dhony kurmin e zhomrin, ka passur ngy kontestazion kka veta ty etur mundsije e turesi pysé kishin bjerr zhjedhiet. Peshkyvi, kkur i kemi kyrkuer shkakkun: “Ngky kam gjagjò sa ty ty kjortoj; ndai me tix ty shyrberit tond...jaany ghijmuer se kremton (parakalesin, lutin) te e folja arbyriste etj.). Ngy kallogré sr. V., kkur ghijmoneja pyr vyshtirysit: “Popo. ti ddeje ty gjeje besy ndyr arbyreshyt? - Kredenzialet tona: i ller te hora, fjas mir gjuhyn tyme çç’e ka mysuer pyr shumy vjety, dzones kka ty Gangalit. Shumy ty nismat (nisurat) çy kemi boony sa ty jipjim ngy ty ndihur ty shpitimyt ty gjuhys; ndyr kyra ngy ditir i matur (urt) dhe shkaghzyer pyr ngy e ddhuhur inversion gjuhje. Ki dytir ka kjoony i pohuer kka “Sinodi” i dioçezhis. “Gadzetta e Mjezhditys” gjaty Sinodhit ka shkruer: “Ty thonyt mo ty interessant e çy bie gjagjò ty ri ka kjoony ata ty famughitarit zh. G. G. sa ty kremtohet leiturgjia te gjuha arbyreshe.

3. Shpitimyt i ty foljavet (gjuhavet) ty pakizzavet istorike e ddo “Kostituzionat” e Italjes, e ddo Europa, e Krahina (rrethi), po mo se mo, Konçili i Vatikantit II, çy ddo se kremtimat (çelbrazionat) kety bohen te gjuha e gjindies (e polemity), pysé fjala e besa jany ty dhillura. Papa Françishku te “Evagelii gaudium”, schruen: “Kjisha oshty momy e mysony (fjet, laimron) polemit si ngy j’oomy çç’i fjet ty birit. Pyr kyta, leçitja e krishtery, te zhmyra e kultures e gjindies gjen ngy krua uji çy mburon, kax sa ty ddingy çy kety thoory, kax sa ty gjenjy maneryn e ddhury sa t’e bonjy. Si gjithy neve na pyrkyehet sa ty na fòlet

### PAROLA E FEDE IN S. NICOLA DELL’ALTO (AMK 9)

1. Questa analisi segue la conferenza svolta da Gangale per quanto riguardava il romancio nel Grigioni (Svizzera). Sulla lingua (parola) di AMK 9 degli anni Settanta del secolo scorso, lo stesso ha scritto qualcosa in “Lingua arberisca restituenda” ove la lingua non è morta, ma è ipertrofica (albanesizzazione delle parole italiane). (cfr “Per Paradigmata” ad grammaticae amk 9 Cnatus”, ad “Arra-Buka” (apprendimento di primo livello”, a “Burragnet e horys”, a “Llulle e Bubukje”). Gangale nel Grigioni notava la mancanza di fede, naturale e religiosa. In amk 9, in genere, si ha una religiosità festaiola e senza interiorità.

2. Nel 1700 il paese ha ricevuto una censura pontificia; un vescovo li ha definiti “falsi e bugiardi tutti; dal 1930 al 1949, il vescovo di Cariati non è potuto entrare in paese per un fatto violento; d. Peppino Nigro ha ricevuto uno schiaffo in piazza. Il sottoscritto, pur avendo dato corpo e anima, è stato soggetto ad ignobile contestazione da soggetti bramosi di potere e di denaro che avevano perso le elezioni. Il vescovo, alla nostra domanda di conoscere le motivazioni: “Non ho niente da rimproverarti; condivido il tuo operato...si sono lamentati che celebri in albanese ecc.”. Una attempata suora sr. V. ai miei scoramenti per le difficoltà: “Ma tu vuoi trovare religione tra gli arbyreshy?”. Credenziali nostre: nativo del luogo, conoscitore e studioso della parlata locale, discepolo di Gangale. Tante le iniziative messe in atto per dare un contributo alla salvezza della lingua; fra le quali un prudente e graduale impegno per una necessaria inversione linguistica in chiesa. Tale impegno è stato approvato dal Sinodo diocesano. “La Gazzetta del Mezzogiorno” durante il Sinodo ha scritto: “Il più interessante ed innovativo intervento è stato quello del parroco di S. Nicola, d. G.G. sull’uso nella liturgia della lingua albanese” (a senso).

3. La salvezza delle parlate delle minoranze storiche è richiesta dalla Costituzione italiana, dall’Europa, dalla Regione, ma soprattutto dal Concilio Vaticano II, che vuole che le celebrazioni avvengano nella

te gjuha e momys, kyshtu edhe te besa, na pyrkjehet sa ty na folet me kjiçcin e “kulturyr e sotme” (moderne, e motit ty ri), ny kjiççi i ty foljes e jomys (cf 2 MaK, 7,21.27), e zhmra hapet sa ty gjegjinjy mo miiry. Kio gjuhy ka nry tonalità çy jep zhomyr, friimy, fukji, vrugh (“Evangelii gaudium”, bisedimi i nry jomje, EDB, p. 67).

4. Py ty kyrkuerit mbi beses ty “Grigionavet” (na thomi ty AMK 9), Gangali shkruen: “Te kyrkimet toona vemi kka pika e besys te ajo e fjalys, kka “pyrmbajtja te forma” [...] Ati gjenen shumy pakky gjurma ty nry gjoghje besje e mbrondme, ty tipit “besje e naturme e ndai mosnjò “ty tipit “besje e zbuluer” ny forma pietistika-mistika, as ny forma e miryfighte e Bibjes. Kyta ty lipsur ty gjoghje besje kety shihet mo se mo si nry ty lipsur i vyrtety e gjo si nry ty lipsur çy dduket vet”. “Dhe letyrsia ty nry polemi (gjind’je) ket vrehet (shikohet, shkjirohet) si nry simbuhy psikolodjik ty asax gjind’je”, kka hora çy jemi çy fjasmi, mumi ty thomi kjetysisht se ngky njohmi mosnjy vepyr e botuer kka shkuetary “popughor” (ty polemit). Kongkat popughore gkojore ngky kany nulla pyrmbajtje (kontenut) besje. “Ty fali Ridjina e kjiaghys” e marr hue kka Variboba ka kjoony e “kalabridzartur” e shkatyrruer. Vaghet, ty thoono o ty kynduera, pa ty ddigkohet ata çy thuhet. “Hipu vasha ty m’e shkundi” (lissin) u bo: “Hipu maçça te mashkù” e kytù ngka njo thoty si do. “Kush na ka boony?”. Ty pyrgjegjurit: “Krishti”. Gjithy statujat jany boony “Shumbri” (kka shyn Myri) etj.

5. Nry zhony me vjety çy ka nd’jekur kjishyn çy kkur ishy vaizharelle e njeh gjithy konkat, kkkur na laimrojim ty prasmyn ringjaghie e ty vdekuravet o’ pyrgjegju kyshtù: “I ddashur, u kam pasur e kam besy te gjithy atà çy my kaany mysuer llallzhotrat (priftrat), po te kytà ngky kam besy (besoi)”. Si te “Grigionet”, oshty shumy e madhe krizha e laimytaravet, te bashkesia e arbyreshe. “Famughitaary e laimyaary (ty dyrgkuer kka peshkjit e ty pagkuer), veçç se zhblonjin (kaghyzhonjin) krizhyn, t’e dдинin e pa t’e dдинin, e kany ndihur (pruuny) ata”. Edhe atà pakk priftra kka hora kaany nikokjirtur e ligjeruer lytisht. Ny seminariet, ny pyrkjikiet ty dioçezhany e dzonal nky ka kjony ndo nry hery rrahur ki problem. Gjindia shprehin gjoghin e sax te gjiuha e sax. Famughitaaryt, kkur jaany ty dyrgkuer ny nry famughi me gjuhin e kulturin e arbyrishy ngky

lingua del popolo perché “parola e fede” sono collegate e la lingua materna è una. Papa Francesco nella “Evangelii gaudium”, scrive: “La Chiesa è madre e predica al popolo come una madre che parla al figlio. La predica cristiana, pertanto, trova nel cuore della cultura del popolo una fonte d’acqua viva, sia per sapere cosa si deve dire, sia per trovare il modo appropriato di farlo. Come a tutti noi piace che ci si parli nella nostra lingua materna, così anche nella fede, ci piace che ci si parli in chiave di “cultura materna”, in chiave di dialetto materno (cf 2 Mac, 7, 21.27), ed il cuore si dispone ad ascoltare meglio. Questa lingua ha una tonalità che trasmette coraggio, respiro, forza, impulso” (“Evangelii gaudium”, La conversazione di una madre, EDB, p. 67).

4. Per le ricerche sulla religiosità dei Grigioni (noi diciamo di AMK 9), Gangale scrive: “Nelle nostre ricerche andiamo dal punto di vista religioso a quello della parola, dal contenuto alla forma [...] Qui si trovano pochissime tracce di una vita religiosa interiore del tipo “religio naturalis” e quasi nessuno del tipo “religio rivelata”, né nella forma pietistica-mistica, né nella forma d’osservanza letterale della Bibbia. Questa mancanza di vita religiosa deve piuttosto essere considerata come mancanza effettiva e non come mancanza apparente”. “Se la letteratura di un popolo deve essere considerata come simbolo psicologico di quel popolo”, possiamo tranquillamente dire che per il paese in questione non conosciamo nessuna pubblicazione di autori popolari. I canti popolari orali non hanno nessun contenuto religioso. La “Salve Regina” mutuata da Varibobba è stata calabresizzata e rovinata. Le vaghe (Vallje) recitate o cantate senza comprensione. “Hipu vasha ty m’e shkundi” (sali la ragazza per scuotere (l’albero di mele) è diventato: “Hipu maçça te mashkù” (Sali la gatta...e qui ognuno dice la sua). “Chi ci ha creato?”. Risposta: “Crishti!”. Tutte le statue sono diventate “Shumbri” (da Shyn Myri, Santa Maria) ecc.

5. Una anziana signora che ha frequentato dalla fanciullezza la chiesa e conosce tutti i canti, alla nostra proclamazione della risurrezione finale si è espressa: “Caro, io ho sempre creduto a quello che mi hanno insegnato i preti, ma a questo non posso credere”.

Come nei Grigioni, è grandissima la crisi di predicatori, nella comunità arberisca. “Parroci e predicatori (mandati dai vescovi e pagati), oltre a

njohnin gjuhën arbyrsihy, ngky kany nÿj terminologji teologjike e perpiqty (prery); “jaany si nÿj zheitar (artidjân) çÿy kety shyrbex pa vegkyl (ndzonjy)”. Ty folurit e tire oshty dialekti kalabrisy-lytisht, gjuha e momys e tire, e lygjeronjin me kyto.

6. “Bukky” ngk’oshty nÿjo me “pane”. Ddomi ty thoomi se oshty shumy ndrishim ndyr gjuha momje e jetrat gjuhy. Kremtoja meshin ny arbyrisht e ddi merikany pypara te vjetyt, bix ty emigrantave, my vrejÿn me sity ty ngkulur e kjeshjin. Kkur o sossur mesha i kam pie: “Pysé kjeshjit?...Mi kjeshjt (shajin) mua?”. Jany pyrgjegjur te gjuha joony: “U kam shtaty vjety e jaamy ller Brookulin; tata e moma ishin kka Shi’ Nikoghi, e fjitjin nteru gjuhÿn tony e horys e uren kam folur (fjassur) nteru kyshtu. Edhe kuççinellit (kuççkarelles ) i fjitjim nteru kyshtu. U kjeshja kka harea pyse gjegjÿja gjuhÿn e t’atys e t’ momys (e prindravet) e kam ddigkuer gjithesei, e kam shkuer “mumentë” (çastje) çÿy ngky mund harrohen”. Njetyr zhot: “My kany shpituier loty ty gjegj’ja meshin, fjalyt e konkat e ty foljes time. Ngky my kysh ndodhur ndo nÿj hery e kam ddiguer gjithsej”. Kka “Belgi”, e bija e Ghatanit O., pypara te vjetyt, atjé çÿy kkur ish e vogkle, my kyrkox ndonjy ghipyr kka hora e sax. Vuax (dhimbex) ty fjitx lytisht. Kkur pra ka gjegjur nÿj fjaly te gjuha joony, gjthy haré ha fjassur sa ndo nÿj gjimys orje, e gk’e sosyx mo. E kax matrirat ty shkuera te ghibri joony “*Fjala e besa*” e te jetryt shyrbierja tona.

(*Gjaton*)

rivelare la crisi, coscientemente o inconsciamente, l’hanno procurata”. Anche i pochi sacerdoti locali hanno amministrato e predicato in italiano. Nei seminari e negli incontri diocesani e zonali non è stato mai affrontato tale problema. Il popolo esprime la sua vita nella sua lingua. I parroci quando vengono mandati in una parrocchia di lingua e cultura arberisca non conoscono la lingua albanese e non posseggono una precisa terminologia teologica; “sono come un artigiano che dovesse lavorare senza attrezzi”. Il loro linguaggio è il dialetto calabrese-italiano, loro lingua materna, e predicano con questo.

6. Differenza tra bukky e pane. Intendiamo dire che c’è grande differenza tra la propria lingua materna e le altre lingue. Celebravo la messa in arberisco e due anziani americani, figli di emigrati, mi guardavano fisso e sorridevano. Finita la messa ho chiesto: “Perché sorridevate?...Mi prendevate in giro?”. La risposta è stata in arberisco del paese: “Io ho sessanta anni e sono nato a Brooklin; i miei genitori erano di S. Nicola, e parlavano sempre la nostra lingua del paese ed io ho sempre parlato così. Anche al cagnolino parlavamo così. Io sorridevo dalla gioia perché sentivo la stessa lingua dei miei genitori ed ho capito tutto; ho vissuto momenti indimenticabili”. Un altro signore: “Mi sono scappate le lacrime a sentire la messa, le parole e i canti nella mia parlata. Non mi era mai capitato ed ho capito tutto”. Dal Belgio, la figlia di Gaetano Oliverio, ormai anziana e lì da piccola, mi chiedeva qualche opera del suo paese. Stentava a parlare in italiano. Sentendo una parola nella nostra lingua, felice e contenta ha parlato per circa mezz’ora; e non la finiva più. E tante altre testimonianze accennate nel nostro libro “Parola e fede” e negli altri nostri lavori (34).

(*Continua*)

Mbi poezinë e Zef Chiaramonte-s, nga 'Postfazioni' të librit

## Kaq pak dhe kaq shumë

**dr. Alisa Velaj**  
Universiteti i Durrësit

Kaq pak dhe kaq shumë janë përcaktimet që më vijnë ndërmend, pasi mbaroj së lexuari vëllimin me poezi "Vulë uji" të Zef Chiaramontes. Përcaktimi i parë ka të bëjë me numrin e poezive, ndërsa i dyti i përket cilësisë së teksteve poetike, ku pulson një jetë, e shtrirë në tri dimensionet thelbësore të dashurisë. Para së gjithash vjen lirika dashurore, në të cilën poeti shfaqet si një nga zërat më të formuar të lirikës erotike arbëreshe dhe asaj shqipe. Përjashtimi i thekur i titullit të këtij vëllimi "Vulë uji" e ka zanafillën e vet në lirikën erotike me të njëjtin titull. Sipas Erik Fromit, uji mbahet si simbol i përjetësisë, i gjendjes vitale, po i një gjendjeje më të ngadalshme, më të qetë sesa eksituese. Vetinë e fundit, eksitim, e përmban pikërisht zjarri<sup>1</sup>. Nga njëra anë uji si simbol përjetësie, e në anë tjetër, dashuria si ndjenjë që e lë vulën në shpirt, duket se e ka shtyrë poetin që krejt vëllimin ta bashkojë nën këtë titull, i cili pranëvendos dy fjalë sa antonimike në formë, aq edhe sinonimike në thelbin e vet konotativ.

Dashuria është burimi i jetës për poetin tonë. Kujtimet për të vijnë përmes një nostalgjie, ku diçka mbetet përherë pezull, e parealizuar, një gjendje ëndrre, e përcjellë kjo e fundit në vargje ku mjegulla duhet shpërndarë me shumë kujdes, për të parë se çfarë fshihet brenda saj. Dashuria, edhe pse kështjellë që arrin të pushtohet për një kohë jo të gjatë, është përjetësia që bashkon të shkuarën me të tashmen dhe hedh dritën kah vizionet e ardhmërisë. Poezi të tilla si: "Ëndërr", "Shtëpia e ëndrrave", "Shenaj" "Shtatori", "Vulë uji", "Ti", "Pelote" dhe "Mavrotissa" vijnë si lirika thellësiht moderne, me një gjuhë eliptike e të përpunuar deri në kufijtë e përsosmërisë, ku mesazhi përkapet nga një lexues elitari i poezisë. Është loja e pangopur e ujit dhe e zjarrit, siç shkruan poeti, që i bën këto lirika sa drithëruese, aq edhe të thella për nga mesazhi që përçojnë. Në to janë shkrirë si në simbiozë, fryma e lirikës erotike arbëreshe dhe pikëllimi i skajshëm leopardian, duke krijuar imazhe me thellësi e tejdukshmëri uji e eksitime të zjarra që vijnë prej përjetimesh sa shpirtërore aq edhe erotike. Përjetimet fizike kanë pra vetinë e zjarrit. Ato e turbullojnë subjektin lirik gjer në kufijtë e një tërmeti, e shkulin qenien nga themelet, duke i krijuar turbullira të njëllojta, pavarësisht largësisë kohorë të përjetimeve reale.

Largësia thjesht e ka kthyer zjarrin në prush, e mjafton një kujtim i beftë, apo një rishfaqje e së dashurës, që prushi të kthehet sërish në zjarr. Subjekti rikrijon të njëjtat imazhe dhe pengu i së kaluarës ia trazon pandërprerë të tashmen. Dikur dhe sot duket se vijnë si kohë e njëjtë, pasi ato kanë një sinor të përbashkët, pezullinë. Vonë dhe herët shfaqen e rishfaqen si e tashme e përhershme. Kjo e fundit e bën poetin Chiaramonte një nga pijetarët e kupës poetike të poetit të madh arbëresh, Zef Serembe.

*"si Zonjë e dalë nga përrallat arbëreshe  
papritmas m'u fanite  
një mëngjes gushti  
në Akatllar / Aktash  
sapo u zgjova"*

(Shenaj)

*"herën e tretë  
erdhe vonë  
herën e katërt  
papritmas  
u nise herët"*

(Pelote)

Lirika patriotike këndon me lahutë fatin tragjik të genit ilirian prej netëve pellasgjike e deri në bashkohësi; Arbëria e Siçilisë, arnautët nën Perandorinë Osmane, Kosova me lirinë e saj të mohuar dhe Tirana rrugëhumbur diktatoriale. E mes gjithë këtyre fateve tragjike shekullore, një mesazh dashurie përmes figurës së një shqiptareje të madhe si Nënë Tereza. Dashuria është kryefjala që rilind një komb për poetin arbëresh. Dashuria do të bëjë që vendet e takimeve tona të mos jenë më gurë kufiri të pakaluar, pasi një zemër e ngjizuar me dashuri është në gjendje të kapërcejë çdo lloj kufiri.

*“Arnautë u linde  
në Perandori osmane  
hebrenj muslimanë  
dhe ortodoksë  
jevgj shqiptarë  
dhe grekë  
turq maqedonë  
dhe kroatë  
serbë bullgarë  
dhe rumunë  
i pate vëllezër  
i pate motra”.*

*(Teresa Gonxhe Bojaxhiu)*

Dimensioni i tretë i dashurisë vjen përmes lirikës intime, me poezi të ngrohta për Zotin, nënën, zonjën dhe dy bijat e poetit, Donikën dhe Ksenjën. Drita e këtyre dashurive vjen përmes simboleve të tilla të folklorit arbëresh a atij shqiptar si dielli dhe hëna, apo dritës së pashtershme hyjnore, për të cilën poeti trishtohet, që ne qeniet e paplotësuara tokësore e kërkojmë vetëm kur jemi në ditë mungesash shpirtërore. Pastaj kur na duket se dëshpërimi që na pat kapluar shpirt e trup ka shtegëtuar diku përtej nesh, ne e harrojmë Zotin dhe lutjet tona të zjarra në netët pa rrugëdalje, e humbasin zjarrin e mëparshëm. Poeti vuan mosmirenjohjen në natyrën njerëzore, duke prekur kështu prapun e lirikës meditative.

Lirikat *“Për shpëtimin nga depresioni / Parakalesi”* dhe *“Jeta e re”* janë një hymn i dashurisë hyjnore për njeriun.

*“dora jote Zot i math  
pakë pushim më dhuroj  
si përgjegje parkalesish  
ç’ashtu kurrë s’i kisha bërë  
e përmallimi sot më merr  
se s’më dajën më si aherë”*

*(Për shpëtimin nga depresioni / Parakalesi)*

Dashuria dhe veç dashuria, si kryefjalë e vëllimit me poezi *“Vulë uji”*, është fryma që ka pushtuar poetin Zef Chiaramonte në secilin detaj të secilit varg.

1) Erik From, Gjuha e harruar, Kujtin Ymeri, Dituria, Tiranë 1998, f.13.

*(Vlorë, nëntor 2014)*



## Vulë uji - Marca d'acqua

(poesie bilingui di Zef Chiaramonte)

**Giuseppe Schirò Di Maggio**

da Piana degli Albanesi (Pa)

Il mio primo incontro con Zef Chiaramonte avvenne negli anni '50 del secolo scorso, negli ampi locali del Seminario Diocesano di Piana degli Albanesi, seminario che ereditava in un certo qual modo la gloriosa fama di quello di Palermo istituito nel 1734 dal Servo di Dio Padre Giorgio Guzzetta per gli Arbëreshë di rito bizantino dimoranti nelle cinque storiche colonie albanesi della provincia di Palermo. Con il trasferimento a Piana degli Albanesi del seminario palermitano, i ragazzi in età scolare media della diocesi che presentassero anche una vaga aspirazione al sacerdozio, venivano indirizzati a Piana. Il Seminario Diocesano divenne quindi luogo eletto per la socializzazione degli adolescenti bizantini che portavano, anche inconsciamente, cultura dai luoghi di provenienza e cultura ricevevano in loco. Il seminario sostituiva a quei tempi la scuola dell'obbligo che non esisteva ancora. Da più di una ventina d'anni, il seminario è materialmente chiuso e quindi si sono interrotti gli scambi culturali degli appartenenti alla comunità: l'enorme danno che ne deriva ha segnato, segna e forse segnerà per sempre il declino della nostra esistenza etnica.

Zef Chiaramonte da Santa Cristina Gela, di rito latino in quel momento, era uno dei tanti seminaristi diocesani provenienti dalle cinque colonie. A differenza degli altri compagni delle colonie di Palazzo Adriano e Mezzojuso, Chiaramonte parlava arbërisht, come parlavano arbërisht i contessioti e naturalmente i pianioti. Tutto ciò per dire che Chiaramonte e pochi altri, compreso me di due anni e mezzo più in età di lui (e quindi anche di due anni scolastici), abbiamo posto le basi per un futuro di dedizione alla causa culturale e linguistica albanese. In seguito si aggiunsero alla nostra esperienza scolastica gli anni del Seminario superiore di Grottaferrata; usciti da lì ognuno seguì la propria strada, ma le basi non furono tradite.

Tra le tante iniziative intraprese da Zef Chiaramonte ascrivo a suo grande merito quello di averci fatto incontrare i poeti kosovari, invitandoli a Palermo per uno scambio culturale e di poesia nel 1980. Lo stesso Chiaramonte portò in Kosovo i miei primi libretti di poesie, da cui venne tratta la raccolta "Gjuha e bukës" (Rilindja, Prishtinë, 1981).

Ero a conoscenza del fatto che Chiaramonte di tanto in tanto si diletta a comporre versi poetici quand'era bibliotecario a Santa Cristina Gela; alcuni versi li ricordo per avermeli recitati: "Tirana, agosto 1991", ma ho saputo soltanto ultimamente, quasi a pubblicazione avvenuta, della raccolta *Vulë uji – Marca d'acqua*. Sicché oggi, con piacevole sorpresa, incontro un Zef Chiaramonte "poeta". Ed è su questo che mi soffermerò con brevi note.

Con un solo libro di poesie Zef Chiaramonte ha fatto "goal" ottenendo ufficialmente da parte anche di illustri lettori il titolo di "poeta". Mi pare d'aver letto da qualche parte come un solo libro di poesie non basti a dare conferma di una effettiva ispirazione prolungata nel tempo. Tra l'altro mi viene in mente la frase, non so se da intendere in senso positivo, di uno scrittore che disse: *era un uomo d'un solo libro*, frase che si collega alla sentenza di San Tommaso d'Aquino: *cave ab homine unius libri*, guardati dall'uomo d'un solo libro. In sostanza, per dire che Chiaramonte è obbligato a continuare sulla via poetica intrapresa.

Comechessia Chiaramonte con un solo libro si impone già all'attenzione dei lettori e degli studiosi.

Se analizziamo i testi poetici della presente prima raccolta *Vulë uji – Marca d'acqua* di Zef Chiaramonte, ci convinciamo di avere a che fare con un poeta autentico.

Ricevuto il libro, l'ho aperto quasi a metà e, tenendo d'occhio le due pagine parallele bilingui, ho dato una scorsa immediata a una poesia: *Kodra e diellit*. L'ho riletta subito con attenzione. Mi è parsa una sintesi perfetta di tutta la nostra storia di antichi migranti sparsi dovunque, che si esaltano agli incontri sia casuali che voluti come può essere appunto un convegno di studi sulla lingua albanese a Prishtina: «rami dispersi / di stirpe antica / qui giungemmo insieme / un giorno d'estate / d'alfabeti e ortografie / lontananze a sfidare // ragazze in delirio / aspettavano alla finestra / ognuna il suo cavaliere / in cuor covando / segretamente //



lei dal primo piano / mi chiese una sigaretta / volò il mio pacchetto / rosso di pall mall / tra i seni suoi splendidi / fece goal / cinque secoli di solitudine / svanirono d'incanto - të këputura degë / gjak i shprishur / këtu erdhëm tok / një ditë gushti / alfabeti largesi për të sfiduar / dhe drejtshkrimi // vajza të dalldisura / në dritare na prisnin / secila kalorësin e saj / duke pirë me sy / fshehurazi // ajo nga kati i parë / një cigare me kërkoi / flutur paketa / ime e kuqe Pallmali / gjirit në lulëzim / i bëri gol // pesë shekuj vetmi / u zhdukën si me magji». Fino all'undicesimo verso scorriamo sui binari di una frequentazione poetica che non ci è ignota e la forma moderna del verso, l'accostamento stringato delle parole ci fa gustare come nuove sensazioni antiche, patrimonio di sostanza di chi è autenticamente arbëresh. Ma dal dodicesimo verso l'eccellente originalità: l'immagine del pacchetto di sigarette che vola quasi fosse un pallone del calcio o della pallacanestro, nell'incontro tra due squadre quella che attende ospiti e quella che porta ospiti, ha una suggestione quasi da gara sportiva amorosa: il pacchetto centra il seno in fiore della ragazza che ha chiesto una sigaretta dal primo piano dell'edificio. Un legame si è ristabilito tra albanesi di plaghe geograficamente distanti: il pacchetto partito dalle mani maschili dell'ospite arbëresh fa "goal" nel seno femminile di una ragazza kosovara, una carezza ideale, ma che ha un valore aggiunto (sempre nelle "cose" che scrivono gli arbëreshë c'è un valore aggiunto): cinque secoli di separazione, "di solitudine, svaniscono d'incanto", dice il Poeta. Come il pacchetto di sigarette, messaggero d'amore, anche la presente raccolta di poesie ha fatto "goal".

Ho iniziato queste note al bel libretto di Chiaramonte dalla poesia *Kodra e diellit* (pp. 62, 63) perché emblematica, a mio parere, di tutta la raccolta. Ma, in questa, la varietà di sensazioni, di sentimenti, di immagini, di suggestioni è così doviziosa che non sai come proseguire.

L'Arbëria non è un luogo "concluso", ma da sempre è rimasta aperta alle relazioni con i luoghi geografici in cui è situata e a cui lega l'appartenenza per cultura, religione, sentimenti. La raccolta inizia infatti con *Oi Topoi – Vendtakimet*, poesia che raccorda Occidente e Oriente, Arbëria di Sicilia, Roma, Orvieto, Trieste, Aquilea, Bisanzio: simboli presi non a caso, perché *topoi* dell'anima che li ha assorbiti e li ha resi eternamente palpitanti e che, però, il fato divide: «se il fato ci divide / chi fermò la corsa / il tempo / il tempo vorrei fermare / farlo tornare indietro», per ritrovare l'unità.

Delle 26 poesie bilingui, solo "Ti" non è bilingue: i versi si accentrano sull'intimità, l'amore rato e consumato, versi che sono riservati al lettore di *famiglia* albanese; ma mi viene il sospetto di un pudore *antico* del poeta, che cita Luc Glikjini (1765-1850) per la sua poesia scabrosa scritta con l'alfabeto greco, proposto per noi da Demetrio Camarda che ha redatto la lirica, ma essa è albanese, e non fu tradotta in italiano per non ampliare la piattaforma dei lettori; solo recentemente ha visto la traduzione italiana. Sussistono pudori ancor oggi, per fortuna, ma la mancata comunicazione linguistica italiana esclude anche oggi l'immenso stuolo di eventuali lettori italiani in confronto all'esiguo consorzio dei lettori arbëreshë.

Nelle presenti liriche si possono gustare varietà di temi poetici che lasciano sensazioni quasi magiche di un mondo inaspettatamente nuovo. Gli antichi sentimenti dell'innamoramento, della devozione filiale, della religiosità, del valore dei rapporti umani, della libertà, dell'amore per la natura stupefacente dei luoghi, dell'orgoglio dell'appartenenza etnica, prendono sostanza con una forma versificatoria moderna espressa nelle due lingue in uso: l'italiano e l'albanese.

Per mia diretta pluriennale esperienza, concordo con il Poeta quando scrive che l'ispirazione non è subordinata nella resa scritta italiana e albanese all'una o all'altra lingua, e che quindi non di traduzione si tratta, ma di ri-ispirazione, mi si passi il termine, che è da ritenersi originale in entrambe le espressioni scritte.

Nella *Nota praevia* troviamo un appunto interessante e chiarificatore di Chiaramonte: «Il testo italiano dei componimenti che seguono non connota come traduzione il testo in albanese a fronte, e viceversa. [...] Le esperienze maturate nel corso della vita, mi permettono oggi di usare i due codici linguistici con pari dignità e affetto... Tuttavia, terrò solo per me la memoria di quale dei due registri, caso per caso, io abbia usato per primo a secondare per iscritto l'ispirazione del momento». Molto vero e molto esatto.

In un dibattito tra poeti monolingui, mi fu difficile riuscire a convincere i presenti della possibilità per il poeta arbëresh ben acculturato di passare *naturaliter* da un registro all'altro delle nostre due lingue correnti,

l'italiano e l'albanese (e viceversa).

Ampia gamma di sensazioni quindi dalla lettura delle poesie di Zef Chiaramonte, anzi direi doppie sensazioni alla pari, giacché la doppia lettura ti permette di penetrare a fondo i concetti poetici espressi.

Il verso libero moderno usato dal poeta non ci deve ingannare. Leggete le poesie del libretto *Vulë Uji – Marca d'acqua*, titolo indovinatissimo e “sperlucicante”, come direbbe Camilleri, e poi andate a scorrere le poesie presenti nell'*Appendice al saggio di grammatologia comparata* di Demetrio Camarda, del *Codice Chieutino* di Figlia, dei *Canti tradizionali*, *Canti didascalici*, *elegie e proverbi* raccolti da Giuseppe Schirò senior, scritti al modo antico. Ho avvertito l'identico afflato, l'identica meraviglia dinanzi all'amore, l'identica sofferenza derivante dal dolore, temi svolti da Zef Chiaramonte e dai nostri illustri o sconosciuti poeti. Ho annotato a margine del testo la parola “tradizione” per le seguenti poesie: Stagioni – Stina, La casa dei sogni – Shtëpia e ëndrrave, Settembre – Shtatori, Donika – Donika, Xenia – Ksenia, A mia madre nel giorno dell'addio – Mëmës time ditën e lamtumirës, Per salvezza da depressione, Preghiera – Per shpëtim nga depresioni, Parkalesi, Vita nova – Jeta e re, Sogno – Ëndërr, Pelote – Pelote, Mavrotisa – Mavrotisa, Raggio – Rreze, Noctes Pelasgicæ – Net Pelasgjike, Oltre – Mbatanë, Virgulti d'Albania – Vllastarët e t'Arbërit dhe.

Qualche esempio di colleganza, se non di termini, almeno di aura poetica e di concetti.

*Chiaramonte* (Stina p. 31): ere e verës / me ardhjen tënde më vinte // dhrithmë shikimi / emocion fjalët / puthjet marrëzi // gjithnjë / me te nisurit e tu / për mua më e dashura / dimri / më shtangte.

*Canti tradizionali* (p. 334): Ka dimbër po edhe verë ka nga vit; / isht hënza herë e josme e herë e plotë; / menatën edhe mbrëmën ka nga ditë... / Ti vetëm po je një, edhe gjindia e thot!

*Chiaramonte* (Donika, p. 44): si u leve e u leve ti / vajza ime e parë / nata m'u bu ditë / t'errëtit dritë...”.

*Chiaramonte* (Ksenia, p. 47): si u leve e u leve ti / vajza ime e dytë / dielli e hënza / dhane takim / mbi djebën tënde / se bashku vallëzuan.

*Codice Chieutino* (p. 60): ... ti në mes ilzet një hënë je.

*Appendice* (11, p. 80): Kur të leu tij mëma / si ti të bënë nga mbrëma! Përse je me klëmshtë gëshur, / vetullë-përveshur, / lampadë je e hjisur...

O nel “vajtım” canto funebre per l'addio alla madre.

*Chiaramonte*: (Memës time ditën e lamtumirës, p. 53) e para fjalë që na del nga goja / je ti Mëme” e le anafore del “vajtım” M'ò të duam kur qeshëm / M'ò të kerkojëm kur klamë”...

*Giuseppe Camarda, Canti tradizionali* (IV, p. 320) Flëni, flëni gjithmonë / eshtra të prindit t'im...

Soprattutto i bei versi “Per salvezza dalla depressione – Për shpëtim nga depresioni” che riportano alla memoria vari *imput* poetici presenti nei *Canti tradizionali*: *Në ti po do të kesh bekim e uratë*, (p. 56), ecc.

Bella e preziosa poesia! In modi e tecniche diverse il Poeta è nel solco della nostra splendida tradizione. Del resto l'amore e la sofferenza sono identiche da secoli e lo saranno per i secoli, e se ne avrà la possibilità, come le ha espresse nel passato così in futuro le esprimerà il poeta arbëresh, con i modi poetici propri dell'epoca in cui vivrà.

Un'ultima annotazione. Al lettore probabilmente sfugge la collocazione nel libro della versione italiana e di quella arbëreshe. Per classica consuetudine i nostri poeti, soprattutto i grandi, hanno situato a sinistra la versione albanese (pagine pari) e a destra quella italiana (pagine dispari). Nel libro di Chiaramonte le parti sono invertite. Quale può essere stato il motivo della scelta di Chiaramonte? È probabile che tale partizione sia stata fatta con l'intento di voler porre in miglior posizione il testo albanese per invogliare i lettori arbëreshë a soffermarsi maggiormente su di esso.

Rreth poezisë së Arshi Pipës

## Lindja e poezisë, transfigurimi i ëndrrës në vetëdije për kohën

**Dr. Bavjola Shatro**

Universiteti i Durrësit

Prania e Arshi Pipës në kulturën shqipe, si studiues, kritik e poet është një fakt me rëndësi për të ndërtuar dhe kuptuar drejt realitetin e letërsisë tonë në shekullin e XX. Pipa ka shkruar që në mesin e viteve '30 të shekullit XX. Skena letrare e kohës kishte dëshmuar zhvillimin e vullshëm të letërsisë, të mendimit kritik, të përkthimit, botimeve letrare-kulturore, fakte të cilat e bënin këtë periudhë ndër më të larmishmet e historisë së letërsisë shqipe. Nga ana tjetër, përmes kësaj periudhe kuptohet më drejt edhe ndërprerja e panatyrshme që pësoi procesi letrar, si rezultat i vendosjes së regjimit komunist dhe imponimit të realizmit socialist. Sikurse dihet, në rreth 15 vitet e para pas çlirimit, gjendja e letërsisë shqipe ishte tronditëse, plotësisht e përkundërt me zhvillimin që pati në vitet '30 e '40.

Në gjysmën e dytë të shekullit XX, një periudhë gjatë të cilës studimi i letërsisë brenda kufijve të Shqipërisë mbartte vranën e rëndë të mendimit njëdimensional ideologjik dhe mungesën e plotë të pavarësisë së domosdoshme për të kuptuar e studiuar artin letrar, Pipa shkroi veprën e tij *Triologia Albanica*, 1978, *Contemporary Albanian Literature*, 1991 (Letërsia Bashkëkohore Shqiptare), dhe studime me natyrë letrare dhe sociolinguistike duke bërë të përmendej në kontinentin e largët amerikan një letërsi e kulturë pothuaj e panjohur. Pavarësisht profilit të tij si studiues dhe vëmendjes së përligjur që i jepet tashmë prej vitesh punës së tij në këtë drejtim, në këtë artkull, ne do të përqendrohemi tek poezia e Arshi Pipës, duke synuar të paraqesim disa linja në të cilat mund të ecë studimi i kësaj poezie, veçanërisht po të kemi parasysh kohën e shkrimit të saj. Ne do ta shikojmë poezinë e Pipës si krijim letrar të dy fazave të dallueshme nga njëra-tjetra, por me një kalim të natyrshëm mes tyre.

### Faza e parë

Në krijimtarinë poetike të Pipës të fazës së parë hyjnë poezitë e botuara në vëllimet “Lundërtarë”, “Libri i dashurisë dhe fatit”. Në to vërehet një ndjeshmëri e hollë dhe një shije e rafinuar për të njohur të mëvetësishmen deri edhe te përsëritja e fenomeneve më të përditshme. Marrëdhënia me mjedisin, me të shkuarën, me natyrën dhe me tjetrin, të kujton veçoritë e poezisë romantike. Në lidhje me këtë fakt, janë shprehur në dy mënyra të dallueshme dy studiues<sup>1</sup>. Kjo ngjashmëri me poezinë romantike bie në sy mbi të gjitha në vëllimin e parë të Pipës, tek “Lundërtarë” dhe më konkretisht tek “Libri i elegjive” që i përket si kohë shkrimit viteve 1936-1940.

Nga poezitë e para të Pipës e deri më tej, në ato të vëllimeve “Libri i burgut” e “Meridiana” ndodh një proces i ndërlikuar dhe estetikisht i arrirë, të cilin ne do ta quanim transfigurimi i imazhit dhe i ndjenjës drejt meditimit dhe prirjes së unit lirik për të perceptuar të padukshmen që në njërin nga poezitë e tij, *Notturmo*, e gjejmë të emërtuar si Prani të paqme të qenies<sup>2</sup>. Këtë lëvizje mes fazave të krijimtarisë poetike të Pipës nuk e nënvizojmë duke e parë thjesht në termat e një ngritjeje cilësore apo si një fenomen të pavërejtur më parë, pasi ndryshimi i perspektivës së autorit dhe riorientimi i mendimit dhe i estetikës së tij përbëjnë dukuri të njohura në letërsi. Duke e vënë në dukje këtë zhvendosje, ne synojmë të theksojmë faktin se në optikën tonë, Pipa shfaqet në dy pamje si poet. Këto dy faza karakterizohen nga rikonceptimi i alternuar i Ëndrrës si ndjeshmëri dhe mendim kryesor i fazës së parë dhe i Kohës, si më tipike për të dytën.

Faza e parë mishërohet në mënyrë më tërësore në konceptimin e Ëndrrës, e cila kuptohet përmes të shkuarës dhe vështrimit pothuaj djaloshtar, rinor dhe emotiv të të ardhmes. Ëndrra krijon edhe pikëvështrimin e unit lirik për kohën dhe pikëtakimin e njeriut me botën. Poezia e fazës së parë nuk përbën thjesht një fazë a një kapërcyell për të kaluar në etapën e dytë, por një fenomen më vete në të cilin gjen idilin, baladën, sonetin dhe një larmi të tërë metrash e strofash, duke përbërë kështu një model vjershërimi më vete. Aty gjendet imazhi dhe përjetimi i drejtpërdrejtë në modelin romantik, kushtuar fëmijërisë dhe kohëve të rinisë së

hershme.

Poezia e kësaj faze është një poezi ndjeshmërisht romantike, përgjithsisht evropiane dhe jo me specifikat që pati ajo në letërsinë tonë të shek 19; pra, është një poezi që dominohet nga meditimimi dhe ndjeshmëria për realitete të simbolizuara përmes natës, hënës, heshtjes, në të cilat mpleksen vlerat kuptimore të elementeve më të kudogjendura të kësaj paradigme, si mjegulla, thellësia, fshehtësia, humnera, dhe nocioni e përkushtimi i vetes dhe i jetës për dashurinë. Me dashurinë, Pipa nënkupton realitetin më sublim dhe Bukurinë, rruga drejt të cilës është lundrimi më i guximshëm dhe më sfidues i njeriut, drejtuar vetëm nga forca e Fatit. Në këtë fakt, vërehet menjëherë një prirje e mirëfilltë për ta konsideruar estetikën/estetikën si formë përcaktuese të vetëdijes. Po aq, aty vërehen edhe shenjat e para të komunikimit të vazhdueshëm me vetveten dhe raportit me të, që në poezitë e etapës së dytë bëhen më intensive dhe më të pranishme.

Ndërkaq elegjia, jo vetëm si nënloj letrar, por edhe si tonalitet dhe ndjeshmëri më vete, ndërtohet mbi elementin natyror, të transfiguruar në luhajtje dhe përjetime të trishta e të sinqerta. Ndjehet një dëshirë e mallit të përtejbotshëm, për diçka që përkapet intuitivisht, si një nevojë për t'u njësuar me të tërën, me një përjetim paqeje dhe vetënjohjeje. Ndjeshmëria e thellë nuk e vakëson vargun. Këtu mbizotërojnë jehonat, kujtimet, melankolia, vegimi, ëndrra, flatrat, drita qiellore etj. Poezia e fazës së “Lundërtarëve” është poezi e arratisë dhe e largimit më shumë se e qartësisë për destinacionin e kërkuar. Për habi (disi romantike), destiancion bëhet shpesh e shkuara dhe kujtimi për të, që për unin lirik duket se kurrë nuk zbehet. Personalizimi është tejet i fortë dhe madje është qendër kuptimore. Përvojat e jetës kalojnë përmes tij dhe për tek ai. Subjektiviteti tek Pipa është kohë e brendshme, dëshirë për zhvendosje në hapësirë, në largësi të skajshme.

Pipa paraqet relativisht shpesh shkrimin e poezisë në variante. Varianti i një poezie, zakonisht rezulton në një poezi më vete duke paraqitur konceptim të ri në stil, por edhe me ndryshime nga ana përmbajtësore. Natyrisht që në këtë rast nuk flasim për logjikën krijuese të Kenosë, Gijenit apo Valerisë në modernizmin e fillim-shekullit 20, të cilët pothuaj e shihnin poezinë si mundësinë e shprehjes së shumë varianteve rreth të njëjtit subjekt<sup>3</sup>. Sigurisht që ky i Pipës është një rast tjetër, i lidhur madje me një pikëpamje plotësisht të ndryshme, atë të njësimimit të unit lirik me atë empirik dhe jo me prirjen tipike moderniste (duke nisur madje që nga simbolistët e këndeje) të kërkimit të “gjuhës së re”. Përgjithësisht uni lirik te poezia e Pipës konsolidohet në një ndjenjë të definueshme, tipar relativisht i dukshëm ky i poezisë shqipe të asaj kohe, ndërkohë që realiteti letrar evropian reflektonte prej kohësh prirje të kundërta moderniste që thellë-thellë kishin nisur që me analizat e Novalisit dhe romantikëve të tjerë.

Kalimi për tek faza e dytë e poezisë së Pipës bëhet përmes asaj që vetë ai, në parathënien e “Librit të dashurisë dhe të fatit” e quan njohja e vetes<sup>4</sup>. Tek poezia e vëllimit të parë “Hije tallëse” (shkruar në 1940), shihet një nga gjurmët e para të këtij procesi. Tani, poeti përballet me Fatin dhe zbulon emrin e objektit të dashurisë (sikurse sqaron edhe vetë Pipa në parathënie), prandaj perceptimi i tij mbi atë që është brenda dhe përtej vetes së tij ndryshon shumë.

## Faza e dytë

Në poezitë e fazes së dytë zë vend vetvetja dhe e shkuara, të tjerët dhe e tashmja, logjika e kërkimit të prehes në vazhden e shndërrimeve të befta të kohës dhe vetes, shndërrime këto të parathëna me shenja të tërthorta. Raporti është i tillë: vetvetja e njësuar me Ëndrën kthehet në vetveten e shndërruar në kujtim për Ëndrën dhe vetë kjo shndërrohet është tashmë në hije. I pari atribut që humbet prej një shndërrimi të tillë është të folurit, i cili është kthyer në murmurimë dhe pastaj shkon në shuarje të plotë.

Duke e parë poezinë e Pipës në optikë gjithëpërfshirëse, ne gjejmë se ajo është një mahnitje ndaj Ëndrës dhe vrapim drejt dhe përtej Kohës, për t'i mbijetuar kësaj të fundit. Këto dy fenomene i korrespondojnë rrugës që ka ndjekur poezia e Pipës, kahut të zhvillimit të saj të brendshëm, të cilin ne e shohim pikërisht si transfigurim të Ëndrës në Kohë dhe përgjatë kohës.

Kur trajtohet raporti i përkundërt, pra i kalimit të kohës (konceptuar si fenomen metafizik, social dhe historik) në rikonceptimin e Ëndrës ndodh transfigurimi i përvojës jetësore në përsiatje. Në këtë rast, poezia e Pipës

nuk hulumton e as nuk zhytet në meditim, por jep reflekse zhbirimi që janë pasojë e meditimit. Pasionet përmbahen.

Në poezitë e pas viteve '40 ka dy modele të dallueshme: poezia që ka rimarrë trajtat e herëshme, që jo vetëm janë ndryshuar, por janë krijime të mirëfillta e të reja poetike, dhe poezia e kohëve të burgimit ku, natyrisht, spikat "Libri i Burgut". Në poezitë e grupit të parë ndjehet qëmtimi i ndryshimit të trajtave të njeriut dhe të përjetimit. Poezitë fitojnë me shumë kondensim të brendshëm, ndërsa përshkrimi ngjeshet në favor të përçjelljes së një meditimi më pak të shprehur dhe më fort të nënshtresuar. Përvojat thellohen duke ngërthyer caqe më të largëta të kohës së brendshme. Koha bëhet një pezulli mes qiellit dhe tokës dhe është një e tashme e trajtësuar në vegimin e krijimit, që sheh për aktin e përplotësisë. Kjo mishërohet me konceptime që formulohen tek "Poema e krijimit", por duke e bërë gjithë poezinë e këtij grupi një treguese të rrugës disahapëshe të jetës së brendshme të njeriut dhe të vetë poetit.

Megjithatë duhet sqaruar se koha është edhe kohë reale objektive, ajo të cilës Pipa vetë i mbijetoi dhe sigurisht ia doli t'i mbijetonte edhe pjesa më cilësore e poezisë së tij. Poezia shpreh jehonën e bërthamës së vetë njeriut në një stinë të ndryshme, të brendshme të tij. Nuk ndjehen më si në poezitë e fazës '36-140 tonet e spikatura romantike. Në këto poezi, ne lexojmë përpjekjen për të kuptuar dhe deshifruar disa të fshehta që njeriu gjithmonë ka synuar të përkapë në kohëra, sidomos përmes artit dhe veçanërisht përmes poezisë. Ndër to dallon dashuria. Dashuritë janë brenda njeriut dhe përshkallëzohen gradualisht mbi bazën e aftësisë së tij për të njohur tek ato veten dhe shenjat e krijimit. Ajo lind në njeriun dhe prej tij vetë, por duke nënkuptuar se ajo ngjizet për të dhënë fryt. E megjithatë ajo nuk zotërohet, duke mpleksur kështu në vetvete Dafnen dhe Euridikën njëherësh, pakapshmërinë dhe humbjen e pakthyeshme, për të cilat dëshmon hyjnesha Mnemozinë e kujtimit të anktshëm të krijimit. Kështu poezia shtyhet të rrekë kufirin e përtejme të perceptimit të njeriut. Ajo mplekset tani me Fatin. Lindja e poezisë është përçapje drejt zgjidhjes së moskuptimit dhe misterit të Fatit. Uni lirik është përjetuesi i madh i këtij eksplorimi të gjithëjetshëm dhe fundi i këtij kërkimi sjell në vëmendjen tonë një element të tretë të poezisë së Pipës të kësaj kohe, fillesën, krijimin.

Tashmë njeriu kërkues i kthehet hapësirës ujore dhe boreale, pikërisht pikës së lindjes së tij. Veçanërisht tek "Poema e krijimit" lexohet një imazh thujse kozmogonik mes ditëve të para të krijimit dhe shfaqjes së gruas së parë Evës, imazh ky që rreket të prekë sidomos ndjeshmërinë e botës vegetale me ujërat, avujt e tokës, dritën që plasarit retë e qiellit, frymën, pritjen, ngrohtësinë e trualit etj. Në këtë hapësirë lëndore dhe ujore ngjizen dashuritë, epshi, njohja dhe eksplorimi i të padukshmes. Kjo është pothuajse tërësisht një kohë e brendshme e mbetur midis fazave të jetës dhe të tokë-qiellit. Ëndrra e poezive të hershme elegjiake tani është prirje e heshtur e brendshme, gjakim i vazhdueshëm për tek ajo që konsiderohet sublime dhe e gjithmonëshme dhe që mishërohet në elementet e shprehura më sipër.

Krejt ndryshe janë poezitë e ciklit të Burgut. Këtu gjithçka shndërrohet në shqisë, në perceptim të menjëhershëm e të thellë të botës. Instinkti i fortë i jetës shprehet përmes mprehtësisë në përkapjen e sekuencave si në një seri filmike pa zë, por me gjithë efektet tronditëse të shpërhyrimit të njeriut nën dhunën e mohimit. Këtu nuk ka asnjë gjurmë të Ëndrrës dhe përforcohet imazhi i vëzhgimit dhe i kapjes pas një pranije të paqme të diçkaje pothuaj të padukshme, por që është shpresa e lirisë. Sigurisht që ky i fundit është një nocion i gjerë e kompleks, është vetë një koncept etik me implikime të shumëfishta. Në këto poezi koha ngrin, apo më saktësisht, ecën me ritme infernale, të përtejme që ndikojnë në krijimin e një imazhi pamor të palëvizshëm. Mendojmë se është impresionuese zgjedhja e poetit për të lëvruar sonetin në një kontekst të tillë tematik e motivor sepse rregullsia e sonetit i jep një dimension të veçantë interpretativ ngrehinës së trishtë të vuajtjes dhe të shpërhyrimit sidomos në poezitë e ciklit "Kanali". Poezia paraqet shkretinë e burgut, por shpreh mjeshtërisht edhe botën përtej mureve të burgut, me të cilën fatkeqsisht ndryshimet nuk ishin fort të mëdha. Poezitë e "Librit të burgut" janë pothuajse një ditar i mbajtur në heshtje, por me përpikmëri artistike të fakteve të njëpasnjëshme dhe tronditëse për domethënien dhe çmimin e mbijetesës. Edhe përzgjedhja e metrave, figuracionit dhe gjuhës është e tillë që t'i japë poezisë ritmikën e jetës në një botë paralele që ekziston si një ishull makthi brenda një absurdi më të madh, por që përbën



pikën më të skajshme ku mizoria dhe dhuna mpiksen e pleksen plotësisht. Tek këto poezi bëhet më e dukshme dhe më e prekshme heshtja. Disa prej poezive ndërtohen si një vështrim i objekteve memece të qelive apo burgjeve të shfarosjes. Kështu, të krijohet përshtypja se lëvizja mungon, ose se identifikohet me dinamikën e dhunës dhe imponimit të realitetit të shpërfytyruar të burgut. Që këtej krijohet ndjesia e një kohe që rrjedh fare ngadalë dhe ndryshe nga realiteti logjik, objektiv. Klimaksi i mpleksjes së tragjikës me ironinë e rrethanave dhe të dhunës gjenden tek vdekja, përshkrimi i të cilës bëhet i shpeshtë dhe praktikisht një realitet i pandashëm.

**Në përfundim** do të thoshim se pavarësisht se përmasat e Arshi Pipës shpërfaqen më gjerësisht në punën e tij si studiues dhe kritik, madje duke përbërë një fenomen të rëndësishëm në kulturën tonë, ca më shumë për kohën dhe rrethanat kur u shfaq, poezia e tij është një realitet letrar me karakteristika të vetat, të qenësishme. Kjo duhet të mjaftojë për t'i kushtuar asaj vëmendjen e nevojshme, rezultat i të cilës do të jenë mendimet akoma më të argumentuara për vendin e Arshi Pipës në letërsinë dhe në kulturën tonë, veçanërisht duke patur parasysh kontekstin e zhurmshëm e shpesh të pezullit të letërsisë shqipe gjatë shekullit të shkuar.

### **Përmbledhje**

Ky artikull është një variant i riparë i një kumtese të mbajtur disa vite më parë në konferencën kombëtare, zhvilluar në Tiranë, mbi veprën dhe kontributet e Arshi Pipës në letërsinë shqipe. Artikulli përqendrohet te poezia e Pipës dhe synon të evidentojë, në mënyrë të përmbledhur, disa veçori të poezisë së këtij autori, të cilat e bëjnë atë një individualitet më vete në skenën e poezisë shqipe të kohës. Në artikull poezia e Pipës analizohet duke parë kalimin nga faza e parë e saj në të dytën dhe duke u përqendruar në disa nga dukuritë më të cilat shoqërohet ky kalim.

Ndërsa roli i Pipës si kritik e studiues është pranuar gjerësisht, artikulli tërheq vëmendjen edhe në një spektër tjetër të marrëdhënies së tij me letërsinë e cili, sado modest krahasuar me dy të parët, përsëri dëshmon një ndjeshmëri artistike dhe shije të përpunuar, një afinitet të natyrshëm ndaj filozofisë dhe një prirje drejt estetikës moderne.

Poezia e tij shpreh qartazi lidhjen e dyfishtë sa me drejtimit letrarë pararendëse, mes të cilave mund të përmendim romantizmin, aq edhe me drejtimit apo prirjet bashkëkohore. Pipa mediton dhe prek realitete etike, sociale dhe historike, por gjithmonë duke përcjellë një vizion dhe të kuptuar vetjak për to. Uni i tij lirik ndërmer eksplorimin e tij tërësisht të dallueshëm e sfidues drejt dashurisë, të bukurës, fatit, kohës dhe ëndrrës. Ai heton dimensionet e estetikës dhe etikës nga një pikëvështrim që ka një zë të vetin në poezinë shqipe dhe mund të kontribuojë në një njohje më të gjerë të saj.

### **Bibliografi e shkurtër**

1. Elsie, Robert. Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë 2000.
2. Friedrich, Hugo. The structure of Modern Poetry, USA, 1974.
3. Ismajli, Rexhep. Poezi , Dukagjini, Pejë, 1998.
4. Pipa, Arshi. Autobiography, Phoenix, Tiranë, 2000.
5. Pipa, Arshi. Lundërtarë , Libri i dashurisë dhe i fatit, Phoenix, Tiranë, 2000.

### **Shenime:**

- 1) Shiko R. Ismajli “Poezi” (Ftesë për lexim) Dukagjini, Pejë 1998, fq.10 dhe Robert Elsie, “Historia e Letërsisë Shqiptare”Dukagjini, Pejë, 2001, fq.479;
- 2) “Poezi” Dukagjini Pejë, 1998, fq. 160
- 3) Shih Hugo Friedrich, The structure of Modern Poetry, Northwestern University Press, Evanston, 1974.
- 4) Arshi Pipa, Lundërtarë; Libri i dashurisë dhe i fatit, Phoenix, Tiranë, 2000, fq. 97.



Romani “Aksidenti” i Ismail Kadaresë

## Kodimi i kohës në prozë

**prof. dr. Nexhip Mërkuri**  
Universiteti ‘Ismail Qemali’, Vlorë

Krijimtaria e autorit me shumë çmime të fituara në vite ka tërhequr vëmendjen e mjaft artikullshkruesve në gazeta apo revista që kanë shumë lexues. Të detyron të mëshosh tek një vlerësim: “Ismail Kadareja është një shkrimtar që krijon hartën e një kulture të tërë, të historisë, pasionit, folklorit, politikës, dhe katastrofat e saj. Ai është një shkrimtar universal me një traditë të narracionit që e ka origjinën që nga Homeri.”<sup>1</sup>

Përveç kritikës letrare, vepra e Kadaresë ka qënë objekt i kërkimeve gjuhësore nga student të nivelit të parë, të dytë dhe të tretë. Përvjetorët e këtij autori dhe konferencat shkencore të universiteteve<sup>2</sup> brenda dhe jashtë vendit kanë bërë objekt të hulumtimeve veçori gjuhësore të veprës disa vëllimëshe në poezi apo prozë. Gjuhëtari Xh.Lloshi në 80-vjetorin e lindjes ka shkruar midis të tjerash për veprën e Kadaresë me aq vëllime sa nuk i ka arritur asnjë shkrimtar yni më parë, nuk ka veç disa fjalë të reja, por është e tëra një neologji, një fjalë e re në letërsinë shqipe. Organizimet e paprovuara më parë të tekstit letrar shqip, rindërtimi i ligjëratave historike, etnografike dhe sociale.”<sup>3</sup>

Dhe romani “Aksidenti” nuk përjashtohet nga ky përfundim. Organizimi i tekstit i gjuhës së shkrimtarit, i ligjëtimeve në këtë prozë janë gjetje të reja të autorit. Vështrim nga pasqyra e brendshme e shoferit të taksisë për aksidentin, vështrim nga pasqyra e grave që zbukuroheshin, tek telefonata e Nënë Terzës për Bill Clinton; kënga e kafeneve, testamenti i përkthyer në gjuhën e lashtë standarde të Europës dhe në disa gjuhë të Bashkimit Europian. Testamenti i hartuar me fjalën e bukur shqipe letrare dhe përkthyer në një gjuhë të lashtë, të Dante Aligerit dhe në nëntë gjuhëve të Bashkimit Europian. Tërësia e emrave: *zemër, legjendë, Orfeu, çifti, gjeopolitika, Këshilli i Europës, Ballkan, robinjë, femër qejfi, Besfort Y dhe Rovena, histori, Iliadë, varr, këngë, Lorelei, qiellzanë, anketë, hulumtuesi, gërmuesit* etj.; vendosen në faqet e romanit me një pjesë tjetër të ligjëratës siç është **folja** apo me pjesë të tjera të ligjëratës. Kombinimi i pjesëve të ligjëratës edhe për këtë roman është krejtësisht i ri, sidomos kodimi i asaj pjese të ligjartës që tregon veprimin në tri apo dyzet ditë, veprimin e çdo emri.

Si i ka koduar foljet në të gjitha romanin, përshatur me rrëfimin, me hartimin e testamentit, në këngën e kafeneve, tek kërkesa e lejës gojarisht, në zyrë etj.?

Autorë të tjerë kanë vënë në dukje për këtë autor se vendosja e dukurive në kohën e tyre në një vepër artistike është një element i domosdoshëm për shkak-pasojën e çdo dukurie. Nuk është e lehtë të alternosh kohërat duke ruajtur të paprekur unitetin artistik të veprës.

Autori Tefik Çausi sjell si shembull të qëlluar poezinë “Laokonti”, i cili duke dashur të transmentojë një mesazh të natyrës politike, alternon kohën e sotme të bashkëbisedimit të statujës (të animizuar) me turistët, me kohën e zbulimit të kundërlegjendës, me kohën e trillimit të legjendës, me kohën tremijëvjeçare të ekzistencës së statujës, bile me kohën e ardhshme (të parashikuar), kur statuja mund të pëlcasë e të bëhet copa-copa nga marazi për indiferencën e atyre që s’kuptojnë dhe lejojnë tradhëtitë. Por i gjithë ky mozaik kohësh është derdhur natyrshëm në një shtrat kohor të vetëm në kohën e sotme, kur statuja rrëfen fatin e vet.<sup>4</sup>

Këtë përvojë në poezi autori e ka mordenizuar më tej në prozë me mjetet të tjera gjuhësore si në shembullin e mëposhtëm.

Rrëfimi e shpie modernitetin e një çifti nomad dhe universal në zemër të legjendës së Orfeut me vështrimin e shoferit të taksisë në pasqyrën e brendshme:

“...*gjeopolitika e re e Ballkanit, vënia në radhë përpara portave të Europës, për të hyrë në familjen e ëndërruar, treteshin ngadalë, telefonuesja Nënë Tereza për Bill Clinton që të bëjë diçka për shqiptarët e mi, ndërsa një këngë kafenesh vazhdonte të këndohej si më parë:*

*Kishte dëgjuar se për “Iliadën” duheshin katër ditë për ta treguar  
Për historinë tij<sup>5</sup> do të mjaftonin, ndoshta, po aq. (f.58)*

Koha e jetës, koha për të treguar historinë e zgjedhur e përmendur shkurt më lart, koha e hartimit të testamentit bëjnë që secila prej tyre të ketë kohën e vet të shtjellimit, kohën e brendshme që në veprat letrare është koha letrare e rrëfimit, mimetizuese e kohës reale. Kohët e foljeve bëjnë që fjalitë e thëna të lidhen në një kontekst të thënies.

Autori i Stilitikës së gjuhës shqipe, prof. Xh.Lloshi i ka kushtuar vëmendje kohës së kodimit të foljeve, duke e lidhur me veçoritë e dëftimit të kohës, lidhjen me kodimin e periudhave kohore, me kohën e shkrimit të prozës. Kryesisht vë theksin tek organizimi gjuhësor, i cili lidhet me dëftimin e tekstit, prozës, romanit, dhe referimit të ligjërimeve ( $L1+L2 + L3+L4 = L5$ ). Marrëdhëniet e ligjërimeve këndvështrohen me prozën në tërësi si roman. Kohët e foljeve bëjnë që fjalitë e thëna nga goja e personazheve, rrëfimtari, autori apo gjatë ligjëratës së çlirët lidhen me një kontekst të thënies. Vështruar në këtë tërësi kohët e foljeve shpesh kodojnë edhe tipare modale (pikëpamjen e folësit sipas ligjërimeve të ndërtuara nga autori për përmbajtjen si përbërës të shenjënimit) e aspektore.<sup>6</sup>

Autori ka zgjedhur për arsye stilistike që ligjërimet të mos jenë monotone. Para se të japë fjalët e tyre e personazheve Besforti Y dhe Rovena St përdor fjali përfshirëse e komentuese për L1 ose i rithotë me fjalët e veta atë që shqiptojnë personazhet e romanit L2. Është e zakonshme në roman ligjërata e zhdrejtë e lirë e shënuar në botimet e stilitikës si L4.

### 1. Ndërtimi i ligjërimeve të personazheve

Dialogun midis personazheve e ndërton me folje të kohës së tashme të mënyrave të ndryshme: dëshiron, të dish, të besoj, di, të flas, beso... duke e përshtatur me folje në të kryerën që nuk i ka shkëputur lidhjet me çastin e ligjëritimit: ka ndodhur, kam tradhtuar, kam dëshirë etj.

Foljet në gojën e rrëfimtari vendosen në të pakryerën e mënyrës dëftore dhe lidhore, në diateza të ndryshme dhe të kryerën e thjeshtë të dëftores: ishin, vinte, të dëneste, të rrëfehej, vështroheshin, tha, shtoi, u përgjigj, ndjeu...

Shtohet koha e preferuar në ligjërimet e romanit duke përdorur të tashmen historike. Përdoret për harmonizimin e ligjërimeve e tashmja me kuptimin e të shkuarës, kur folja tregon një veprim që ka nisur në të shkuarën dhe vazhdon edhe në çastin e ligjëritimit. Përdorimi në ligjërime në faqet e romanit e kohës së tashme e përdorur me vlerën e së shkuarës, plotësohet nga një tregues kohor që tregon cakun e fillimit të veprimit. E tashmja shpesh përdoret për t'i dhënë kumtimit vlerën e një pohimi të përhershëm në argumente që sjellin personazhet ose gjykimet për një ngjarje që ndodh ose duke ndodhur. Kjo karakterisikë e së tashmes rrjedh nga një fakt se tashmja nuk është e ndjeshme ndaj ndryshimeve të krijuara nga nënrenditja në periudha të ndryshme të tërësisë së prozës. Ndërsa përdorimi i kësaj kohe me vlerën e së ardhmes duke e shoqëruar me mjete gjuhësore është më pak e përdorur.

*Ai ndjeu pickimin e njohur në zemër.*

*Ajo fliste, me sytë drejt qiellzanës, se si t'i rrëfehej asaj.*

*-Nuk të kam tradhtuar në "Lorelei" – tha me zë të qetë.*

*As njëri as tjetri nuk vështroheshin. (f.179)*

*Nga marazi i vinte të dëneste.*

*-Dëgjo, Rovena,- tha ai qetësisht.-Unë s'di si të flas me ty. ”<sup>7</sup>*

Ligjërimi i personazheve është ligjërata e drejtë (L1). Ndërmjet L1 dhe L3 do të vendoset ligjërata e zhdrejtë (L2) fjalët e personazheve na rithuhet prej autorit.

Arsyeja e përfitimit të L4 se kështu ruhen mundësitë e L1, d.m.th. pyetjet e drejtpërdrejta fjalitë habitore e thirrmore, pjesëzat, leksiku karakteristik i personazhit, vlerësimet dhe emocionet e tij. Autori flet vetë, por synon drejt përngjasimit me të folurin e personazhit që të mënjanojë kalimin te ligjërimi libror. Sidomos ka rëndësi të nxirrtë në pah se me këtë formë gjatë shtjellimit përfshihet edhe pikëpamja e karaktereve në strukturën e rrëfimit sipas fjalëve ose mendimeve të tyre, madje kryesisht të mendimeve të tyre.<sup>8</sup>

Si shkrimtar me përvojë ndjek rrugën e ndriçimit të njëjtë me ngjarjet që ecin të lidhura, të qarta për

dyzet ditë duke përcjellë të dekoduar të lexuesin veprimet e përshtjellimit historik, psikologjik. Rrëfen disa pjesë disa i lë të nënkuptohen, siç thekson E.Auerbach<sup>9</sup> (Memisis: the Representation of reality in Eastern Literature,1953) përshtkrimi mund të shtrihet ndërmjet dy poleve: e plotë ose e pjesshme e nënkuptuar, kalimi në botën e ëndrrave; duke përdorur folje në kohën më se të kryer të mënyrës dëftore afro 50% më shumë se folje në kohën e pakryer të mënyrave të tjera:

*ishte rrëzuar; ishte çuar; kishte rënë, kishin lënë, ishin ndarë, kishte parë, kishte kujtuar, kishte përsëritur, kishte mbetur, ishte shfaqur paskësh qenë, ishte përqendruar, ishin ndarë, kishte arritur, kishte kërkuar (15)*

*Dukej, çonte, kuptohej, gënjente, shkruante, ndodhte, të përpiqej, të gjente, ishte, dilte, të shkëpuste, të zbrazte (12)*

Pavarësisht nga zgjedhja që i bën kahut të rrëfimit, ndërtimit të rrëfimit me ligjëratë të zhdrejtë të lirë, folje në kohë të tjera dalin një ose 3 herë: *pranoj, kupton, je, u duk, erdhi, mbajti, ka helmuar, qenë vvarë.*

*Me dy zhgunat e hallakatur prej stuhisë, ndërpritej, çudi kronika e jetës së Besfortit Y dhe Rovena ST, një javë përpara mbarimit të vërtetë të saj.*

*Një copë e saj më saktësisht tri ditët e fundit përpara se t'i shkëpuste vdekja ishin ndarë ato vetë nga varfori i ditëve. Ishin pikërisht tri ditët për të cilat Besfort Y. kishte kërkuar leje në zyrat e Këshillit të Europës. Përveç kërkesës së lejes të bërë gojarisht në telefonin e tij të fundit asnjë gjurmë e rrokshme<sup>10</sup> s'kishte mbetur gjëkund nga ato tri ditët. (f.218)*

## 2. Ligjëratat e zhdrejtë e lirë

Autori ka vite që përdor ligjërimin, i cili nuk ka asnjë shenjë pikësimi për të dalluar fjalët e autorit nga të personazhit. Është emërtuar kjo ligjëratë të çlirët pikërisht, sepse ka ndërthurje të ligjëratave të tjera, lirishit, pa asnjë dallim.

Në ligjëratën e çlirët të folurit e brendshëm nis të plotësojë edhe detyrën e gjuhës së autorit, pra të japë përshtkrimin e fakteve dhe të ngjarjeve, të përçojë të folurit e të tjerëve etj. Pa dyshim kjo do të shoqërohej me disa veçori të reja të organizimit gjuhësor<sup>11</sup> edhe të përdorimit të kohëve duke përdorur më shumë folje në kohën e tashme për fjalitë e para të ligjëratës së zhdrejtë të lirë dhe të më se të kryerën, të pakryerën, pak folje në të kryerën e mënyrës dëftore për fjalitë që e pasojnë:

*Jam, kupton, dua, të them, kupton, përdor, nxjerrin, kupton, trego, dua, të besoj, (11)*

*Mbante, dinin, ndodhte, ishte, të përpunonte, (5)*

*ke future, ke dëgjuar (2)*

*kishte thënë, kishte sjellë, kishte ndërprerë, ishte zverdhur, kishte klithur, kishte përdorur, kishte nxjerrë. (7)*

*Ishte vonë që Rovena të përpunonte një farë përgjigje qetësuese.*

*Si një idiote kishte lejuar që ai ta përdorte si kukull. Më kupton ç'dua të them? E kupton gjermanishten? E di ç'do të thotë kukull? Ashtu të përdor ty ai. Ashtu si kodoshët e vendit tënd që i nxjerrin të fejuarut në trotuar. I ke lexuar gazetat besoj. I ke dëgjuar radiot. Por ti pa e mjaftuar veten tënde më ke futur edhe mua në këtë lojë.<sup>11</sup> (f.228)*

## 3. Hapësira e tekstit dhe koha gramatikore

Faqet e romanit, brenda thënieve për t'u referuar copës së ligjërimeve, e cilët përmbajnë këtë thënie, pra edhe me mënyrën sesi thënia na sinjalizon marrëdhëniet e saj me tekstin rreth vetes. Kjo mund të quhet hapësira e tekstit ose hapësira gjuhësore<sup>12</sup>, ashtu si dallojmë kohën fizike nga koha gramatikore. Fjalitë e ndërmjetme janë të përdorura me sukses në prozën e shkurtër ose romane si: *na e tregojnë këtë shprehjet në paragrafin e fundit, në kreun që vijon, siç e thamë më parë, për sa më sipër, siç do ta shohim më poshtë; janë të gjitha shprehje me të cilat ne përfyrojmë veten brenda tekstit si në një hapësirë nëpër të cilën*

lëvizim, ndonëse jemi duke folur duke shkruar. (sidomos duke shkruar, prandaj janë edhe togje të lindura në gjuhën e shkruar )

Prania e tyre tregon se thënia që pason është në vijim ose përgjigje ndaj pjesës së mëparshme të ligjëratës. *Siç dilte nga anketa Besfort Y. Ashtu siç pritej, Por siç mund ta dinte zoti hulumtues, siç pëlqen ta quash ti, Ashtu siç ka ndodhur edhe më parë, ashtu siç do t'i ndodhë qindra herë të tjera etj.*

Mjete gjuhësore bashkëveprojnë me matjet, me ndarjet kulturore të kohës siç janë njësitë e kalendarit. Mjetet gjuhësore të përdorura janë ndajfoljet për kohët e foljeve, ndarjet kalendarike janë ditët e javës, muajt : *në mesnatë, të nesërmen, një pasdite, pas mesnate, pasdite vonë, më parë, asaj dite, qysh në çastin e parë, qindra herë të tjera gjer në mbarim të jetës së tij, dyzet javët e fundit, dyzet ditë, tre ditët e fundit etj.*

*Ashtu siç ka ndodhur edhe më parë ashtu siç do t'i ndodhë qindra herë të tjera gjer në mbarim të jetës së tij, hulumtuesi*<sup>13</sup>...

*Për të dhënë të plotë historinë e tyre ashtu ashtu siç dilte prej anketës, ishte përqendruar në dyzet javët e fundit të jetës së çiftit. (f. 217)*

Fjalitë dhe rrallë periudhat që përdor si ndërkalje, si informacion shtesë të dorës së dytë për emrin, mbiemrin, foljen, kohën e foljeve e alternon me kontekstin duke përdorur si denduri përafërsisht të tria kohët: koha e kryer, koha e tashme, koha e pakryer.

*Bën, të jetoj, le...*

*të dinte, njëshoheshini, merrnin*

*ke bërë, ke gjetur, ke shkatërruar*

*hulumtuesi (siç mund ta dinte, madje më mirë se ajo)*

*zotëruese (ti më ke bërë mua robinjë, më ke gjetur të vogël, bën ç'të duash me mua),*

*të hidhej. (Ti s'më le mua të jetoj.) s'më lini. (Ti ke shkatërruar seksualitetin tim.)*

*rrjedhë së prapthi (të dyzetat ose të shtata që njëshoheshin para vdekjes dhe jo pas saj sipas zakonit gjithënjëzësor),*

*për mëngjesin (mëngjesin e vjeshtës me shi dhe erë që e bënte e më të shkretueshëm hollin e hotelit, përpara të cilin Besfort Y po e çonte drejt taksisë shëmbëllesën e së dashurës)*

Rovena ST (me kalimin e kohës shkronjat St. disa e merrnin për shkurtimin të fjalës<sup>14</sup> “shën”), ishte ende gjallë.

*Siç dilte nga anketa Besfort Y. e kishte parë atë ëndërr, atë ëndërr një javë para vdekjes. Sipas logjikës ai duhej ta shikonte atë ëndërr më pas mbasi ta kishte zhdukur Rovenën. Por siç mund ta dinte zoti hulumtues (siç mund ta dinte, madje më mirë se ajo) një zhvendosje e tillë ishte më se zakonshme në gjumë. (f. 50)*

*Ankesën time të përhershme për natyrën e tij zotëruese (ti më ke bërë mua robinjë, më ke gjetur të vogël, bën ç'të duash me mua), ai e kundërshton. (f.69)*

*E kishin zënë nga cepat e palltos e nuk shqiteshin. Mu te këmbët e ylberit s'e linin të hidhej. (Ti s'më le mua të jetoj.)*

Teknika e parapëlqyer nga autori në faqet e prozës si edhe në vepra të tjera, është paraqitja jo në çastin e radhës një informacion për marrësin, lexues, por e shtyn për më vonë. Kjo është një nga teknikat themelore për intrigën për të mbajtur kureshtjen gjallë si u realizua aksidenti para pasqyrës së brendshme të shoferit të taksisë. Koha e paraqitur mund të tregohet vërtetë sa Iliada e Homerit. Dukuritë e kohës shihen në kuadrin e romanit, sepse folja është element shumë i rëndësishëm i ligjërimit dhe e pranishme në gjithë gjatësinë e romanit, prandaj paraqitja kohore e ligjërimeve merr rëndësi, sepse lidhet drejtpërdrejt me vazhdimësinë logjike, pra koherencën e tij.

Koha e paraqitur në faqet e prozës ka raport të drejtë për lexuesin, lidhur me kodimin e kohëve, periudhave kohore të paraqitura. Kodimi i kohëve të foljes në prozë e shqyrtuar realizohet me shumë mjeshtëri. Brenda thënies copës së ligjërimeve, e cila përmban këtë thënie, pra edhe me mënyrën sesi thënia na sinjalizon marrëdhëniet e saj me romanin si tërësi e ligjërimeve. Dallohet koha e kodimit dhe momenti i marrjes së kohës (koha e dekodimit) duke gramatikalizuar me ndajfoljet e kohës dhe mjete të tjera gjuhësore.

## Përmbledhje

Përvjetori i tetëdhjetë, viti i Ismail Kadaresë pasqyrohen në studim gjerësisht për mjeshtërinë e kodimit të kohëve. Trajtohen disa teknika të ndërlikuara dhe të reja nga autori të provuara dhe më parë në poezi që kanë të bëjnë me organizimin gjuhësor në prozë e kryesisht në romanin “Aksidenti”.

Bëhen përpjekje për të parë rendin kronologjik të kohës në prozë, përputhjen e kohës letrare me rrjedhjen e ngjarjeve. Mëshohet më shumë koha edhe tek rendi i ndërkallur në roman dhe fjalitë e ndërmjetme. Jepet pasqyrë e plotë e teknikës themelore për intrigën që mban gjallë kureshtjen e marrësit të mesazhit. Realizohet edhe këndvështrimi përngjasimi ndaj kohës reale, perceptimi i autorit sesi e mësojnë të renë personazhe të veprës dhe si shfaqen në psikikën e tyre. Veçoritë e dëftimit të kohës lidhen me kodimin e periudhave kohore, me kohën e shkrimit të prozës.

## Shënime:

- 1) Jonh Carey. Kopertina e pasme e romanit.Tiranë, 2010. (10)
- 2) Shih më gjerë Lafe,E. Diskutim “Kalemi është më i rëndë se dhiqeli” në I.Kadare dhe vepra e tij Universiteti “E.Çabej”, Gjirokastër, 2006. Konferenca ishte fryt i bashkëpunimit të universitetit “E.Çabej me Akademinë e Shkencave dhe Universitetin e Tiranës, 19 maj 2006. (11)
- 3) Lloshi,XH.Gazeta “Dita”, 28 janar 2016. (12)
- 4) Çausi,T.Universi letrar i Kadaresë.Tiranë, 1993,f.104. (13)
- 5) Kadare, I. Aksidenti. Tiranë, 2010,f.46.58.218,271.(14)
- 6) Lloshi, Xhevat. Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika. Tiranë,2001,f.308. (15)
- 7) Kadare, I. Aksidenti. Tiranë, 2010. (16)
- 8) Lloshi, Xhevat.Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika.Tiranë,2001,f.264. (17)
- 9) Cituar sipas XH.LLoshit. (18)
- 10) Kadare, I. Aksidenti. Tiranë, 2010.f.17,22,26,27,103,217,218. (19)
- 11) Lloshi, Xhevat.Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika.Tiranë,2001,f.264. (20)
- 12) Kadare, I. Aksidenti. Tiranë, 2010.f.197,228.(21)
- 13) Lloshi, Xhevat.Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika.Tiranë,2001,f.310. (22)
- 14) Kadare, I. Aksidenti. Tiranë, 2010,f.50,69,96,98,146.(23)
- 15) Kadare, I. Aksidenti. Tiranë, 2010,f.135,138.(24)

## Historia e Çamërisë në Këngë Popullore

**dr. proc Diana Mone**

Universiteti i Durrësit

Luftrat për liri dhe pavarësi dhe mbrojtjen e trojeve shqiptare nga lakmitë e fqinjëve tanë kanë gjetur shprehjen e vet në këngët popullore të Çamërisë. Ato u bëjnë jehonë ngjarjeve të rëndësishme dhe figurave të shquara të Çamërisë në periudha të ndryshme historike.

Historia e Çamërisë e këtyre shekujve të fundit identifikohet me disa familje të mëdha të Çamërisë, si Çaparejtë e Margëlliçit, Pronjatët dhe Dinejtë e Paramithisë, Dematët, Sejkatët e Dojakët e Filatit, Daljanejtë e Tajkove të Konispolit, etj. etj.

Le të ndalemi në disa ngjarje historike në Çamëri dhe figurat drejtuese çame, që i përjetësojnë këngët popullore.

Në mesin e shek. XIX (1847) në Shqipërinë e jugut plasi një lëvizje antiosmane, e drejtuar nga Zejnel Gjoleka. Në atë lëvizje kundër Portës së Lartë, përkrah Zejnel Gjolekës ishte dhe Hasan Çapari me djemtë e Çamërisë: këtë dëshmi historike na e përcjellin këto vargje të këngës popullore çame:

Labërinë e ngriti Gjoleka  
Dhe Çamërinë Hasan Çapari

Meqë jemi tek fisi i madh i Çaparenjve të Margëlliçit, është me interes të përmendim një figurë me emër në histori, që kënga popullore na e përcjell jo vetëm guximtar, por dhe të zotin e shpatës, ky është Lule Çapari. Ai me bashkëatdhetarët çamë i nxorri shumë telashe komandës osmane në Çamëri. Ai ndiqej hap pas hapi për t'u kapur, por forcat osmane e kishin të vështirë, se çdo fshat e shtëpi në Çamëri, pa dallime fetare, qoftë muslimane, qoftë e krishterë, atij i siguronte besë, strehim dhe mbrojtje. Kënga popullore përshkruan një moment kritik për heroin Çam, i cili në kohën që ishte në rrezik për t'u kapur gjendej në një fshat të krishterë, Morfat (në rrethinat e Pargës).

Lule Çapari nuk kishte të njohur, besnikë të tij, por megjithatë për t'u shpëtuar ndjekjeve të forcave turke, kënga popullore na sjell lëvizjet dhe veprimet e tij në këto vargje:

Lule agai ia hipi kalit,  
Çau fushën e Morfatit,

dhe më tej kënga vazhdon të tregojë se Lule Çapari iu drejtua një plake të krishterë për të gjetur mbrojtje me besë:

- Ti moj plaka morfaqote,  
Ke vend për mua sonte?  
- Kam sonte dhe sisonte,  
bujrum Lule trim, zotrote.

Plaka e krishterë morfaqote e mori në besë again musliman të Luaratit duke i shpëtuar jetën. Kjo këngë përcjell dy mesazhe të rëndësishme:

së pari, bujaria dhe mikëpritja çame, dhe miku në shtëpinë e mikpritësit kishte garanci të plotë; së dyti, vargjet e kësaj kënge shprehin qartë se muslimanët e të krishterët në Çamëri kishin marrëdhënie shembullore të harmonisë e të bashkëjetesës paqësore. Ajo u prish kur ndërhyri propaganda fetare, kisha, kleri dhe propaganda e egër e nacionalizmit.

Në periudhën e Lidhjes shqiptare të Prizrenit, 1878-1881, rreziku i aneksimeve të trojeve shqiptare në Shqipërinë e Poshtme, i dha zhvillime të reja lëvizjes patriotike në Çamëri.

*(Qëllimi i kësaj kumtese nuk është shtjellimi i ngjarjeve, por jehona që gjejnë ato në këngën çame.)*



Edhe në Çamëri, si në shumë vise shqiptare, ishin krijuar Komitetet e Lidhjes, siç ishte ai Margëlliçit dhe i Artës. “Çamërit ishin të vendosur të mbronin trojet e tyre deri në pikën e fundit të gjakut të tyre, dhe vendin e nderit, që Zoti ua kishte besuar”<sup>1</sup>.

(Ndër) Drejtuesit e Komiteteve të Lidhjes Shqiptare në Çamëri, (ku) përmendim Vejsel Dinon dhe Abedin Pashë Dinon. Burimet historike shënojnë një ngjarje të rëndësishme, një tubim madhështor në fshatin Mazrek. Ky tubim ishte manifestim proteste kundër planeve që kurdisnin Fuqitë e Mëdha për t’i aneksuar Greqisë krahinën e Çamërisë.

Një këngë popullore e trajton këtë temë. Ja disa vargje:

Zejbekut era i ra,  
Për besën që u lidh në Kaza,  
Margëlliç- turq e kaurë,  
Me dugrah në dorë të tërë,  
Ata vetë janë të zotë,  
Botë<sup>2</sup> hanë e vend s’lëshojnë,  
të tre milët do luftojnë.  
Kazatë besën lidhnë,  
Glishtrit prenë e gjaknë pinë,  
Ikrar<sup>3</sup> me Abdyl Bejnë dhanë,  
Komandar Jakup Çaparë.

Në këtë Beslidhje ndërkrainore në hapësirën çame, nuk kishte të bënte me fanatizmin fetar por me vendosmërinë e shqiptarëve të Çamërisë, me qëndrimin e tyre burrëror, që u buronte nga zemrat, mbrojtjen e trojeve nga lakmitë e grabitqarëve fqinj.

Ngjarjet në Çamëri, në periudhën e Lidhjes Shqiptare dhe drejtuesit e saj, poeti popullor i përjetësoi në vargje:

Ti moj Lidhja Shqipëtare,  
Tunde male, tunde krale,  
Tunde Evropën e madhe.

Dhe një këngë tjetër i këndonte Abedin Pashë Dinon me këto vargje:

Abedin Dino, bajrak,  
Evropës i dhe xhevap,  
-Vendin tim nuk e ap  
Pa mbitur dheun në gjak.

Kënga popullore çame është e pasur me kontributin e shqipëtarëve të Çamërisë dhe të drejtuesve të saj me tërë larminë e ngjarjeve të shënuara historike.

Unë do ndalem vetëm në disa prej tyre.

Kur flasim për historinë e Çamërisë në këngët popullore, nuk mund të lëmë pa përmendur qëndresën e çamëve në vitin 1912-1913 për mbrojtjen e trojeve të tyre nga rreziku i pushtimit grek:

Dolli greku në Filipjadhë,  
djeltë çamë u ngrënë e vanë,  
Bezhan i ziu bezhan<sup>4</sup>,  
Rreth e rreth me istikam<sup>5</sup>,  
Pa bukë e pa ujë e mban.

Dhe vargjet e një kënge tjetër tregojnë se në ç’rrethana të vështira gjendeshin vullnetarët çamë, por ata ishin të vendosur:

Mbahu o Bezhan i shkretë,  
Se ke trima si je vetë,  
Gjashtë muaj në istikam,  
Pa bukë e pa duhan.

Zemrat e popullsisë çame ishin të zhuritura edhe për arsimin kombëtar, për shkrimin dhe leximin e gjuhës amtare. Nëpërmjet këngës popullore, u thurën hymne me plot dashuri e mirënjohje përkrahësve të arsimit kombëtar.

Për ta konkretizuar këtë ide, kam veçuar vargje të këngëve popullore çame për dy figura të shquara të përhapjes së arsimit kombëtar në Çamëri. Për Sabri Prevezën nga Preveza:

Sabri Preveza s'u lodhe,  
Nat' e ditë ti punove,  
Me pushkë e me penë luftove,  
Gradat e turkut s'i deshe ,  
Shkrive gjithë pasurinë,  
për të hapur diturinë.

Ndërsa kënga popullore çame për atdhetarin Mehmet Sejko nga Filati (i ati i Taho dhe Teme Sejkos), tregon se si vuri në dispozicion odat e shtëpisë së tij për arsimin e fëmijëve të bashkëqytetarëve të tij në Filat:

Mehmeti hapi shtëpinë,  
Për të hapur diturinë,  
Atje e bëmë gostinë.

Dhe, së fundi, është me interes të theksohet se kënga popullore çame shpreh dhembje të thellë për fushatën e spastrimit etnik dhe shpronësimet e çamëve muslimanë në Çamëri dhe për t'i detyruar ata me kuadrin e shkëmbimit të popullsisë greko-turke 1923-1938 të lënë trojet e tyre dhe, nën presionet e dhunshme të administratës greke, emigrojnë në viset e Anadollit. Ja vargjet e një kënge popullore që shprehin dhimbje dhe trishtim për dramën çame:

Gjithë çamët muslimanë,  
Edhe pse s'janë turq, por shqipëtarë,  
Rehat në Çamëri s'i lanë.

Dhe vargjet e një kënge tjetër tregon se si u grabitën padrejtësisht pronat e çamëve:

Në Athinë u dha ekzarë<sup>6</sup> ,  
T'u marrim çamëve mallë,  
E pastaj të bëjmë pallë.

Atë që Athina nuk e realizoi në vitet '20- '30 , ia arriti me bandat e Napoleon Zervës dhe forcat e Plastirës t'i çrrënjoste Çamët nga trojet e tyre dhe sot atij komuniteti i mohohet të shkelë në trojet e të parëve të tyre.

Çamët kanë me vete të drejtën historike dhe kjo e drejtë i bën optimist se do të vihet njëditë në vendin e vet.

#### Shënime :

1) W. Chirol në veprën e tij "twixt greek and turk.....London, 1880, f. 246; 2) dhë; 3) Vendosën, morën vendim; 4) Qendra e luftimeve (vendi i qëndresës), 5) llogore; 6) vendim.

## Papët dhe Nëna Tereza

dom Lush Gjergji

vikar i përgjithshëm i Ipeshkëvisë së Kosovës, Prishtinë

### • Papa PIU XII dhe e Lumja Nëna Tereze

Nëna Tereze ishte e njohur, çmuar dhe nderuar, por edhe e përkrahur nga Papët, pa të cilët ajo sigurisht nuk do të ishte Misionarja me e njohur e shekullit XX, Nëna e botës së mjerimit dhe të vuajtjes, “Samaritanja” e ditëve tona në mbarë botën.

Papa Piu XII ishte i njohur me qëndrim të vendosur që Kisha Katolike s’kishte më nevojë për themelime rregulltare të reja, por për shpirt dhe frymëzim të Zotit në jetën dhe veprimtarinë e tyre.

Megjithatë përjashtim ishte “rasti” i Nënës Tereze. Ajo i kishte shkruar Papës Piu XII kështu: “Zoti më ka thirrur që t’i braktisja të gjitha për t’ia dhuruar vetveten Atij në shërbim të më të varfërve që askush nuk i donte”.

Nëna Tereze kishte lutur dhe kërkuar së pari që të dilte prej “*Motrave të Loretos*”, sipas urdhrit dhe kërkesës së Zotit. Këtë ia kishte lejuar Papa Piu XII më 12 gusht 1948. Me këtë njëkohësisht fillonte jetën dhe veprimtarinë e re, por edhe të mbeste murgeshë, nën autoritetin e arqipeshkëvit të Kalkutës.

Në vitin 1950 Papa Piu XII e kishte autorizuar edhe zyrtarisht themelimin e rendit të ri të “*Misionareve të Dashurisë*”, që ishte edhe nisja e mbarë dhe e bekuar e këtij rregullit të ri të motrave.

### • Shën Gjoni XXIII dhe e Lumja Nëna Tereze

Intervista me Imzot Loris Francesco CAPOVILLA, arqipeshkëv, Sekretari personal i Papës Gjoni XXIII (1958-1963), tani kardinal i Kishës Katolike.

*Shkëlqësi, vlerësimi i Juaj dhe i Papës Gjoni XXIII për Nënë Tereze?*

“Unë kam një nderim të posaçëm për Nënë Tereze. Ajo doli prej atdheut të saj të vogël, por zemra e saj ishte zgjeruar duke vajtur në një vend dhe shtet tejet të madh, në Indi. Ajo ka ndier në brendinë e saj se duhej të bënte diçka për ata njerëz... E ka kuptuar se thirrja e saj ishte Dashuria. Kjo grua e përvuajtur, por tejet inteligjente dhe kreative, e vuri jetën e saj dhe të “*Misionareve të Dashurisë*” në shërbim. Bota e ka hetuar dhurimin e saj për të tjerët, sepse ajo është bërë Nëna e të braktisurve. Kështu bota ka besuar në mrekullinë e dashurisë...”.

Për vlerësimin e Shën Gjoni XXIII ndër të tjera tha: “*Papa Gjoni XXIII fliste shpesh për Nënë Tereze me mua dhe me Sekretarin e Shtetit të Vatikanit, kardinal Tardinin, si dhe me të tjerët për këtë Grua të madhe dhe të mrekullueshme. Thjeshtësia dhe dashuria ishin fuqia e saj. Është bukur që një popull i vogël ka një Nënë kaq të madhe. Kur vdiq dhe qe varrosur në Kalkutë në një meditim pata thënë kështu: Arkivolja e vogël dhe Nëna e Madhe... Ajo në vitin 1971 mori Shpërblimin e Paqes “Gjoni XXIII”.*

Sotto Il Monte, Bergamo, 18. 09. 2008

### • Papa i Lumi Pali VI dhe e Lumja Nëna Tereze

Papa Pali VI ka përcjell me vëmendje, kujdes dhe dashuri atërore jetën dhe veprën e Nënës Tereze. Ja vetëm disa dëshmi dhe hapa konkret në këtë kuptim dhe drejtim. Deri sa shumë njerëz të Kishës, si dhe jashtë saj, nuk mund ta kuptonin karizmën e veçantë të Nënës Tereze, dashurinë flijuese dhe dhuruese për Zotin dhe Njeriun, pa kurrfarë dallimi dhe përjashtimi, Papa Pali VI pati mirëkuptim dhe përkrahje të plotë për Nënë Tereze, nëpërmjet saj, si thoshte ai “*për veprën e Zotit*”.

Do të mbes në histori vizita e tij baritore Indisë (1964), me rastin e Kongresit Eukaristik. Gjatë ditëve 3-6 dhjetor 1964 ishte Kongresi Eukaristik në Bombay, me pjesëmarrjen e Papës si dhe të Nënës Tereze. Përshtypja e Papës për jetën dhe veprën e saj ishte aq e madhe, tronditëse, sa që vendosi t’ia dhuronte automjetin personal “*Cadillac*” me të cilin kishte lëvizur dhe udhëtuar në Indi me këtë motivim: “*për t’i ndihmuar asaj në dobi dhe në të mirë të të varfërve*”. Nëna Tereze e qiti këtë automjet në Lotari të Indisë dhe

fitoi mjaft para, kuptohet, si gjithmonë, për të varfëritë ndër më të varfër. Ky gjest e bëri Nënë Tereze shumë të njohur në Kishë dhe në botë.

Më 10 shkurt të vitit 1965 me dekretin papnor “*Decretum laudis*” Papa Pali VI e kishte pranuar dhe lartësuar bashkësinë e “*Misionareve të Dashurisë*” si “*kongregatë të drejtës papnore*”. Kjo ua mundësoi atyre që së shpejti të mund të përhapeshin dhe vepronin në mbarë botën. Fill pas kësaj mirënjohjeje dhe pranimit “*Misionaret e Dashurisë*” filluan zgjerimin në botë: në Venecuelë (26 korrir 1965), shtëpia e parë jashtë Indisë e kështu me radhë në Evropë, Afrikë, Amerikë, kudo në botë.

Papa Pali VI përkrahu edhe themelimin e Shoqatës ndërfitare dhe ndërkombëtare “*Bashkëpunëtorët e Nënës Tereze*” më 29 mars 1969, duke dhënë bekimin dhe pëlqimin e tij.

Papa Pali VI, i kishte dërguar një çek personal “*për të varfëritë e Nënës Tereze*”, duke përkujtuar dhe ndihmuar gjithnjë veprën e saj në dobi të të mjerëve në Indi dhe në botë.

Më 22 gusht 1968 Nëna, Tereze hapi shtëpinë e parë të “*Misionareve të Dashurisë*”, në Romë në lagjen “*Torfiscale*”, gjithnjë me ftesë dhe bekim të Papës Pali VI.

Më 6 janar 1971, Papa Pali VI ia dorëzoi Nënës Tereze “*Shpërblimin për Paqe – Gjoni XXIII*”, që dëshmonte edhe njëherë nderimin, përkrahjen, dashurinë e tij për Nënë Tereze, për “*Misionaret e Dashurisë*”, për të varfëritë e botës.

Këto janë disa nga çastet e bashkëpunimit mes Papës Pali VI dhe Nënës Tereze.

#### • **Papa Shën Gjon Pali II dhe e Lumja Nëna Tereze**

Njerëzit e mëdhenj të Zotit fill njihen dhe bashkëpunojnë me njëri - tjetrin, sepse janë të Zotit dhe të Popullit; kanë një burim dhe frymëzim të përbashkët: ZOTIN DASHURI dhe VËLLAUN NJERI.

Ja vetëm disa pika të përbashkëta dhe bashkëpunimi mes Papës Shën Gjon Pali II dhe Nënës Tereze.

Nëna Tereze, para se ta pranonte Shpërblimin Nobel për Paqe, ndër të tjera u këshillua edhe me Papën Gjon Pali II, i cili i pati thënë kështu: “*Pranoje këtë Shpërblim dhe nderim të madh në emër të Zotit dhe të varfërve të mbarë botës, të cilëve Ti kaq shumë iu ndihmon dhe u shërben*” (nga rrëfimi gojor i Nënës Tereze, shënuar në ditarin tim).

Fjala e parë e Nënës Tereze, në aeroportin e Oslos ishte: “*E pranoj këtë Shpërblim në emër të Zotit dhe të varfërve të botës...*”<sup>1</sup>

Pas pranimit të Çmimit Nobel për Paqe (Oslo 10 dhjetor 1979), Nëna Tereze e vizitoi në Romë Papën Gjon Pali II. Pas urimit dhe bisedimit të përzemërt me të, Nëna Tereze i tha Papës: “*Kam vendosur të tërhiqem nga jeta botërore (publike). Do t’iu kthehem të varfërve dhe të gërbulurve...*”.

Papa, pasi e dëgjoi me vëmendje dhe me dashuri, i tha: “*Kurrsesi, sepse Ti je dëshmitarja më bindëse e Ungjillit dhe e Dashurisë së Zotit për çdo njeri. Të lutëm që të shkosh kudo që të thërrasin nëpër botë...*”.

Dhe Nëna Tereze aty për aty e ndërroi mendimin, qëndrimin dhe vendimin e saj. Duke komentuar këtë, më tha: “*Nuk pata tjetër zgjidhje. Fjala e Papës për mua është urdhër, është vullneti i Zotit*” (nga ditari im).

Së bashku me Papën Gjon Pali II, Nëna Tereze ishte shtegtarja e paqes dhe e dashurisë në mbarë botën, duke tejkaluar të gjithë kufijtë, ndarjet, përçarjet, dallimet, për ta dëshmuar fuqinë e së vërtetës dhe të dashurisë.

Në vitin 1980 Papa Gjon Pali II e ftoi Nënë Tereze në Romë dhe ia dhuroi çelësin e shtëpisë për fëmijë dhe nëna të braktisura.<sup>2</sup>

Papa Gjon Pali II, s’ u ndal me kaq, sepse dëshironte ta kishte Nënë Tereze sa më afër, në Vatikan. Mu për këtë vendosi t’ia dhurojë një shtëpi strehimore në Vatikan, pranë Sallës së Audiencave “*Pali VI*”, si mirënjohje dhe përkrahje personale. Kjo shtëpi quhet “*Dono di Maria*” (Dhurata e Marisë), dhe është një ndër qendrat e rëndësishme të “*Misionareve të Dashurisë*” në botë.<sup>3</sup>

Gjatë vizitës së Papës Gjon Pali II në Indi, ishin së bashku si “*dueti*” i fesë dhe i dashurisë së krishterë. Gjatë kthimit në Vatikan, gazetari italian Renato FARINA ndër të tjera e pyeti Papën: “*Si keni qëndruar kaq shumë gjatë këtyre ditëve të vizitës në Indi? Ne si gazetarë ishim të lodhur duke përcjell vizitën Tuaj. Ku është burimi i gjithë kësaj fuqie?*”.

Papa u përgjigj me buzëqeshje kështu: “*Kjo nuk është vepra ime, por e Zotit... Kjo vizitë baritore ishte*

më e lehta, sepse afër meje, me mua ishte Nëna Tereze e Kalkutës. Mjaftonte që me gisht ta tregoja atë, dhe të gjithë e kuptonin shumë mirë dhe me pak fjalë porosinë e Krishtit, të Kishës Katolike, të Krishtërit. Ajo është dëshmitarja burimore e jetës dhe e fesë së krishterë”.<sup>4</sup>

Më 13 janar 1989, së bashku me Imzot Nikë Prelën dhe me shumë ipeshkvij nga ish-Jugosllavia, bashkëmshuam me Papën Gjon Palin II. Pas meshës vijoi takimi dhe biseda me të.

Unë, me atë rast, ia dhurova dy libra të mia në gjuhën italiane kushtuar Nënës Tereze:

*Madre Teresa, prima biografia completa, Jaca Book, Milano, 1983;*

*Madre Teresa e le sue radici, EMI-PIEMME, 1987, me këtë përkushtim: “Papës Gjon Palit II, Mikut të madh të Nënës Tereze dhe të Popullit Shqiptar: “SHENJTËRI, këtë monografi e kemi botuar me rastin e 75-vjetorit të lindjes së Nënës Tereze, ku janë të pranishëm më se 175 autorë shqiptarë: poezi, prozë, pikturë, skulpturë dhe muzikë (katolikë, ortodoksë dhe myslimanë)”*.

Papa më tha: “Mirë, tejet mirë, sepse ajo është shqiptare. Keni bërë shumë mirë që e keni botuar një libër kaq të pasur dhe tejet të bukur. Ajo ka lindur në Shkup. Por me prejardhje ishte nga Prizreni, shqiptare, ZEMRA E POPULLIT TUAJ, E MBARË KISHËS. KËSHTU KULTIVOHET DIALOGU, BASHKËPUNIMI DHE BASHKËJETESA MES POPUJVE DHE FEVE. URIME DHE VETËM PËRPARA!”.<sup>5</sup>

Gjatë vizitës së Papës Gjon Pali II Shqipërisë, në Shkodër, ai për Nënën Tereze tha kështu: “Të dashur, nuk mund mos ta përshëndes një njeri fort të përvojatur, që ndodhet mes nesh. Është Nënë Tereza e Kalkutës. Të gjithë e dini nga vjen, cili është Atidheu i saj. Atidheu i saj është këtu. Edhe në kohët e izolimit të plotë të Shqipërisë ishte kjo rregulltare e përvojatur, kjo shërbyese e përvojatur e më të varfërve, që përçonte në tërë botën emrin e Atidheut tuaj. Në personin e Nënës Tereze Shqipëria është nderuar gjithmonë. Është ky misioni i saj dhe i të gjithë atyre që, porsiaj, janë ndjekës të vërtetë të Krishtit, apostuj të dashurisë e të dhembshurisë. Ju falënderoj sot në emër të Kishës Katolike, ju falënderoj, të dashur shqiptarë, për këtë bijë të tokës suaj, të popullit tuaj...”.<sup>6</sup>

Papa në Tiranë për Nënën Tereze tha: “E si mos ta kujtojmë tani, një bijë të zgjedhur të popullit shqiptar, Motrën Tereza të Kalkutës, nënë e shumë të varfërve ndër më të varfëritë në botë? Me zjarrin e fesë në kraharor, kjo grua e vogël dhe e madhe njëkohësisht, sjell dhe ruan brenda vetes hovin e bujarisë së papërmbajtur dhe të pamposhtur të zemrës shqiptare”.<sup>7</sup>

Me rastin e “kthimit në Shtëpinë e Atit” – vdekjes së Nënës Tereze, (5 shtator 1997), Papa Gjon Pali II tha: “Në këtë moment të lutjes më rri në zemër, që të kujtoj motrën tonë nga Kalkuta, Nënë Terezën, e cila para dy ditësh i dha fund jetës së vet të gjatë në tokë. Unë pata rastin ta takoj shpesh, dhe në kujtesën time rri figura saj e vogël plot jetë në shërbim të më të varfërve ndër të varfër, e cila ishte e përmbushur nga një forcë e brendshme e pashtershme: forca e dashurisë së Krishtit...Duke e gjurmuar Ungjillin, u bë për çdo njeri “samaritani i mirë”...Përderisa po ia besojmë Hyjit shpirtin e ngritur të kësaj rregulltarje të përshpirtshme dhe besimtare, e lusim Virgjërën Mari që t’u jap ngushëllim bashkëmotrave të saj dhe të gjithëve që e njohën dhe e deshën”.<sup>8</sup>

Papa Gjon Pali II lejoi përjashtimin kanonik dhe përshpejtimin e procesit të lumturimit të Nënës Tereze, dhe atë e lidhi me dy ngjarje tejet të rëndësishme: 25 vjetorin e Pontifikatit të tij në Selinë e Shën Pjetrit dhe Ditën Botërore të Misioneve. Në meshën e lumturimit të saj, në Sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan (19 tetor 2003), ai ndër të tjera tha: “Jam personalisht i falënderueshëm ndaj kësaj Gruaje të guximshme, të cilën gjithmonë e kam pasur afër vetes. Ikona e samaritanit të mirë, ajo shkonte gjithkund për ta shërbyer Krishtin ndër të varfër ndër më të varfër. As konfliktet dhe luftërat nuk e kanë ndalur atë. Herë pas here vinte tek unë dhe më fliste për përvojën e saj në shërbim të vlerave ungjillore... Me ndjenja të thella jemi këtu për ta përkujtuar sot Nënën Tereze, shërbëtoren e madhe të të varfërve, të Kishës dhe të mbarë botës... Jeta e saj ishte e thadruar në dashuri si shpallje e guximshme e Ungjillit...”.<sup>9</sup>

Duhet përmendur që sipas dëshirës dhe kërkesës së Papës Gjon Pali II janë përkthyer dhe botuar tre libra të Don Lush Gjergjit në polakishte, me tirazh milionësh:

*Madre della carita (Matka Teresa), 1994; Vivere, Amare, Testimoniare, /Zyc’, Kochac’, Sëiadczuc’/, 1999; dhe për lumturimin e Nënës Tereze L’amore in azione (Matka Teresz, Milosc czynach), 2003.*

Këto vepra, autori ia ka paraqitur dhe dhuruar Papës personalisht, së bashku me botuesin italian VELAR nga Bergamo, dhe botuesin polak Etërit Pallotinë nga Varsava.

Kulmi ishte ky: Papa i kërkoi këto botime në gjuhën polake dhe në gjuhët tjera: italisht, anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht...për t'ua dhuruar delegacioneve më të larta kishtarë dhe shtetërore gjatë vitit Jubilar 2000.

Më këtë, dëshmoi edhe njëherë nderimin dhe dashurinë ndaj së Lumes Nënës Tereze, si dhe ndaj Kishës dhe popullit tonë.

Dhe në fund ta përmendi edhe këtë: Papa Gjon Pali II, ishte Miku i madh i Nënës Tereze, nëpërmjet saj edhe i Popullit Shqiptar. Qysh prej fillimit të Pontifikatit në Selinë e Shën Pjetrit (16 tetor 1978), deri të ndërrimi i jetës (2 prill 2005), për festa të mëdha si Kërshëndellat dhe Pashkët, Shën Pjetri, kur jepet Bekimi Apostolik “*Urbi et Orbi*” (Qytetit dhe Botës), gjithmonë ka folur dhe uruar edhe në gjuhën shqipe, bile ndër gjuhët më të para.

Edhe kjo, si dhe e tërë jeta dhe veprat e tija, dëshmojnë se na kishte në zemër.

#### • **Papa Benedikti XVI dhe e Lumja Nëna Tereze**

Papa Gjon Pali II kishte një nderim, admirim dhe bashkëpunim të veçantë me të Lumen Nënën Tereze. Ajo pati ndikuar që ky Papë vërtet i madh të ishte edhe miku dhe përkrahësi i Kishës dhe Popullit Shqiptar në shumë kushte dhe rrethana.

Këtë drejtim dhe orientim e ka edhe papa i sotëm në dorëheqje Benedikti XVI i cili në disa raste edhe botërisht e ka lavdëruar Nënën Tereze duke e paraqitur atë si shembull jete dhe dëshmitare bindëse të dashurisë së krishterë.

Në enciklikën e parë të tij “*Deus Caritas est*” (Hyji është Dashuri) Papa shkruan kështu për Nënën Tereze: “*E Lumja Nënë Tereza e Kalkutës është një shembull shumë i dukshëm i faktit se koha që i kushtohet Hyjit në lutje jo vetëm nuk e dëmton efektshmërinë dhe zellin e dashurisë për të afërmin, por në realitet është burimi i pashterëshëm i saj. Në letrën e saj me rastin e Kreshmeve të vitit 1996 e Lumja shkruante kështu: “Ne kemi nevojë për këtë lidhje intime me Hyjin në jetën tonë të përditshme. E si mund ta sigurojmë? Përmes lutjes!”* (Benedikti XVI, Hyji është Dashuri, Letra enciklike mbi dashurinë e krishterë, Nën kujdesin e Arqipeshkvisë Shkoder – Pult, Qershor 2006, nr. 36, fq. 98).

Më 16 dhjetor 2007, e diela e III-të e Ardhyes Benedikti XVI ndër të tjera tha: “*Gëzimi i krishterë buron nga kjo siguri: Zoti është afër nesh, është me mua, është me ne, në gëzime dhe në pikëllime, në shëndet dhe në sëmundje, si miku ynë besnik...*”

*E Lumja Nëna Tereze e Kalkutës a nuk ishte ndoshta dëshmitarja e paharrueshme e gëzimit ungjillor në kohën tonë? Ajo jetoi për çdo ditë në lidhje me mjerimin, degjenerimin e njeriut, me vdekjen. Shpirti i saj e ka njohur sprovën e natës së errët të fesë. Mëgjithatë ajo iu ka dhuruar të gjithëve buzëqeshjen e Zotit.*

*Në një shkrim të saj lexojmë: “Ne e presim me paduresë parajsën, ku është Zoti, por ne kemi mundësi të jemi në parajsë qysh tani sa jemi në këtë botë, shi nga ky çast. Të jemi të lumtur në Zotin domethënë: të duam si do Ai, të ndihmojmë si ndihmon Ai, të dhurohem si dhurohej Ai”* (La gioia di darsi agli altri, Ed. Paoline, 1987, fq. 143).

*Po, gëzimi depërton në zemrën e atij që vihet në shërbim të të vegjëlve dhe të varfërve. Kush dashuron kështu, Zoti banon në të, shpirti i tij është në gëzim...”*

Papa Benedikti XVI më 4 janar 2008 e vizitoi shtëpinë e Misionareve të Dashurisë “*Dono di Maria*” (Dhurata e Marisë), të cilën Papa Gjon Pali II para 20 viteve ia kishte dhuruar Nënës Tereze në Vatikan, para Sallës së Audiencave “Pali VI”, për t’i pranuar dhe strehuar të varfrit e Romës, ata që nuk kanë as kullm mbi kokë.

Kjo shtëpi-strehimore pranon në ditë deri në 100 vetëve, disa edhe për bujtje apo për kërkim të punës dhe për çështje tjera, për një kënd sigurie dhe dashurie në botën anonime që shpesh i përbuzë të mjerët, sidomos botën femërore.

Edhe ky gjest dëshmon bindshëm sa Papa Benedikti XVI çmon jetën dhe veprën e Nënës Tereze dhe dëshminë e dashurisë së krishterë të Misionareve të Dashurisë, si dhe të varfrit.

Me këtë rast ai ndër të tjera i tha fjalët e Nënës Tereze: “*Është Krishtlindje sa herë i krijojmë Jezusit mundësinë t’i dojë të tjerët përmes nesh*”.

Dhe vazhdoi kështu: “*Vite të tëra, kur isha Prefekti i Kongregatës për Doktrinën e Fesë, kam kaluar*



shumë orë të mia afër këtij institucioni të merituar, që e ka dëshiruar paraardhësi im, Shërbëtori i Zotit Gjon Pali II, i cili ia ka besuar këtë të Lumes Nënës Tereze të Kalkutës...

Kushdo që trokit në derën tuaj merr si dhuratë nga Maria pritjen me krahë të hapur nga ana e motrave dhe e vullnetarëve... Uroj që ky stil i dashurisë ungjillore ta vulosë e ta dallojë gjithnjë thirrjen tuaj në mënyrë që, përpos ndihmës materiale, t'iu komunikoni atyre që i takoni për dite, të njëjtin zjarr për Krishtin, që gjallëroi gjithnjë jetën e Nënës Tereze...".

Papa Benedikti XVI e përfundoi këtë vizitë me këto fjalë: "Kjo shtëpi e ka një emër të bukur "Dhurata e Marisë", dhe na fton të gjithëve, në fillim të vitit të ri, ta dhurojmë jetën tonë pa kurrfarë lodhje".

#### • Papa Françesku dhe Nëna Tereze

Papa Françesku dhe Nëna Tereze, për mendimin dhe vlerësimin tim, janë si dy "binek" shpirtëror, sepse parimet dhe qëndrimet e tyre janë thellë ungjillore: thjeshtësia, përvujtëria, varfëria, mbi të gjitha feja dhe dashuria.

Këtë "ngjashmëri" e ka dëshmuar Papa Françesku në shumë raste duke e përmendur dhe paraqitur Nënën Tereze si "model" të jetës dhe dashurisë së krishterë për çdo njeri, sidomos për të vegjël, të nëpërkëmbur, të pambrojtur dhe të braktisur.

Këtë e ka shprehur Papa Françesku edhe në Letrën Enciklike "DRITA E FESË", kua ai thekson shumë qartë: **Pa fe s'ka as shpresë, si dhe pa fe dhe shpresë, nuk ka dashuri, që është përfundimi i logjikshëm i Papës.**

Feja fisnikëron, tejkalon dhe bujaron arsyen, mendjen, njohurinë, njeriun. Dashuria tejkalon edhe arsyen dhe e bënë të pavdekshme fenë, njeriun, dhe kështu na drejton ka e Vërteta dhe Jeta – Jezu Krishti.

Vuajtja me fe dhe dashuri është krejt ndryshe nga pësimi, dhembja, mërzia, lodhja, deri edhe dëshpërimi. Dy ndërmjetës të dritës së fesë, sipas Papës Françeku, janë Shën Françesku i Asizit dhe Nëna Tereze e Kalkutës, sepse feja nuk e harron vuajtjesin e botës, por është në shërbim konkret të drejtësisë dhe të paqes. "Për shumë burra e gra fetarë të vuajturit kanë qenë ndërmjetës drite. Për shembull për Shën Françeskun e Asizit i gërbuluri, apo për të Lumen Nënë Terezë e Kalkutës të varfrit e saj. Ata e kanë kuptuar misterin që gjendet në ta" (LF 57).

Nëna Tereze thoshte: "Fatkeqësia më e madhe e Indisë është mosnjohja e Jezusit", në harmoni të plotë me atë që thotë gjithnjë Papa Françesku për botën e sotme.

Shpallja publike e Dekretit mbi kanonizimin e së Lumes Nënës Tereze në përvjetorin e ditëlindjes së Papës Françesku, është edhe një dëshmi i mirë i Papës, si nderim dhe urim për Kishën Katolike, e cila në Vitin Shenjt të Mëshirës Hyjnore, do ta ketë "ikonën" e Mëshirës dhe të Dashurisë së krishterë për mbarë njerëzimin. Nëna Tereze thotë: "Jeta ime është një dhuratë për të tjerët".

Papa Françesku më 6 mars 2016 pas uratës Engjëlli i Tenzot për vrasjen e katër motrave "Misionare të Dashurisë" në Jemen tha: "Janë martiret e sotme! E këto nuk janë në krye të gazetave, nuk janë lajme! Këto dhurojnë gjakun për Kishën. Prandaj janë viktima të sulmit të atyre, që i vranë, por edhe të indiferencës, të globalizimit të kësaj indiference, të cilës nuk i bëhet fare vonë për asgjë... Nënë Tereza i shoqëroftë në Parajsë këto bija martire të bamirësisë e ndërmjetësiftë për paqen dhe respektin e shenjtë të jetës njerëzore".

#### Shenime:

1) Mbi këtë lexo: Dr. Lush Gjergji, Nëna jonë Tereze, Drita, 1990, fq. 196-209; 2) Lexo: Lush Gjergji, Nëna e Dashurisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2000, fq. 218; 3) Po aty, fq. 187; 4) Nga dëshmia e gazetarit të njohur Italian Renato Farina dhënë Don Lush Gjergjit në Milano në vitin 1987; 5) Më gjerësisht lexo: Drita, Ferizaj, 1-2/1989, fq. 1; 6) David Xhuxha, Papa në Shqipëri, vep. e cit. fq. 36; 7) Po aty, fq. 49-50; 8) Don Pren Kola, Nënë Tereza, dëshmi, kujtime, meditime, mbresa, Fjala Hyjnore, Prishtinë, 2004, fq. 9-10; 9) Lush Gjergji, Madre della carità, Velar, 2004, fq. 229-230.

## Katharsisi psikologjiko-religjioz në vargjet e një Shenjtoreje

Dr. proc Irena Alimerko

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Në këtë prag shenjtërimi të Nënë Terezës së gjithë njerëzimit dhe Gonxhe Bojaxhiut të gjakut shqiptar, do të dëshironim të ndaleshim në një përmasë paksa të panjohur të figurës së saj dhe pikërisht përmasën krijuese. Gonxhe Bojaxhiu do të thurte që në moshë fare të re poezi të vërteta që predikojnë dashurinë, paqen dhe besimin në Krisht. Nëse nga këto poezi do të "hiqnim" emrin e Nënë Terezës, dhe do t'ja paraqesnim lexuesit si një tekst pa përkatësi autoriale, përjetimi që këto poezi do të paraqesnin do të ishte i njëjtë si për çdo poet të vërtetë. Është ky pikë së pari shkaku kryesor që na shtyn drejt krijimtarisë poetike të Nënë Terezës. Teksa përhumbesh në këto predikime poetike, njëjtë si në Librin e Predikuesit në Shkrimet e Shenjta, lexuesi përjeton një katharsis të vërtetë shpirtëror dhe psikologjik.

*"Mos jeto me fotografi të zverdhura,  
këmbëngul edhe pse të gjithë presin të braktisësh.  
Mos lejo të ndryshket hekuri që është në ty.  
Bëj që në vënd të mëshirimit të të respektojë".*

Po t'i referohemi dialektikës hegeliane, katharsisi [...] paraqitet si një aspekt i funksionit të artit që është i ngjashëm me historinë, jetën dhe universin. Procesi kathartik i përshkruar nga Aristoteli nuk do të thotë një purifikim apo një ndryshim në karakterin apo cilësinë e pasioneve në vetvete, por një ndryshim në shpirtin e njeriut.<sup>1</sup> Poezitë e Gonxhe Bojaxhiut janë balsam e eliksir për shpirtërat e qenieve të lënduara nga bota dhe një udhërrëfyes për udhën e vërtetë.

*"Ki gjithnjë parasysh se lëkura rrudhet,  
flokët thinjen  
e ditët bëhen vite".*

Këto vargje i drejtohen psikologjisë dhe shpirtërave që e kanë bjerrur kuptimin e ekzistencës, duke shkaktuar një ndryshim të rrenjësishëm në këtë gjendje, nga skajet e pikëllimit në oazet e paqes. Psikika e lexuesit të këtyre vargjeve e përkap menjëherë se një shpirt i dliër është vetëm ai që frymon dhe gjeneron nën pushtetin e së mirës absolute, Zotit, krijuesit të universit. Plakja fizike, egoizmi, pesimizmi për humbjet e vogla apo të mëdha janë veçse sprova për ta jetuar dhe dashuruar jetën më fort dhe aspak shqetësime për ndryshken e hekurit brenda nesh.

Kjo lloj psikologjie për ta parë individin si burim drite dhe energjie edhe në çastet më pak dritëhënese sjell edhe katharsisin shpirtëror brenda recipientit të poezisë. Shpirti nuk zhytet më në asgjënë e gjërave pa kuptim, por mëson të dashurojë të dliërën, të bukurën dhe t'i këndojë hymne jetës me akordet më të thella të një zemre të përmbushur nga lumturia. Optimizmi gjeneron jetë, pesimizmi dhimbje. Dhimbja e pafund shumëfishon vetveten duke ndalur harenë të ngrohë zemrat tona.

*"Duaje jetën ashtu siç është  
Duaje në lumturi të plotë  
apo në vetminë absolute.  
Duaje kur je i fortë,  
Por mos duaj kurrë pa dashuri.  
Mos jeto kurrë pa jetë!"*

Filozofia kristiane e humanizmit dhe dashurisë dominon krejt opusin poetik të Gonxhe Bojaxhiut, nuk do të shihej si ndonjë arritje e veçantë artistike, nesë në to nuk do të predikohej forca e vullnetit të mirë. Vetëm me anën e këtij vullneti transformohet psikika pesimiste dhe shpirti do të dashuronte jetën edhe kur të gjithë do ta braktisnin.

*"Gjej kohë të bësh mirësi  
Është çelësi i parajsës".*

Koncepti i së mirës është forca kryesore lëvizëse që e shndërron botëkuptimin e një vdekatori qoftë në kënvështrimin shpirtëror, duke shkaktuar katharsisin religjuz, qoftë në këndvështrimin psikologjik, duke qenë se mendja qetohet kur shpirti bie në paqe hyjnore.

Sipas Kantit, është e pamundur të mendohet në botë, e në përgjithësi jashtë saj, diçka që mund të konsiderohet e mirë pa kufizime, me përjashtim vetëm të vullnetit të mirë.<sup>2</sup> Të mirat pa kufizime na vijnë veç nga Parajsa si vendmbërritja e çdo shpirti të çliruar nga mëkati. Ndaj duhet të gjejmë kohë për ta jetuar me dashuri udhëtimin tonë tokësor, në mënyrë që të plotësojmë premtimin e dhënë nga Perëndia në fillim të këtij udhëtimi. Poezitë e Gonxhe Bojaxhiut me filozofinë e tyre optimiste i japin dritë qenies për të parë edhe më thellë raportin e saj me jetën dhe universin, ç'ka është në fund të fundit qëllimi final jo vetëm i artit të poezisë.

Nga ana artistike këto poezi kanë një fjalor shumë të zgjedhur, ku në çdo varg asnjë detaj nuk është i tepërt dhe ku asgjë nuk mungon. Një poezi e drejtpërdrejtë ku forca e argumentit jetësor përmes metaforash kuptimplote buron dashuri dhe muzikë. Poezi himnizuese për Hyun dhe Udhën e Vërtetë shkruar në të njëjtën frymë si këngët e adhurimit në Shkrimet e Shenjta. Duke të sjellë po atë paqe, po atë rënie në oazet e një parajse të shumëëndërruar e të fortëshiruar, po atë katharsis shpirtëror, ku e ndjen veten siç do të thoshte një tjetër shkrimtar i madh shqiptar si Ernest Koliqi: "si të përshkuar nga mijëra shëndrita".

## Permbledhje

Gonxhe Bojaxhiu do të thurte që në moshë fare të re poezi të vërteta që predikojnë dashurinë, paqen dhe besimin në Krisht. Nëse nga këto poezi do të "hiqnim" emrin e Nënë Terezës, dhe do t'ja paraqesnim lexuesit si një tekst pa përkatësi autoriale, përjetimi që këto poezi do të paraqesnin do të ishte i njëjtë si për çdo poet të vërtetë. Është ky pikë së pari shkaku kryesor që na shtyn drejt krijimtarisë poetike të Nënë Terezës. Teksa përhumbesh në këto predikime poetike, njëjtë si në Librin e Predikuesit në Shkrimet e Shenjta, lexuesi përjeton një katharsis të vërtetë shpirtëror dhe psikologjik. Optimizmi gjeneron jetë, pesimizmi dhimbje. Dhimbja e pafund shumëfishon vetveten duke ndalur harenë të ngrohë zemrat tona. Poezi himnizuese për Hyun dhe Udhën e Vërtetë shkruar në të njëjtën frymë si këngët e adhurimit në Shkrimet e Shenjta. Kështu koncepti i së mires absolute (hyjnore) është forca kryesore lëvizëse që e shndërron botëkuptimin e një vdekatori qoftë në këndvështrimin shpirtëror, duke shkaktuar katharsisin religjuz, qoftë në këndvështrimin psikologjik, duke qenë se mendja qetohet kur shpirti bie në paqe hyjnore. Poezitë e Gonxhe Bojaxhiut me filozofinë e tyre optimiste i japin dritë qenies për të parë edhe më thellë raportin e saj me jetën dhe universin, ç'ka është në fund të fundit qëllimi final jo vetëm i artit të poezisë.

**Shënime:** 1) Adnan K. Abdulla, Catharsis in Literature, Indiana University Press, Bloomington, In, 1985, f.5; 2) Imanuel Kant, Themelimi i zakoneve shoqërore, Ajsela Koka, Botimet Dritan Tirana, Tiranë 2004, f. 61.

Tekst e Muzikë: **Agostino Sofis**  
 Arranxh.muzik.: **Vëllezërit Scaravaglione**  
 Këndojën: **Cosimo e Damiano Scaravaglione**

## Mëma Tirezja

Duart të ndëjtura te dora tënde e hapt  
 e milzra grika të hapura pa ngrën e pjot me et  
 e qaga të mallanjasura, lot e kurme të djersura  
 të shtunura e shprishta mbë truall  
 sikur duken gjithë të vdekura...  
 E Ti përpara, grua e vogul, ti pjakarele më e holl  
 si Shën Mëri e dashur me zëmër e me mallë  
 terje lot e gjak e jet e diersë e nëmuri  
 me zëmërën paq ...  
 Jatrua pa jatri  
 që shroje shpirtin mbrënda  
 më funu njer te zëmëra  
 njer ku pundaret sprënxa...  
 Ktë ishe ti, një dor e ndëjtur  
 një det pjot ëmbelsi, ktë ishe ti!  
 Ishe grua ishe mëm e dashur  
 ishe ujt që nëng bën dëmë  
 ishe ngrën e dielli që dritson  
 ishe hënë, ishe drita që na bën.....  
 E agimi që shkelqen te ki dhe që qindroj  
 pa frim  
 nani ç'ike e më nëng vjen !  
 Sot të mbanj mend te zëmëra një cik më shumë  
 se rrënja tënd është edhe si ajo tim  
 e të siell te dheu si një ikon  
 se të dua shoh samënjëhere shënjt e bën....  
 Ishe grua, ishe mëmë e dashur  
 ishe lule te një dhë i thajtur...  
 një ëmbelsi që m'u rrit te zëmra e madhe  
 që të lehej mbrënda e paq ju leve e paq ju bëre  
 Një ëmbëlsi që sot na sallvon  
 se përmbërnda dhezen një sprënxë  
 e sot një illë doja të dhezja  
 e t'e thrisja 'Mëma Tirezja' !

**Alisa Velaj**  
 nga Vlora

## Heshtohu, heshta ime

*Monolog pas një takimi imagjinar me Nënë Terezën*

Heshtohu heshta ime  
 dhe shih gurët si përndriten netëve  
 në yje.  
 I mahnitshëm udhëtimi i tyre  
 prej oborrit të shtëpisë...  
 Shih ditën si i merr me vete po k'ta yj'  
 e i lë ngado të ftohur e pa ngjyrë.  
 Rënia pingul në zemër të tokës  
 ringjiz diej të trishtë memecë.  
 Hesht heshta ime  
 edhe më përtej heshtjes hesht  
 me të fshehtë e përndritjes si testament!

*(Durrës, më 08.06.2016)*

## MADRE TERESA

Mani tese alla tua mano aperta / mille bocche aperte,  
 affamate, assetate / e ferite infette, lacrime e corpi  
 sudati / gettati e sparsi per terra / come se fossero  
 tutti morti.../ E li davanti Tu, piccola ed esile / come  
 una madonna amata / asciugavi le lacrime, il sangue,  
 / vita, sudore e povertà con amore e / col cuore in  
 pace... / Dottore senza medicine / guarivi lo spirito  
 dentro / profondamente fino al cuore / fin dove si  
 ferma la speranza... / Questo eri tu, una mano tesa /  
 un mare pieno di dolcezza, /questo eri Tu!!! / Eri  
 donna eri una madre amata / eri l'acqua che non fa  
 male / eri cibo e sole che illumina / eri luna, eri la  
 nostra luce / e l'alba che brilla in questo mondo che  
 rimane / / senza respiro / ora che te ne sei andata e  
 non ritorni più ! / Oggi ti ho nel cuore un po' di più /  
 perché la tua radice è un po' anche la mia / e ti porto  
 al mondo come un' icona / perché voglio vederti fatta  
 santa al più presto.../ Eri donna eri madre, madre  
 amata / eri il fiore su una terra arida / una dolcezza  
 che portavi dentro / e che cresce grande dentro il mio  
 cuore: (pace sei / nata e pace sei diventata!) / una dol-  
 cezza che oggi è salvezza / perché dentro accende  
 la speranza.... / E oggi (nel cielo) vorrei accendere  
 una stella / per chiamarla 'Madre Teresa' !

**Nicola Alfano**

ka Shën Pali (Pz)

**Sënd Roku ndë gusht**

Tek gjithë ditat e vitit  
këto janë më të ndierturat.  
Gjindjat gëzonen nëpir katund  
pir atë festë që ata presen shumë.  
Janë ditë të bekuara  
që mbjedhen gjindë ka horet më t'harruara;  
gjindë që shihen një herë nd'vit  
e shihen ndër këto ditë.  
Kush ka Merka, kush ka Milana,  
si qaset Gushti,  
tek zëmra tire  
priret e çelet vundata.  
E Ai i pret  
vit pas vit, sembri te ai llok,  
biltë e tij që mbidhen me harë  
e kanë zëmren si një trim i ri.  
Ki është Shëjti inë i bekuar  
që ka prikulet e jetës neve na ruan,  
e që mbjedh rro-rrò ati  
kush e kirkon me zëmer e lipisi.

**Aedi**

ka Pllatni (Cs)

**Zëmër**

Zëmra ima, zëmra re,  
ti diç s'ke ni më harë;  
zëmra ima, zëmra vjetar,  
ti diç s'ke ni më fuqi;

Ti je imja e u jam tëndi  
po mos' m' bën ni më kta dhëmbaz,  
po eja bëjam njetar këmbaz  
se jeta ë a ligë e shumë a shtrëmbar.

*(Prof. Basile, ç' thrritat si poet Aedi, trùan ktët poezi "më t' mirit jatrua të zëmras, P. Grillo").*

**CUORE**

Cuore mio, nuovo cuore,  
tu non puoi mai più gioire;

**Zef Skirò di Modika**

ka Hora e Arbëreshëvet (Pa)

**O lule, lul'e bukur**

O lule, lule fushj'e bukur,  
me ar plot të veshi maji.  
O flutur, flutur mali, flutur,  
të dha era krahët e saj(i).

Ti e bardhë je si zborë,  
ëm se të jap një dorë.  
Të rritem prit, bukur djalë,  
u te fusha, ti mbi mal.

Kur të qaset dimr'i ftohtë,  
njësh do t'rrimë më ngrohtë.  
Le të rritem në më do mirë,  
se jam vajzë me çdo hir.

Të lyp dorën se je arbëreshe,  
një unazë mirr për nuse.  
Mirupafshim, djali jim,  
sot më dhe hare e gëzim.

Kur të fola, kur të fola, kur të fola,  
kur të fola e para herë,  
bure bé e më dhe fjalë:  
ishe lule në të dalë.

Për mesi, për mesi, dora dora,  
në të ngrysur u' të mora...  
Bie shi, po bie zborë,  
floqe floqe bie me erë  
e më duket her'e herë  
se më fale ti me dorë.

*(nga libri: Zef Schirò '38, Io l'altro (forse nessuno) poesie - U' tjetri (mbase mosnjeri) - Hora e Arbëreshëvet 2010, faqe 39).*

cuore mio, vecchio cuore  
tu non avrai mai più vigore;

Tu sei mio ed io tuo soltanto,  
non guardarmi con arroganza,  
ma lanciamoci in un'altra danza  
perché questo mondo non ha baldanza.

*(Il prof. Basile, alias Aedi, dedica questa poesia "al più bravo cardiointerventista d'Italia, il dott. P. Grillo")*

**Brikenë Ceraja**

nga Mitrovica

**U plak koha**

Majë gurit  
Gdhenda  
Kohën e lodhur

Ngjyrosa në të zezë  
E në të verdhë  
Para se ta rrihte  
Shiu i verës

Shpresë humbur  
U plak koha  
Nën hijen  
E merimangave

**Pagëzim**

Ati të pagëzon  
Me fjalë.

Me atë që do  
E pagëzon vetën.

Me fjalën e shenjtë  
Thur jetë

Të pafund.

**Kullë**

Shtatëdhjetë e shtatë gurë  
I vura mbi trupin tënd.

I gdhenda me heshtjen e dhimbjes  
Shtatëdhjetë e shtatë plagë

Për të ndërtuar një kullë  
Të qëndresës së dhimbjes  
E gëlltit helmin e heshtjes  
Të gurëzuar në gurë

(nga libri: **Brikenë Ceraja**, *Udhëtim me fjalën e vvarë*,  
Faik Konica, Prishtinë 2007.

**Me gjethet e qëndisura**

Do të vdes pranë gjirit tënd  
Dhe në ditën e varrimit  
Mos harroni  
Të mos më varrosni me arkivol

Më mbulonj me gjethet  
Po që se nuk i gjeni tek toka ime  
Filloni t'i kërkoni  
që nga (koha) antike  
mos i harroni as Pellazgët  
ndaluni pak tek Ilirët  
do të gjeni diçka  
mos harroni të shkoni  
në Dardani e as në Shqipëri  
mblidhni një nga një  
e nga duart e një kosovareje  
t'ma qëndisin një arkivol

Mos harroni

në secilën gjethë të shkruani  
nga një varg  
një epitaf

**Ik, o njeri**

Ik  
Nga dheu  
Thanë  
Para se të të  
Thuret vargu

Ik  
Nga koha  
Thanë  
Para se ta fundosësh këngën

Ik  
Nga vetvetja  
Thanë  
Para se s'të  
bihet koka



**SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE**

FAKULTETI I FILOLOGJISË I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Prishtinë, Rruga Nënë Tereza, pn. KOSOVË

Tel. +38138 222 970

E-mail: seminar.filologjik@uni-pr.edu; rrahman.pacarizi@uni-pr.edu

Drejtor: Prof. asoc. dr. Rahman Paçarizi  
Bashkëdrejtor: Prof. dr. Aljula Jubani  
Sekretar: Prof. asoc. dr. Qibrije Demiri-Frangu  
Bashkësekretar: Dr. Viola Isufaj  
Sekretarë profesionalë: Ma.Kadire Binaj dhe Ma.Alban Zeneli

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është themeluar në vitin 1974 pranë Fakultetit të Filologjisë (atëherë: Fakulteti Filozofik) të Universitetit të Prishtinës. Ky Seminar organizohet për studentë e studiues që merren me probleme të gjuhës, të letërsisë e të kulturës shqiptare, po edhe me albanologjinë përgjithësisht.

Seminari ka zhvilluar gjithsej tridhjetë e katër sesione. Në vitin 1991 është ndërprerë veprimtaria e tij nga organet e dhunshme serbe. Në vitet 1995 e 1996 sesionet e këtij Seminari u mbajtën në Tiranë në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Nga viti 2000 Seminari zhvillohet sërish në Prishtinë. Sesionet 19 dhe 20 (2000-2001) janë organizuar në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

**Seminari XXXV do t'i zhvillojë punimet në Prishtinë nga 15 – 26 gusht 2016**

Arritja e seminaristëve në Kosovë, më 14 gusht 2016 (e diel). Hapja solemne e Seminarit XXXV, më 15 gusht 2016, në orën 11:00.

**Programi bazë i Seminarit XXXV:**

1. Kurse intensive të mësimit të shqipes (tri shkallë);
2. Ligjërata të veçanta të gjuhësisë;
3. Ligjërata për letërsinë shqiptare;
4. Ligjërata për kulturën shqiptare;
5. Referime shkencore;
6. Ligjërata të përgjithshme;
7. Tryeza të rrumbullakëta;
8. Tryeza e doktorantëve;
9. Program kulturor plotësues për t'i njohur seminaristët me bukuritë natyrore, me veprimtaritë kulturore e të mira të tjera në qendra të Kosovës.

**SESSIONET SHKENCORE (25 – 26 gusht 2016)**

Temat bosht të Seminarit për sesionet shkencore janë:

- Gjuhësi: Varietetet e shqipes
- Letërsi: Koncepti i tjetrit në letërsinë shqipe
- Kulturologji: Media dhe kultura në epokën e internetit

Afati për dërgimin e titullit të kumtesës dhe të abstraktit të bashkëngjitur (deri në 300 fjalë) është deri më 15 maj 2016. Abstrakti është i domosdoshëm!

Adresa e e-mailit: seminar.filologjik@uni-pr.edu

**Këshilli Drejtues**

## Koha kërkon të flas arbërisht

**prof.ass.dr. Kledi Shegani**, Univ. i Tiranës  
**dr. Helena Grillo**, Univ. i Durrësit

*“Arbërishtja është Lëkura e arbëreshëve.....T’i thuash një arbëreshi se, për të xërë shqipen, ka të harronjë arbërishten, është si t’i shkullësh lëkurën; është si t’i lypësh të harronjë si ja thonë, të harronjë të jëmën e të jatin”.*<sup>1</sup>

Arbëreshët e Italisë janë një komunitet etno-gjuhësor, të cilët, prej më shumë se pesë shekujsh e gjysëm janë vendosur në krahinat e Kalabrisë, Siqelisë, Puljes, Basilikatës, Kampanie-s, Molizit, në rreth 50 vendbanime, duke ruajtur gjithë traditat, zakonet, këngët, folklorin, duke marrë me vete një copëz Shqipërie për ta patur gjithmonë e për t’u ndjerë mirë aty. Mërgimi i arbëreshëve drejt Italisë u zhvillua në disa valë, duke filluar në gjysmën e dytë të shekullit XV dhe në gjysmën e dytë të shekullit të XVII.

Çdo individ lind në gji të një kulture dhe formëson qënien sociale e kulturore në gji të kësaj kulture. Përdoruesit e të njëjtës gjuhë formësojnë bashkësinë gjuhësore, e cila në anën tjetër nuk mund të mendohet pa folësit, përdoruesit e gjuhës. Orioles thotë: “Shoqëria ndahet në grupe dhe gjuha, njëlloj si ajo, ndahet në dialekte, sociolekte, regiistra dhe varietete të tjera”. Një ndër varietetet e shqipes është Arbërishtja, e cila nuk i ka humbur fijet ushqyese të ndërsjellta me gjuhën standard shqipe. Tabloja e gjuhës shqipe ravijëzohet si model rrathësh ku gjuha standarde në qendër merr frymë me dy mushkëri njëkohësisht, toske e geqe, pa harruar degën tjetër ushqyese, variantin e diasporës arbëreshe. Gjithnjë e më tepër zhvillimet e sotme gjuhësore provojnë se larushia gjuhësore me kodet që ndërrohen e kapërthehen, me strukturat gjuhësore heterogjene që japin e marrin sipas ligjësisë vetjake, formësojnë folës, të cilët përdorin lirshëm mjete gjuhësore të çdo idioime që njohin dhe e kanë më të lehtë për ta zgjedhur.

Gjuha shqipe që flasin Arbëreshët e Italisë paraqitet si një formë më vete, që nuk është plotësisht e njëjtë me asnjë nga dialektet e shqipes. “Në të vërtetë po të vështrojmë elementet strukturore dhe fonetike themelore të ligjërimeve arbëreshe, rezulton se ato i përkasin toskërishtes jugore, duke u përputhur më fort me disa dukuri konservative të camërishtes dhe labërishtes, po edhe me gjuhën e autorëve të vjetër gegë; nga ana tjetër, ato ligjërime paraqesin dhe dukuri dhe tipare të reja, sidomos në fushën e leksikut, që përcaktohen dhe kushtëzohen nga takimi i ngushtë gjuhësor që kanë pasur me italishten qysh prej shek XV-XVI e këtej”.<sup>2</sup>

Të folmet e arbëreshëve të Italisë paraqesin një strukturë fonologjike dhe morfologjike e sintaksore, por edhe leksiko-frazeologjike të përbashkët me njëra-tjetrën, por edhe me atë të shqipes, prej së cilës kanë ardhur. Lamberci arriti të jepte fytyrën e së folmes arbëreshe, duke depërtuar në indin e saj social. Ai është i pari nga dialektologët që vëren përzjerjen e italishtes me arbërishten. Jo vetëm ngulimet arbëreshe, por edhe shumë emra familjesh italiane si: Gramshi, Albani, etj.. tregojnë për një prani historike të elementit shqiptar në Itali. Ky komunikim mes dy vendeve, me sa duket është një dukuri që daton herët. Dëshmitë që vijnë nga periudha të ndryshme të historisë tregojnë se urat e komunikimit midis dy vendeve nuk janë shkëputur asnjëherë, pavarësisht shkallës së intensitetit dhe formave të komunikimit.

Sipas Jakobsonit, “cilido folës i realizon përdorimet vetjake gjuhësore, por m’anë tjetër s’ka si të mos shohë shumëllojshmërinë e përdorimeve gjuhësore brenda shtratit standard”. Duke e parë si sistem më vete Arbërishten, mbështesim pikëpamjen e A. Giordanos, i cili është i hapur ndaj lëvizjeve sistemore kur pohon: “Ndë të folmat arbëreshe gjëmi adhe, këtu këtje, gjallëri leksikore e thjellsli gramatikore. Prandaj arbëreshi nëse do, mund të shkruanj arbërisht, e mirë. Po ka të verë mbatanë kufinjvet lokalë e të marrë hua nga të tjerë katunde arbëreshë ato fjalë e ato forma gramatikore që te katundi i tij u buartin ose u shtrëmbëruan. E, ndëse gjë fjalë Arbërishtja s’i ka, ka t’i marrë, me urtësi, ka gjuha motër shqipe”.<sup>3</sup>

Ernest Koliqi në një konferencë të mbajtur në Kozencë më 20 shtator të vitit 1964, në kongresin e Dante Aligierit, “Shqiptarët në Kalabri”, theksonte: “Edhe endacakut me përvojë, rrallë i ndodh të hasë në rrugën

*e tij, ashtu si në tokën kalabreze, plot mrekulli të panjohura, kostume me një përzjerje harmonike të ngjyrave kaq mbresëlënëse. Në ato pasqyrohen njëkohësisht ngjyrat e ndezura dhe të venitura të detit me qiellin mesdhetar dhe magjia e lulëzimit pranveror nëpër kodra e male që mbulojnë rrënojat e qytetërimeve të lashta dhe rezonanca muzikale e emrit ruan shijet e forta klasike. Horizontet solemne që na japin ndjenjën e pafundësisë, që zhduken përtej imazheve madhështore të maleve duken të mbështjellë në një atmosferë vetmie primitive ku koha dhe hapësira vërejnë ndryshimin e kushteve njerëzore, të cilat ruajnë të paprekur urtësinë e eksperiencave shekullore... Mes peisazheve dhe njerëzve trima dhe të hareshëm bien në sy kostumet me ngjyra ekzotike të kulturës dhe zakoneve të shqiptarëve në Itali dhe të ceremonive spektakolare fetare me rit bizantin”<sup>4</sup>.*

Studimet e studiuesve të tjerë si: Sh.Demirajt, M.Camaj, F.Solano, apo F.Altimarit, apo edhe të E. Çabejt, i cili theksonte se shqipja që flitet në bashkësitë arbëreshe të Italisë paraqet një formë të toskërishtes, por gjithashtu nënvizonte se: *“me barazimin arbërisht-toskërisht nuk shpjegohet gjithcka në këtë problematikë. Çështja është disi më komplekse nga ç’mund të duket në vështrimin e parë. Aty ka vend për diferencime nga më se një pikëpamje”<sup>5</sup>*. Në këtë vijueshmëri mendojmë se ka ardhur koha për njehsim, në emër të njohjes së laryshisë. A. Giordano pohon se *“Arbërishtja standarde<sup>6</sup> kish t’ishë ëndrra e çdo shkrimtari arbëresh, arritja e çdo studiuesi arbëresh”*.

De Rada ka shkruar edhe një seri artikujsh mbi gjuhën shqipe dhe gramatikën e saj, lashtësinë apo alfabetin e shqipes. *“De Rada është i pari dijetar arbëresh që u përpoq të bëjë një shtresëzim të huazimeve në gjuhën shqipe. Në rradhë të parë, ai ka parë fondin autokton të leksikut tonë. Ndër huazimet ka saktësuar ato që kanë ardhur prej gjuhës greke, latine, neolatine dhe sllave. Autori pranon ndikimin e greqishtes, por në të njëjtën kohë, pranon edhe rolin dhënë të shqipes mbi gjuhën greke. Ka shprehur ndonjë mendim mbi elementet slave në gjuhën shqipe. Ka nënvizuar edhe motërzime (variante) dialektore të arbërishtes”<sup>7</sup>*. Madje, De Rada mendonte se me veprat e tij do të bëhej themeluesi i gjuhës letrare të njehsuar kombëtare shqipe dhe sipas tij e folmja arbëreshe duhet të ishte e folme e të gjithë shqiptarëve.

Një kontribut të jashtëzakonshëm në njohjen e studimit e botës arbëreshë ka dhënë “Jeta Arbëreshe”, e cila ka pëmirësuar gjatë viteve si hartën e gjeografinë e botimeve dhe vecoritë strukturore të elementeve që trajtohen.

### **Klasifikimi i rubrikave të përmbajtjes në:**

Korrispondenca nga Katundet arbëreshë e ish- arbëreshë / Tekste popullore nga katundet arbëreshë / Poezi arbëreshe / Poezi shqipe / Studime - recensione mbi botën arbëreshe / Studime - recensione mbi botën shqiptare, dhe herë herë dhe Arbërishtja o shqipja, janë pasqyra më e mirë e njohjes së arbërishtes, lëvrimit të saj brenda bashkësisë gjuhësore që e përdorin dhe shpesh gërshetimin për njohje krahasimtare me shqipen e dialektet e saj. Kjo revistë, krahas shkrimeve të tjera përpiqet të mbush boshllëkun e studimit të gjuhës dhe letërsisë arbëreshe si mbeten e vetmja hallkë lidhëse e pashkëputur ndërmjet botës shqiptare dhe Perëndimit që nga 1501, vit kur Ulqini ra në duart e osmanëve, e deri në fillim të shekullit XX, me përpjekjet për rizgjim kombëtar shqiptar gjatë Rilindjes.

*“Gjuha e bukës”* dhe *“gjuha e zemrës”*. Ky binom duket se ka shoqëruar jetën e arbëreshëve në Itali dhe ka krijuar një klimë të përshtatshme për bashkëjetesë të shkëlqyer në të gjitha fushat.

Një studim të plotë për vendin e këtyre të folmeve e ka bërë prof.Shkurtaj<sup>8</sup>, i cili vazhdimisht ka sjellë, përpunuar dhe pasuruar harta të së folmeve arbëreshe dhe të kontributit të shumë studiuesve lidhur me këto të folme.

Ka ardhur koha që letërsia arbëreshe në traditën letrare të shkruhet e lexohet në Arbërisht, pa “përkthime” në standard.

**Shenime:** 1) A. Giordano, Jeta Arbëreshe, nr. 44, Itali, 2006; 2) Gj.Shkurtaj, Ligjërimet arbëreshe,, Julvin, 2006, f.17; 3) Jeta Arbëreshe, Nr.49, Itali, 2006; 4) E. Koliqi, Esse të letërsisë shqiptare, Leo S. Oloschki, 1972, f.76; 5) Cabej, E, Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë, në “Bota arbëreshe”, Tiranë, 1987, f.61; 6) Jeta Arbëreshe, Nr.49, Itali, 2006; 7) Po aty, f.588; 8) Shkurtaj, Gj. Vendi i të folmeve arbëreshe të Italisë në izoglosat e ADGJSH-se, Studime Albanologjike I, Tiranë, 1997 f.104-112.

## Gjuha Arbëreshe, e thertur ka bilt e saj

Drejtori

Arbërishtja, kjo e nëmur! E dashur lik ka shumë Arbëreshë, sikur t'ish gjuhë e mallkuar!

Është kush thot se 'Arbërishtja s'është'. E u pyhem: Po pse 48 të Folme Arbëreshe të njëi "nëndialekti tosk" të gjuhës shqipe, - çë folen/fjiten ndë Talljet, llargu ka Mëmëdheu, ka më se pesë shekul e gjymës - s'mund të kenë të drejtën e nderën të thërriten "Gjuhë Arbëreshe"? Letërsia Arbëreshe – pëlqeftë o jo - u shkrua me këto 48 të Folme Arbëreshe!

Është kush thot se 'Arbërishtja është po të vdesë'. E ndiejën si një problem t'e mbajën të gjallë këtë gjuhë! Po Arbërishtja s'do ndihur ka këta bil të paturpë: mbahet shtuara vet, për të rronjë. Kush do, e folën e e shkruan; kush s'do, s'e folën e s'e shkruan. Pikë.

Është kush thot se 'Arbërishtja vdiq'. Nëng shohën herën t'i hapjën varrin, parë motit, kësaj gjuhje çë qe miâl për prindët e tyre. E gjallë edhe sot, e ëmbël më se dje!

Është kush i 'vë nëmë Arbërishtes'. E kush mallkon prindët ç'ja mbësuan. Këtë gjuhë e mbajën si 'palë e nëmur'. Bëjën sa mundjën për t'mos t'e foljën, o t'e foljën lik. E i vënë afër aq fjalë lëtire, sa ajo murgë, hereherë, ndihet e mbytur ka këto gjitëne çë i hijën ndë shpitë 'saj pa qënë mbitartura / ftuara!

Është kush thot se 's'i pëlqen Arbërishtja'. S'e dinë se dica filologë arbëreshë e thërrit'tin "gjuhë me k'foli Inzot"? Mos i kemi turpë edhe t'Inzoti? Çë gjuhët i stolisi gjithë me bukurë e nderë të rralla?

Është kush thot se 'Arbërishten s'di t'e folënj'. Më turpja! E numëroi sa herë i lipi s'jëmës bukë e djathë, te kjo gjuhë? Për t'hanej e t'pinej, dij t'e folnij. Për t'e nderonjë me fjalën, thot se s'di? Sa bën 'gryka pjotë'!

Është kush thot se 'Arbërishten s'di t'e shkruanj'. Kuj s'i pëlqen gjuha e s'jëmës, ku e gjën arëksin të xërë si shkruhet? Kush nëng xë t'e shkruanj Arbërishten, s'do se ka të rritet. Bilt kanë rriten, po gjuha tyre s'ka të rritet. E kështu, kur bilt e rritur adunaren se gjuha tyre qëndroi djaloshe në djepë, kuptojën se i dhanë më të ngrënë maçes e qenit t'shpisë se sa gjuhës tyre!

Është kush 'Arbërishten s'ja mbëson t'bilvet' sepse e mban si një gjuhë 'private', një kodik i fshehtë me k'mund të folënj pa qënë kuptuar ka shoqe e bil. Më turpja! Prindët ja lanë si 'palë hùà', për me ja trashëguar nipravet; po biltë e mbajën për vetëhenë, si 'pronë private'!

Popo, sa Arbëreshë dojin shtypur kryet te murtalli!

## Eparkia e Arbëreshëvet e Ungrës është po t'bënjë një Qind vjet

### protopresbitero Pietro Lanza

Vikari i Eparkisë, ka Ferma (Cs)

#### L'EPARCHIA ITALO-ALBANESE DI LUNGRO VERSO IL I° CENTENARIO -

Era il 13 febbraio 1919 quando il venerabile Papa Benedetto XV, con la Costituzione Apostolica "Catholici fideles", istituiva l'Eparchia di Lungro degli Italo-Albanesi dell'Italia Continentale per "i fedeli cattolici di rito greco, che abitavano l'Epiro e l'Albania, fuggiti a più riprese dalla dominazione dei turchi, ... accolti con generosa liberalità ... nelle terre della Calabria e della Sicilia, conservando, come del resto era giusto, i costumi e le tradizioni del popolo greco, in modo particolare i riti della loro Chiesa, insieme a tutte le leggi e consuetudini che essi avevano ricevute dai loro padri ed avevano con somma cura ed amore conservate per lungo corso di secoli. Questo modo di vivere dei profughi albanesi fu ben volentieri approvato e permesso dall'autorità pontificia, di modo che essi, al di là del proprio ciel, quasi ritrovarono la loro patria in suolo italiano [...]".

La Santa Sede rispondeva così, con paterna benevolenza, alle pressanti richieste di tutela avanzate per lungo tempo dai discendenti del condottiero albanese Giorgio Castriota Skanderbeg, a suo tempo insignito del titolo di "Atleta di Cristo", per l'impegno profuso coi suoi valorosi soldati, per un quarto di secolo, in difesa della libertà e dell'autodeterminazione del proprio popolo e della cristianità europea.

L'esodo degli albanesi in Italia risale ai secoli XV-XVIII, dopo il Concilio di Firenze del 1439, la caduta di Costantinopoli del 1453 e la morte di Skanderbeg nel 1468.

In quel tempo si spostò una Nazione intera, una Chiesa, il cristianesimo albanese, la lingua albanese, un popolo intero con il suo patrimonio.

I profughi dovettero dolorosamente abbandonare la Madre Patria, per poter rimanere in vita, liberi e cristiani; nell'esodo portarono con loro poche cose, le meno pesanti, le più preziose, quelle incancellabili: i ricordi, la lingua, il rito bizantino; mentre nel suolo patrio lasciarono dolore, vuoto e

Ish dita 13 fjavar 1919, kur i nderuari Papë Benedhiti XV, me Kushtetutën Apostollike 'Catholici Fideles' krijonij Eparkinë e Ungrës të Arbëreshëvet të Talljes Kontinentale për "bestarët katolikë të ritit grek, që rrojin në Epir e në Arbëri, të pështuar valë-valë nga zotërimi i Turqvet, ... të mbledhur me bulari zëmërgjerë...ndër dherat e Kallàbrjes e të Siçilljes, ture mbajtur, si ish për me bënë, zakonet e traditat e popullit grek, sa e më shumë ritet e Qishës së tyre, bashkë me gjithë lexhat e zakonet që ata kishin trashguar ka Étërit e tyre dhe me më të madhin kujdes e mall kishin ruajtur për shumë shekul. Kjo mënyrë së rruari të të mërguarvet arbëreshë qe me pjot gëzim e aprovuar dhe e lejuar ka Papa, ashtu që ata, mbatanë qiellit të tyre, sikur të kishin ri-gjetur Atdhenë e tyre në territor italian [...]".

Selia e Shënjtë përgjegjej kështu, me mirëdashje atërore, kërkesavet urgjente për mbrojtje, të parashtruara për shumë mot ka pasardhësit e kreit shqiptar Gjergj Kastriotit Skanderbé, asimoti të dekoruar me titullin 'Atlet i Krishtit', për zellin e derdhur me ushtarët e tij të bushtër, për njëzetepesë vjet, për të mbrojtur lirinë e vetëvendosjen e popullit të tij dhe të krishtërimit europjan.

T'ardhurit e Arbëreshëvet ndë Talljet ndodhi ndër shekk.XV-XVIII, pas Konkilit të Firenze-s (1439), pas rënies së Kostantinopollit (1453) e pas vdekjes së Skanderbekut (1468).

Nd'atë mot ndërroi vend një Komb i tërë, një Qishë, Krishtërimi arbëresh, gjuha arbëreshe: një popull i tërë me trashëgiminë e tij.

Mërgimtarët pat ' lëjin me hjidhi Mëmëdheun, për të qëndrojin të gjallë, të lirë e të krishterë; tue ikur, muartin me ta pak shërbise, ato që mbëshojin më pak, më të shtrëjtat, ato që s'mund të harrohen: kujtimet, gjuhën, ritin bixantin; ndërsa te vendi atëror lanë helm, mbrasti e shkreti. Ata qenë të mbledhur me mirëdashje gjithapàru, si vëllezër të së njëtes Besë të krishterë. Papët e Romës qenë ngaherë të kujdesshëm, si ètër, ndaj tyre, se të kishin kushte rùajtjeje të trashëgimisë së tyre



desolazione. Essi furono benevolmente accolti ovunque, come fratelli nella medesima fede cristiana. I Pontefici romani furono sempre paternamente provvidenti nei loro riguardi perché potessero avere condizioni di salvaguardia del proprio patrimonio ecclesiale orientale.

L'istituzione dell'Eparchia di Lungro è il coronamento di un lungo percorso storico nel quale la Divina Provvidenza ha costantemente protetto questo piccolo popolo orientale integratosi pienamente nel tessuto della Chiesa latina, senza però perdere le proprie caratteristiche identitarie e peculiari. La Santa Sede con tale provvedimento riconosceva giuridicamente e per prima in assoluto la realtà unitaria e particolare degli Italo-Albanesi e donava ad essi una configurazione di diritto ecclesiale e civile.

In questo 2016 l'Eparchia di Lungro ha iniziato il suo 98° anno di vita e avanza spedita per il I centenario. Nella sua storia registra quattro Vescovi dei quali il primo è stato Mons. Giovanni Mele, da Acquafamosa/Cs, eletto all'età di appena 33 anni. Egli ha governato per 60 anni, dal 1919 al 1979 e si è eroicamente impegnato nell'ardua impresa di dare unitarietà alle Parrocchie della novella Eparchia che, precedentemente, appartenevano a ben 6 diverse Diocesi: Cassano Allo Jonio, Rossano, Bisignano, Anglona, Penne, Lecce, ubicate in 4 differenti regioni: Calabria, Basilicata, Abruzzo, Puglia.

Il suo successore Mons. Giovanni Stamati ha proceduto con eguale zelo apostolico per il recupero della spiritualità bizantina e per una uniforme fisionomia ecclesiale nel segno della continuità, della custodia e della valorizzazione dell'avito patrimonio spirituale e storico-culturale. Egli, a ridosso del Concilio Vaticano II, nel 1968, ha decretato l'uso liturgico della lingua albanese, materna e del popolo, come forte segno di unità diocesana nonché di appartenenza e di vicinanza ad un popolo al quale, nella propria terra, era negata la libertà di poter pregare Dio. Nei paesi dell'Eparchia si pregava nell'antica e nobile lingua materna in attesa dell'alba di una rinascita della fede cristiana nella Madre Patria degli Avi.

Il terzo Vescovo, Mons. Ercole Lupinacci, da S.Giorgio Albanese/Cs, dal 1987 al 2010, ha provveduto ad elevare alla confacente dignità il patrimonio liturgico ed iconografico delle Chiese

qishtarë orientale.

Krijimi i Eparkisë së Ungërës është kurorëzimi i një udhëtimit të gjatë historik, gjatë të cilit Perëndia, pa i lënë fare ngëmshtin, ruajti këtë popull të vogël oriental, që u integrua plotësisht te struktura e Qishës lëtire, po pa bjerrë karakteristikat e identitetit të vetë. Selia e Shëjtë, me këtë masë njih juridikisht, dhe më parë se gjithë, realitetin njësor dhe të veçantë të Arbëreshëve të Talljes dhe i jip atyre një formë drejtësisje qishtarë e civile.

Te ky vit 2016 Eparkia e Ungërës zu vitin nëndëdhjetetë (98°) jetje dhe vete përpara, e shkathët, drejt të parit Qindvjetor. Tek historia e saj regjistron katër Peshkopra, i pari i të cilëve qe imzot Giovanni Mele, ka Firmoza/Cs, i emruar kur kish sapo tridhjetetë (33) vjet: ai qeverisi për 60 vjet (1919-1979), e u angazhua trimërisht për t'i jipë një bashkëri Famullivet të Eparkisë së re, që, më parë, vejin me gjashtë (6) ndryshe Dioqeza: Cassano allo Jonio, Rossano, Bisignano, Anglona, Penne, që gjëndshin te katër (4) ndryshe krahina: Kalabri, Basilikatë, Abruc, Pulje.

Pasardhësi i tij, imzot Giovanni Stamati, ka Pllatani/Cs, vate përpara me të njëjtin zell apostolik, për rimarrjen e frymës shpirtërore bixantine dhe për një fisionomi qishtarë të njëjtë, në shëngjin e vijimit, të ruajtjes e të vlerësimit të trashgimisë së lashtë shpirtërore dhe historiko-kulturore. Ai, mbjatu pas Koncilit Vatikan II, te viti 1968, dekretoi përdorimin liturgjik të gjuhës arbëreshe, mëmësore e populllore, si shëngj i fortë njësisje eparkiale, si edhe anësisje dhe afërsisje njëi populli, të cilit, te atdheu i tyre, ish e mohuar liria të mund të luftin Perëndinë. Te katundet e Eparkisë parkalesëj, kështu, tek e vjetra dhe bulare gjuhë mëmësore, tue pritur agimin e një rilindjeje të besës së krishterë te Mëmëdheu i Tatëlshëvev. I trejti peshkop, imzot Ercole Lupinacci, ka Mbuzati/Cs, ç'ka viti 1987 njera ndër 2010, bëri çmos sa të ngrënj te një hjë e duhur trashgiminë liturgjike dhe ikonografike të Qishavet famullitare, ture i sjellur te një formë më të përputhur me traditën bixantine. Gjatë peshkopatit të tij qe e mbajtur e para Mbledhje Eparkiale, ka e cila duall një seri të dhënash për një jetë të mirë



parrocchiali portandole ad una configurazione più aderente alla tradizione bizantina. Nel corso del suo ministero è stata celebrata la Prima Assemblea Diocesana dalla quale è venuto fuori un compendio di indicazioni per una buona vita ecclesiale, comunitaria e individuale, in linea con il patrimonio spirituale orientale.

L'attuale Vescovo, Mons. Donato Oliverio, da Lungro/Cs, ha ereditato una bella Diocesi, saldamente piantata in Occidente dove rende visibile con estrema chiarezza le ricchezze della tradizione bizantina e la bellezza della possibile unità tra i cristiani di occidente e di oriente, nella differenza delle tradizioni e nella diversità delle lingue.

Egli governa l'Eparchia da Lungro, una ridente cittadina di circa 3.000 abitanti, posta sul versante sud-ovest della Catena montuosa del Pollino, ai piedi del Monte Petrosa, ad un'altitudine di 600 metri sul livello del mare. Il suo Trono si trova in quella che è la Chiesa Madre di tutte le Chiese dell'Eparchia, la Cattedrale di San Nicola di Mira, costruita tra il 1721 e il 1825. Maestosa nella sua pianta romanico-barocca a croce latina, è stata impreziosita negli ultimi decenni da pregevoli mosaici e affreschi, che la rendono un luogo unico in cui arte bizantina e spiritualità orientale si coniugano felicemente, tanto da portarla ad essere considerata la Chiesa più importante del cattolicesimo bizantino arbëresh in Italia. Nella sua cupola domina il maestoso Cristo Pantocrator "volto della misericordia del Padre".

Oggi i fedeli dell'Eparchia sono circa 40.000 nei Paesi e altrettanti sparsi in varie città della Penisola italiana; ad assisterli nel loro cammino di divinizzazione ci sono una cinquantina di papàdes. Essi sono costituiti in 30 Parrocchie italo-albanesi di rito bizantino che sono ubicate in paesi sparsi, a macchia di leopardo, sul territorio di quattro Diocesi della Calabria: Cassano Ionio, San Marco Argentano, Rossano-Cariati e Cosenza-Bisignano e altre tre Diocesi al di fuori della regione, Tursi-Lagonegro, Lecce, Pescara-Penne. In questi centri gli abitanti, per strada e in famiglia, parlano l'arbëresh e nelle Chiese, durante le ufficiature liturgiche, i fedeli pregano e cantano in greco e in albanese.

Nell'Eparchia si vive e osserva, con pienezza di comunione ecclesiale con la Sede di Pietro, la

qishtare, bashkësore e individuale, në drejtim me pasurinë shpirtërore orientale.

Peshkopi i sotshëm, imzot Donato Oliverio, ka Ungra/Cs, pat në trashëgim një Eparki të bukur, fort e rënjosur në Perëndim, ku po buthton me qartësi të madhe bëgatëritë e traditës bixantine dhe bukurinë e njësisë së mundshme ndë mes të krishterëvet të perëndimit e të lindjes, edhe me tradita e gjuhë ndryshe.

Ai drejton Eparkinë nga Ungra, një e këndshme horëz me afro 3000 njerëz, e vëtur ka ana jug-perëndimore e vargmalit të Pulinit, te këmbët e malit Petrosa (Gurishte), 600 metra mbi detin. Throni i tij gjëndet tek ajo ç'është Qisha-mëmë e gjithë Qishavet të Eparkisë, Katedralja e Shën Kollit të Mirës, e stisur ndë mes t'vitravet 1721-1825. Madhështore në planin e saj romano-barok me kryqe lëtire, qe e zbukuruar ndër dhjetëvjeçarët e prasëm, me mozaikë me vlerë e me afreske, çë e bëjën të pashoqë, ku art bixantin e frymë shpirtërore orientale bashkohen bukur, aq sa të jetë e mbajtur si Qisha më e rëndësishme e Katolicizmit bixantin arbëresh ndë Talljet. Ka kupola e saj zotëron, madhështor, Krishti Pantokrator, 'faqe e lipisë së Atit'.

Sot bestarët e Eparkisë janë qasur 40.000 ndër katundet, e njetër aq të shprishur te ndryshe hora të Talljes; për t'i ndihjën tek udhëtimi i tyre drejt Zotit janë afro pesëdhjetë priftra. Këta rrojën ndë 30 Famulli arbëreshe të rritit bixantin: të shprishura, këtù këtje ndë territoret e katër Dioqezave lëtire të Kallàbrjes (Cassano Jonio, S.Marco Argentano, Rossano-Cariati e Cosenza-Bisignano) dhe tre Dioqezave jashtë Kallàbrjes (Tursi-Lagonegro, Lecce, Pescara-Penne). Ndër këta katunde, mb'udhë e ndë fëmilet, flasën arbërisht; e te Qishat, gjatë Shërbesavet Liturgjike, bestarët parkalesjën e këndojën grek e arbërisht.

Në Eparki rrohet e mbahet, me plotësi bashkësiqe qishtare me Selinë e Shëjtë, tradita bixantine me të shtrënjten pasuri liturgjike, cerimoniale, ikonografike, teologjike, shpirtërore, melurgjike. Këto karakteristika e bëjën këtë Eparki, ndë Kallàbrjet e ndë Talljet, shëngj i gjallë i jetës së vërtetë të të parëvet shekul të erës së krishterë, kur

tradizione bizantina con il suo ricco patrimonio liturgico, cerimoniale, iconografico, teologico, spirituale, melurgico. Tali caratteristiche rendono la medesima, in Calabria e in Italia, segno vivente della realtà dei primi secoli dell'era cristiana, quando greci e latini vivevano in comunione e lodavano ciascuno nella propria lingua e secondo le proprie tradizioni l'unico e solo Dio.

Il programma pastorale del Vescovo Donato lo si può intravedere già nei primi passi del suo episcopato. Egli, appena insediato, ha guidato un pellegrinaggio di fedeli alla tomba dell'Apostolo Pietro, per elevare ringraziamento a Dio per la tanta benevolenza elargita agli arbëresh nel corso della loro permanenza in Italia e per ribadire la piena fedeltà degli Italo-Albanesi alla Chiesa Cattolica e al Papa di Roma. Nel suo secondo anno di episcopato, con una delegazione del suo presbiterio, è stato ricevuto ufficialmente dal Patriarca Bartolomeo a Costantinopoli al quale ha confermato che gli Italo-Albanesi mantengono viva la fede cristiana nella tradizione bizantina ricevuta dai padri. L'anno successivo si è recato in Albania a baciare la terra degli Antenati e ad incontrare i Vescovi albanesi, Cattolici e Ortodossi, nonché i responsabili delle comunità musulmane e bektashane, simboli viventi della rinascita della luce in quella terra di martirio e segnali di speranza per il mondo intero per le loro scelte di dialogo e di passi di pace.

Il Vescovo Donato vuole guidare l'Eparchia di Lungro con i suoi fedeli italo-albanesi – di tradizione bizantina vissuta in piena comunione in un territorio di tradizione latina – a spendersi per l'unità dei cristiani per esprimere profeticamente il futuro prossimo della Chiesa: l'unità nella retta fede e nella abbondante ricchezza delle differenze ecclesiali.

In tal senso ha avuto grande incoraggiamento da alcuni eminenti rappresentanti della Chiesa Ortodossa che, con la benedizione del Patriarca Bartolomeo di Costantinopoli, hanno visitato negli ultimi anni alcuni paesi dell'Eparchia di Lungro. Nell'ottobre del 2013 Stephanos Charalambides, Metropolita di Tallin e di tutta l'Estonia, e Athenagoras Peckstadt, che giunse come Vescovo di Sinope e ripartì da Lungro con la comunicazione della elevazione a Metropolita del Belgio; e nel

grekra e lëtinj rrojin bashkë e lavdërojin, nganjë të gjuha e tyre e sipas traditavet të tyre, të njëshmin e të vetmin Perëndi.

Programi baritor i peshkopit Donat mund të shihet tash tek të parët hapa të peshkopatit të tij. Ai, sanënga u vendësua, bëri një pellegrinaxh bestarësh te varri i apostullit Pjetër, se të falënderonij Perëndinë për lipisinë e madhe që patë për Arbëreshët gjatë ndënj'jes së tyre ndë Talljet dhe për të singonij besën e plotë të Arbëreshëve drej Qishës Katolike dhe Papës të Romës. Tek i dijt vit i peshkopatit të tij, me një delegacionë priftrash, qe pritur zyrtarisht, në Kostantinòpull, ka patriarku Bartolomé, kuj i vërtetoi se Arbëreshët mbajën të gjallë besën e krishterë te tradita bixantine që trashguan ka prindt. Vitin pas, vate ndë Shqipëri, ku puthi botën e Atlashvet e u përpoq me Peshkoprat Shqiptarë, Katolikë e Orthodoxë, si edhe me kërret e bashkësivet myslimane e bektashane, simbole të gjallë të rilindjes së dritës nd'atë Dhë të martirizuar dhe shëngje shpresje për tërë Botën, për zgjedhjet e tyre dialogu dhe hapash paqje.

Peshkopi Donat do të drejtonjë Eparkinë e Ungrës me bestarët e saj arbëreshë – me traditë bixantine të jetuar në bashkëri të plotë te një territor me traditë lëtire – ture u spenduar për bashkimin e të Krishterëve, se të buthtonjë profetikisht të ardhmen e afërme të Qishës: bashkimin te besa e drejtë dhe te bëgatëria e gjerë të ndryshimevet qishtarë.

Ndë këtë drejtim patë një shtyjtje te madhe nga dica krera të lertë të Qishës Ortodhokse që, me bekimin e Patriarkut Bartolomé të Kostantinòpollit, vizituan, vitet e fundit, ca katunde të Eparkisë së Ungrës. Ndë shënmitër 2013, Stephanos Charalambides, metropolit i Tallin-it e të gjithë Estonisë, e Athenagoras Peckstadt, që errë si peshkop i Sinopit dhe u nis ka Ungra me njoftimin se kish qënë ëmruar metropolit i Bellxhit; e, ndë shënmartir 2015, Elpidophoros Lambriniadis, Metropolit i Bursës, Abat i monastirit Patriarkal e Stavropigiak "Trini e Shëjtë" të Chalki-s.

Këta vunë në dukje se zbuluan, ndër Arbëreshët e Eparkisë së Ungrës, vëllezër që s'njihjin fare, që

novembre del 2015, Elpidophoros Lambriniadis, Metropolita di Bursa, Abate del Monastero Patriarcale e Stavropigiaco “Santa Trinità” di Chalki.

Essi hanno rilevato di aver scoperto, tra gli italo-albanesi dell’Eparchia di Lungro, dei fratelli dei quali ignoravano l’esistenza, pienamente appartenenti alla Chiesa Cattolica ma altrettanto pienamente fedeli alla tradizione bizantina dei Padri. E i medesimi hanno incoraggiato a far diventare i paesi dell’Eparchia palestine di incontro per scambi fraterni tra cristiani ortodossi e cristiani cattolici, con piccoli passi di avvicinamento amichevole, per favorire la conoscenza reciproca, per gioire delle ricchezze altrui nel modo di lodare Dio, per sanare i passi di allontanamento del passato e per sveltire a cuor di popolo la riunificazione delle Chiese cristiane al fine di giungere alla sospirata e necessaria unità visibile dei credenti in Cristo, Figlio di Dio, Signore e Salvatore, che ha chiesto al Padre: “Che siano uno”.

Nel cuore e nella mente del Vescovo Donato, del clero e dei fedeli italo-albanesi dell’Eparchia di Lungro, queste parole forti si sono congiunte a quanto è inciso chiaro e tondo nello stemma dell’Eparchia: “INA ΩΣΙΝ ΕΝ” – “QË TË JENË NJË” – “UT UNUM SINT”, che costituisce la missione specifica della piccola Chiesa Italo-Albanese inviata, con le sue povere forze, per rendere presente il passato e profetizzare la volontà di Dio, e che pare essere l’obiettivo perseguito con tutte le forze da Papa Francesco: unità, a qualsiasi costo!

Il popolo arbëresh e la sua Chiesa ricordano con grande commozione e stupore altre parole simili rivolte loro il 25 aprile 1968 dal Beato Papa Paolo VI, in occasione del V° Centenario della morte di Skanderbeg, il quale rivolgendosi loro ebbe a dire: “Carissimi figli d’Albania ... voi potete considerare questa Sede Apostolica ... come vostra casa paterna ... e se la storia vi ha visti oppressi e dispersi, la bontà di Dio ha fatto sì che voi, con tutti i membri del vostro “gjak i shprishur”, vi rendeste ovunque tramite di alleanze e collaborazioni, che spesso vi hanno reso anticipatori del moderno ecumenismo”.

(Protopresbitero **Pietro Lanza**  
Protosincello dell’Eparchia di Lungro)

bëjën pjesë plotësisht të Qishës Katolike, po ashtu edhe plotësisht të lidhur me besë traditës bixantine të Ëtërvet.

E ata vetë shtyjtin sa katundet e Eparkisë të bëhen shkolla përpjekje për marrëdhënie vëllazërore ndë mes t’krishterëve ortodoksë dhe t’krishterëve katolikë, me hapa të vigjël qàsjeje miqësore, për të ndihur njohjen e njeri-jetrit, për të gëzuar të bëgativet të tjerëvet tek të lavdëruarit e Perëndisë; për të shëruar hapat llargimi të së shkuarës e për të shkurtuar motet e ri-bashkimit të Qishavet të Krishtera; ashtu çë t’errëhet tek e shërtuara dhe e duhura njësi e dukshme të besimtarëvet mbë Krishtin, të Birin e Perëndisë, Zotin e Shpëtimtarin, çë i lypit Atit: “Të jenë një!”.

Te zëmra e te mendja e Peshkopit Donat, të klerit e të bestarëvet arbëreshë të Eparkisë së Ungërës, këto fjalë të forta u bashkuan gjithnjë me atë ç’është shkruar, hapët e qartë, tek stema e Eparkisë: “INA ΩΣΙΝ ΕΝ” – “QË TË JENË NJË” – “UT UNUM SINT”, çë përbën misionin e veçantë të së voglës Qishë Arbëreshe, e dërguar, me fuqitë e saj të varfëra, se e djeshmja të priret e sotme dhe të profetizohet vëllima e Perëndisë; ç’është edhe, si duket, objektivi i kërkuar me gjithë fuqitë ka Papa Frangjisku: njësi, me çdo kusht! Populli arbëresh dhe Qisha e tij kujtojnë, me shumë mall e çudì, të tjera fjalë si këto, çë i drejtoi atyre, ndë 25 prill 1968, i lumturi Papë Pali VI, me rastin e Pesëqindëvjetorit të vdekjes së Skanderbekut: “*Shumë të ndershëm bil të Shqipërisë, ju mund të mbani këtë Selë Apostolike si shpia juaj atërore, dhe ndëse historia ju pa të shtypur e të shprishur, mirësia e Perëndisë bëri çë ju, me gjithë ‘gjakun tuaj të shprishur’, të ishit gjithëparu prematjotë besëlidhësh e bashkëpunimesh, çë shumë herë, e parë motit, ju bënë punëtorë të ekumenizmit modern*”.

( pruar arbërisht Drejtori )

Tek i pari përvjetor i vdekjes

## Vet dy fjalë, për zotin lalë

Drejtori, i nipi

Nd'ëmrit të fëmilës Giordano, falënderonj të nderuarin Peshkop, që dish t'ish këtu me ne sonde te ky i pari përvjetor i vdekjes së zotit lalë, protopapasit Emanuele Giordano.

Më ngit të mos folja. Sepse foljen vet këto dy pllaka marmuri, që Bashkia e Frasnitës i dhuroi kujtimit të tij. Falënderonj, poka, Bashkinë - me Sindkun Catapano e Viçesindkun Gaetani ndë krye - që dish t'i jipjen këtë nderë këtij prifti, të butë e t'urtë. Ja dhanë parë motit, sepse ai s'ish njari që mund t'pritë motin.

Po nderen, sonde, Bashkia ja bën edhe Fëmiles së tij, Fëmiles të vllaut Kuerin, ç'e dish mirë, e mirë që dashur. E nj'ëmer, mbi gjithë, dua këtu t'bënj, që për zotin Manuell që si motër, mëmë e kumatë, ç'kur zu e bëri priftin te kjo Qishë njera ç'vate në pension. Anita Markut. Mëma ime. E meriton t'e zë fill, këtu, sonde. Ndera pra i nget edhe Frasnitës, katundit ku u le, e prindvet të tij, e stërlalës zot Bernard Bilotta.

E pra Ejaninës (s'i pëlqei mosnjëherë t'e thërritë 'Purcill'): këtij katundi, ku që prift, e ku shprishi, me dorë të gjerë, të mirat ç'Inzot i dha, i ndihur ka Shën Vasili.

E pra ndera i nget edhe Eparkisë dhe Arbërisë: qenë 'të zonjat' e jetës së tij, shpirtërore e kulturore. Ylzit ç'e drejtuan gjatë udhës së jetës.

Po prirem e pyhem: 'Pse kështu shpejt kjo Bashki i bën këto ndera zotit-lalë?!'. Ëh, se vepra e tij është gjithë e njohur... O mos edhe Bashkia që si e magjepsur ka jeta 'tj: e rruar ngaherë ture ngurtur, e ndëndur me vepra, më se me fjalë?

Njize do t'hinej ndë skollët; i jati e shkruajti kur kish 5 vjet, po i vanë kundër të tjerët prind: pra e shkruajti kur kish 8 vjet e mbaroi kur kish 13. Doj t'hinej ndë Seminar, po ish i math, e ish vonu; e ndihu miqësia e t'jatis me peshkopin Mele, e ndihu Kongregaciona Orientale, ç'i tha 'ëh' peshkopit Mele. Hiri te Seminari i Grotaferratës kur kish 13 vjet; i sostin 12 vjet për të mirë Meshën. Njize u bë prift.

Po për pak nëng e buar trenin e priftërisë, për zilinë e gjindjes! Patë fat: Inzot e duaj prift! E duaj delar njerzish, jo delar dhensh.

Njize Qishen e Shën Vasilit e pruar Bixantine, dhe Ikonostazin e stisi më parë se Frasnita; te nj'vit e gjims bën e stistin Kanoniken, më parë se Ungra; njize, e i pari, zu e pruar arbrisht tekstet grekë të Liturgjisë dhe këndoi të parët himne në gjuhë arbreshe dhe ja mbësoi popullit. I pari që tha Meshën Arbëreshe, parë Vatikanit II. I pari, bashkë me Frasnitën, zu e nxuar ståtullat lëtire ka Qisha.

Qe i pari që 'zu dhe mbaroi' (dhe botoi) një Fjalor Arbëresh; i pari që pruar arbrisht tërë Vangjelin; i vetmi ç'i dha më priftra Eparkisë.

I pari prift ç'vate nd'Shqipëritë. I pari kuj Shqipëria i botoi nj libër.

I pari prift që, pas një viti nga vdekja, i dha ëmrin e tij Sheshit t'Qishës, dhe ka një pllakë marmuri mbi murin e Kanonikes. Bashki e Eparki i bëjnë nderë, sepse e meriton.

Ëmri i zotit lalë mbi Pllakat e marmurit vjen me thënë se ka fjalët e sheshit shkoi te Storja. Vjen me thënë se, soteparet, jeta e tij është e njohur ka gjithë, si një libër i hapët.

Iku, po sikur s'iku. Qëndroi mbë shpité 'tj. Te shpia tij. Tek ajo Kanonik ku rroi një jetë të tërë.

Një fener për kush shkon. Një shëmbull. Një dritë.

Sepse shëmbullit duan nxjerrë jashtë mbjatu, duan dukur, pa pritur 10 vjet, si thot lexha. Këtu e dhjetë vjet mund t'jetë se është vonu për Arbërinë!...

Edhe ndëse kish një karakter të fortë, të ngurët, zoti Manuell që 'një i Math'.

Ecnej përpara motit, i shpejtë ndër aq shërbise; zakonisht, errënej ndër të parët; pothuaj ngaherë i pari.

Ish i shpejtë tek të zënurit, njetër aq i shpejtë tek t'sosurit. S'lëj faregjë ndë mest.

Bashkia bëri shpejt, i gjau zotit Manuell, që pastën e lëj ngaherë gjims pa bënë. E nanë, te jetra jetë, na ruan tue buzëqeshur e na nëmren: "Accidenti, che fretta!" (Popo, sa presë!)

Shëjtrat janë ndë mes t'neve. Sosën t'i zbulomi e t'i kemi besë.

Kur janë të gjallë, kërkohen; të vdekur, duan parkalesur.

**E-mail dhe kujtime**

Egregio Direttore

Leggendo la rivista Jeta Arbëreshe n.79 ho appreso della scomparsa del Reverendissimo Papas Emanuele Giordano.

La grande figura di Papas Emanuele è stata ricordata in maniera sublime da tutti coloro che hanno scritto gli articoli pubblicati.

Non si resta insensibili e la commozione ci impedisce di poter esprimere con le parole quello che proviamo. Abbiamo goduto della presenza di Papas Emanuele fra noi a Casalvecchio quando ha celebrato la Santa Messa in occasione della Festa della Madonna della Grazie; anche se sono trascorsi alcuni anni, ho un ricordo indelebile.

Esprimo sentite condoglianze a Lei e alla sua famiglia.

**Rita Simone** (Casalvecchio/Fg)

(15-9-2015)

Unita alla vostra preghiera e lode, qui a Costantinopoli, ricordo sempre Zot Emanuell, sperando che intercederà presso il Signore che mandi sempre pastori di valore alla Chiesa, e che protegga la sua Chiesa, e ci protegga...

**Piccola sorella Diana** (dell'Ordine Charles de Foucault, missionaria in Turchia)

I perjetshëm kujtimi i tij.

Amin.

**Italo** (Costante Fortino, Istituto Orientale di Napoli)

Me zemër jam aty! Splendida iniziativa e congratulazioni per tutte le cose che hai organizzato, Agustin. Nderimet e mia dhe të familjes time.

**Keda** (dr.Kaceli)

Caro Agostino,

sono veramente felice di questi doverosi riconoscimenti e spero di essere presente.

Un abbraccio

**Emilia** (prof. Blaiotta)

I dashur Augustin,

të rroni e ta kujtoni përherë lalën Tuaj të nderuar, papa Manuellin!

**Ina Arapi** (Univ. i Vjenës)

Ka të jem me ju të gjithë me mendje e me zemër!

**Emil Lafa** (prof., Univ.Tiranës)

I përjetshëm është kujtimi i tij.

Përzemërsisht,

**don Pasquale Ferraro** (Rromë, pergjegjës kombëtar i Shqiptarëvet Katolikë të emigruar)

Shumë i nderuari Agustin,

Sot u bë një vit, që Zotin Lalë nuk e kemi midis nesh, por kujtimi për të dhe për veprën e tij, që na ka lënë pas, - si një kryepriest i urtë e i ditur, si një leksikolog, si një etnolog, si një dialektolog, si një folklorist, si një krijues e kulturolog në gjithë arealin arbëresho-shqiptar - do të na mungojë. Mirëpo, veprat e tij në



fushat krijuese, shkencore e klerikale, gjithsesi, do të jenë kujtim i përjetshëm për të na dëshmuar se sa njeri i madh dhe i vyer ka qenë për ne dhe për tërë Botën Arbërore. E kujton

**Imri Badallaj** (prof., Univ. i Prishtinës)

Gentile prof.,

sono contenta che l'amministrazione di Frascinetto voglia onorare p. Giordano. A Piana nè l'amministrazione nè il clero hanno mai onorato le figure illustri che si sono prodigate per le patrie tradizioni; Che ingratitudine! Che inciviltà!

**Dimitria** (Schirò Giuseppina, poeteshe nga Hora e Arbëreshëvet/Pa)

**(Pas dërgimit të fotografivet të ditës 17 fjavar 2016)**

Molte grazie

Tanti cari saluti

**G** (Gaetano Passarelli)

Grazie, caro Agostino. Tutto ciò che riguarda tuo zio suscita in me una grande nostalgia e tenerezza.

**Emilia** (Blaiotta)

(...) Jam shumë i kënaqur për atë çë bëre.

**Itali** (Costante Fortino)

Eterna memoria per il Papàs Emanuele!

**Vincenzo Busa**

Grazie professore, le foto sono molto belle.

**Rita Simone**

Caro Agostino,

Sa mirë që Sheshi mori emrin e ungjit tënd! Sa plak i mençur dhe i veçantë që ishte! Jam e gëzuar që më dhe rastin ta takoja para se të vdiste.

Të përqafoj,

**Eda** (Derhemi)

I nderuar Augustini,

Faleminderit shumë për fotot!

Gjithë të mirat!

Me nderime,

**Shyhrete Morina**

I nderuari Agostino Giordano.

Faleminderit dhe urimet më të mira. Nderim dhe respekt për profesorin, i cili mbetet jo vetëm krenaria juaj, por e gjithë kombit shqiptar. Ndhimesa e tij ka zënë vend nderi në kulturën tonë dhe e ka bërë atë një zë që nuk do të shuhet në shekuj!

**Valter Memisha** (prof., Tirana)

Ju falënderoj përzemërsisht!

**Emil Lafe** (prof)



**Lino Mitidieri**

ka Purçilli/Cs (1937-2001)

**Shkon moti e njerzit***(Al mio Parroco don Emanuele Giordano,  
in occasione del suo 50° di sacerdozio)*

Shkon moti,  
shkojen ditët e stinat  
shkojen e dhe njerzit.  
Po kur njerë zit  
rrojen jeten ture mbjellur  
t'mirat e jetës,  
si zoti Emanuele Jordani,  
ata njerez  
rrojen përher  
tek kujtimi  
e tek  
zë mrat e njerëzvet

*(Ejanina, 1995)*

Ringrazio di cuore.

**Papas Luigi Fioriti**

Ringrazio tanto e prego sempre unita a voi, qui ad Istanbul.

**Piccola sorella Diana**

Papàs Emmanuele, grande santo ed erudito Presbitero.

Eterna sia la Sua Memoria!

**zoti Sulla** (Salvatore)

I dashur Gustin,  
një nismë shumë e bukur dhe plotësisht e merituar për  
Z. Emanuel.

Pastë dritë dhe pushimin e pasosur.

**Merita** (Bruci, prof.)

Faleminderit për fotografitë mbi të parin përvjetor të t'dashurit zot Manuel.

**Nik Pace** (protopapas)

Zoti Manol meritava tanto.

**papas Vincenzo Carlomagno****Shkëlqim Llanaj**

nga Gjirokastra, rron në Massa

**Sot n'Ejanin'***(Burrit të lartë Arbëresh- At Emanuele Giordanos,  
nder i kombit Shqiptar  
(në përvjetorin e parë të vdekjes së tij).*

Sot n'Ejanin' si sot një vit  
Një zemër ndali, një Shenjt u ngjit  
Tej Lart në Qiell, si yll Na ndrin  
Drejt Mirësisë Ai na prin

Ai është ndër Ne, në qenien tonë  
Do t'kujtohet sot përgjithmonë  
Kujtimi tij shkon n'pafundësi  
Vepra e Tij në pavdekësi

O At i ndritur, Burrë Arbëresh,  
Ti do të jesh përherë mes Nesh  
Të pastër Arbërishten na e le  
Çdo gjë të vyer, Oh! Ti na dhe

Ti zemërbardhë dhe shpirtkulluar  
I yni At, jo, s'ke të harruar  
Të falemi me përlësi  
Bashk' me Tynzot n'përjetësi.

*(17 shkurt 2016)*

Caro Agostino,  
ti ringrazio delle fotografie che mi hai mandato in occasione dell'anniversario della morte del carissimo Don Emanuele e sono molto dispiaciuto per non aver potuto partecipare alla manifestazione.

**Carmine** (Stamile)

Caro Agostino,  
grazie per il gentile pensiero che hai avuto. La memoria e l'esempio di Zoti Emanuele mi accompagnano tutti i giorni del mio servizio sacerdotale.

Buona Settimana Santa a te e famiglia.

**zoti Mario** (Aluise)

## Targa e Pllaka mërmuri

SHESHI  
zoti Manuell Giordano  
Prift e Albanolog

Për kujtim të zotit MANUELL GIORDANO  
(1920-2015)

Bir i Frasnitës e Prift i Ejaninës  
(1946-2009)

Çë këtë Qishë shërbei njera sa rroi;  
Se t'jetë kujtuar ka gjithë si Arbëresh i Math  
Një vit pas vdekjes së tij ka gjithë vajtuar  
Bashkia e Franitës këtë pllakë këtu vu.

Ejaninë, 17 fjavar 2016.

In memoria del protopresbitero EMANUELE GIORDANO  
(1920-2015)

Figlio di Frascineto e Parroco di Eianina  
(1946-2009)

Che questa Chiesa servì fino alla fine;  
Perchè sia ricordato da tutti come grande Arbëresh,  
A un anno dalla sua rimpianta dipartita  
L'Amministrazione di Frascineto questa Lapide qui pose.

Eianina, 17 febbraio 2016.

## Kodi e Siti i 'Jetës Arbëreshe'

Edhe ndëse u buar mot,  
ç'ka numri 80/2015,  
e për gjithë numret e shkuar  
e të ardhshëm,  
**Jeta Arbëreshe**  
ka Kodin e saj :

**ISSN 2465-1141**  
Jeta Arbëreshe [Online]

-----

Ndëse daftë Inzot,  
mbrënda këtij muaji,  
kjo Rivistë  
gjashtëmujore online  
do të ketë  
**një Sit Web të ri.**

**I vetmi**  
**Sit Web**  
**i rivistës sonë,**  
i autorizuar.

**Vet këtu**  
mund të djovaset  
e të shkarkohet  
**Jeta Arbëreshe.**

**Mb'Shën Mëri Pulin**

(Bernard Bilotta)

Kjo 'Rrëfiemez' autobiografike, njera sot dorëshkrim, gjëndet te Kuaderni I (format 15x20 cm., fleta 66, faqe 132, të pasingùara ka autori), ku janë mbledhur të tjerë sonete e ndryshe poezi, të gjithë të datuar 1990-1901, mbi motive ndrishe.

Na rrëfyen mbi një udhëtim që Bilota bëri, mbë Shën Mëri Pulin, - një shëjtërore ndë malt - me një krushk e mbi mushk. S'ka titull (papas Giordano e titulloi 'Pellegrinaggio alla Madonna del Pollino'), ndërsa u e titullova "Mb'Shën Mëri Pulin". E përbërë ka 17 tringellime/Sonete të thjeshtë, (vjeshe 238.), me rimë njëmbëdhjetë rrokjesh, me rimë ABAB ABAB CDC DCD. Ka datë 10/7/1900 e s'është e pjerrë lëtisht. Një kureshtje: Rrëfiemza nëng zë me sonetin nr.1, por me nr.17, të singuar, një e një, me llaps të kuq ka dora e autorit. (a.g.)

(transkriptoi) **Drejtori**  
ka Purçilli (Cs)

**17.**

Të t'çoja, Shënmëri, si dishe me Tënzot,  
m'u nisa sido ndihsha edhë i smür.  
M'u nisa ndë mes t'dits me diell të ngroht  
kalùer mbi mushk që bënej prë nj'gajdhür.

Däl-däl ngjita brinjat me kapvot;  
shkova murxha e ruga shprisht me gür  
e dushqe e prrenj me driza. Si një çot  
që udhen s'di, u zura e u bora kür

prisja t'mirra Vashjelin. Nji udhje thëll  
ndë dushkut u ngulja tue vät shtrëmbur.  
Mbarrarjen degat aq sa s'shija qiell.

Pat prirsha prap e bora mot tue u trëmbur  
mos prirsha t'birsha tek më s'shijha diell  
ndër trafakope t'bënja ulqit ndëndur.

**16.**

Më ruejte, se me driten tënde dolla  
mb'üdth mbaru ka m'u shtura tue ngär dreq.  
Tue vät si mbë skapò pror e m'u solla  
më llargu ka kish veja për më keq.

Si m'errura ndonj shesh me dega t'holla  
e me bar'ra që prirshin si 'njöm shelq,  
u adunarta se duhej ahiera skolla  
e njerezve, që të Pulinit ishen pjeq.

Ruej ktëj ruej atëj ka t'vrenja ndonjarë  
që të më msonej udhen ka kish vejem  
me shokun, përsaksa llargu një ljetë

që ruenej një mür lop. Me thirr m t'dejem  
i thirrtim:"Qasu ktëj, ti ç'malet di,  
e msona ka kem vemi, se t'paguejem".

**15.**

Rrangarti ljtiri but, si ti Shënmri  
e shtijte luft na jip nd'at hër të keq,  
që trakulonej dita. E piejtim: "Dī  
e na mson udhen ka të ngasmi dreq

të vemi, na që u nistim mbë Shënmëri?  
Msona na të dimi ka ajo telq".  
"Ju shkarpalüet po shüm - na tha - ai ljtī:  
Kin priri prap". Se t'vin me në, një qelq

i mbjuem me vër të pīj, jo nj'hër po trī.  
Pran i thām:"Mb' üdh nxirna, të pagüemi:  
lipna që do. Na sonde duem të qasemi

sa mundmi ka t'errëmi mbë Shënmëri".  
"U marr sa do ju të më jipni doni.  
Pas meje udhes prap, vi anangäsemi".

**14.**

I shkreti ljtī përpara sinodhī  
